


# PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

## BASHKIA ROSKOVEC

STRATEGJIA TERRITORIALE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MIRATOHET**

KRYETARI I KKT-së

**Z. EDI RAMA**

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**Znj. Belinda Balluku**

Kryetari i Këshillit Bashkiak

**Z. Kadri Hyska**

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 11, Datë 24. 02. 2020

Kryetari i Bashkisë

**Znj. Majlinda Bufi**

# PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË ROSKOVEC

STRATEGJIA TERRITORIALE

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 04, Datë 10. 06. 2020

Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit: Rakip Hazizaj

KONSULENT: "Atelier 4", Nr. Liç 5063/7

E SHQIPERI
TERRITORIT
TIRANE

ATELIER 4 STUDIO ARKITEKTURE

# TABELA E LËNDËS

TABELA E LËNDËS ..... 1
LISTA E FIGURAVE ..... 3
LISTA E TABELAVE ..... 4
LISTA E GRAFIKËVE ..... 4
AKRONIME ..... 5
1 HYRJE ..... 7
I. Projekti "Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore për bashkitë Peqin, Roskovec, Patos dhe Mallakastër" ..... 7
i. Objektivat e projektit ..... 8
ii. Produktet e projektit ..... 9
iii. Metodologjia për Fazën 2 – Strategjia Territoriale ..... 9
2 Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga Planifikimi në nivel qendror ..... 11
2.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar ..... 11
2.2 Plani i Integruar Sektorial për zhvillimin e prodhimin e hidrokarbureve në Vendburimet e Patos-Marinëz ..... 15
2.3 Strategjitë kombëtare për zhvillim ..... 17
2.4 Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare ..... 35
2.5 Zonat e Mbrojtura Mjedisore ..... 37
2.6 Zonat dhe Objektet e Trashëgimisë Kulturore ..... 38
3 REZULTATET E ANALIZËS DHE VLERËSIMIT tË TERRITORIT ..... 40
3.1 Ndarja administrative ..... 40
3.1.1 Zhvillimi historik i Bashkisë Roskovec ..... 40
3.1.2 Dinamikat rajonale të Zhvillimit ..... 44
3.2 Analiza metabolike e flukset kryesore me rëndësi për territorin ..... 47
3.2.1 Flukset e Ujit ..... 47
3.2.2 Flukset e Ushqimit ..... 50
3.2.3 Flukset e Energjisë ..... 52
3.2.4 Flukset e Turizmit ..... 54
3.3 Elementet përjashtues të zhvillimit ..... 55
3.4 Trendi i rritjes së popullsisë dhe nevojat ..... 58
3.4.1 Popullsia rezidente në Bashkisë Roskovec ..... 58
3.4.2 Tendencat demografike të popullsisë së regjistruar në Gjendje Civile ..... 59
3.4.3 Diferenca e popullsisë rezidente dhe asaj të regjistruar në gjendjen civile ..... 60

3.4.4 Densiteti i popullsisë ... 61
3.4.5 Tendenca demografike sipas grup-moshave ... 61
3.4.6 Përbërja e ardhshme e popullsisë rezidente në Bashkinë Roskovec ... 62
3.5 Përcaktimi i territorit të bashkisë sipas 5 sistemeve ... 69
3.5.1 Analiza e përdorimit ekzistues të tokës ... 71
3.6 Analiza e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve [SWOT] ... 75
3.6.1 Përmbledhja e aspekteve pozitive ... 80
3.6.2 Problematikat dhe nevojat e evidentuara dhe rekomandimet për zbutjen e impaktit ... 81
4 VIZIONI DHE STRATEGJIA ... 83
4.1 Vizioni i zhvillimit ... 84
4.2 Objektivat strategjike të zhvillimit ... 86
4.3 Drejtimet e zhvillimit ... 87
4.3.1 Zhvillimi ekonomik ... 87
4.3.2 Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve ... 90
4.3.3 Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe mjedisore ... 92
4.4 Nevojat për konvertime të sistemeve territoriale ... 94
5 PLANI I VEPRIMEVE PRIORITARE, INVESTIMEVE STRATEGJIKE DHE PROJEKTEVE PILOT TË ZHVILLIMIT ... 97
5.1 Programet dhe plani i veprimit ... 97
5.2 Metodologjia e përcaktimit të prioritetit ... 109
5.3 Fazat e zbatimit të planit ... 113
5.4 Financat bashkiake dhe burimi i mundshëm i financimit ... 116
5.4.1 Financat bashkiake ... 116
5.4.2 Burimi i mundshëm i financimit ... 121
5.5 Ndryshime të nevojshme institucionale dhe ligjore ... 124
5.6 Indikatorët e monitorimit dhe të zbatimit të strategjisë ... 125
6 ANEKSE ... 132
A – SKEDAT E PROJEKTEVE ... 132
B - HARTAT E STRATEGJISË TERRITORIALE ... 161
C - PROCESI I KONSULTIMIT TË PLANIT ... 162
**Objektivat për përfshirjen e komunitetit në vendimarrje** ... 162
**Takimet dhe grupet e interesit** ... 164
**Përmbledhje e takimeve për strategjinë territoriale** ... 165


"F KosovarPwt", Nd.35, H.6 Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel +3554 2232804 / 2430195, e-mail info@atelier4.al

# LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Harta e rekomandimeve të PPK-së ..... 14
Figura 2 Plani i Integruar Sektorial për zhvillimin e prodhimin e hidrokarkureve ..... 16
Figura 3. Korridori i Transportit Pan-Evropian në Rajonin e Ballkanit ..... 17
Figura 4. Programi i Investimit për Ndërtimin e Rrugëve deri në Vitin 2030 ..... 18
Figura 5 Harta e Venburimeve dhe e Blloqeve të kërkimit të naftës dhe gazit ..... 21
Figura 6. Çështjet e rëndësisë kombëtare ..... 35
Figura 7. Këneta e Zezë,Roskovec ..... 37
Figura 8. Harta e zonave të mbrojtura ..... 39
Figura 9. Pozicioni në rajon dhe ndarjet administrative ..... 40
Figura 10 Rrugët në shek V p.e.s.-IV e.s ..... 42
Figura 11. Densiteti i popullsisë në nivel Rrjeti ..... 44
Figura 12. Densiteti i popullsisë në nivel rrjeti. ..... 45
Figura 13. Dinamikat e Zhvillimit Rajonal ..... 46
Figura 14. Metabolizmi rrjeti ujor ..... 49
Figura 15. Metabolizmi ushqimi ..... 51
Figura 16. Metabolizmi energjia ..... 53
Figura 17. Metabolizmi turizmi ..... 54
Figura 18. Harta e kufizimeve të zhvillimit ..... 57
Figura 19. Harta e sistemeve territoriale ..... 71
Figura 20. Harta e kategorive të përdorimit të tokës ..... 74
Figura 21. Harta e nënkategorive të përdorimit të tokës ..... 74
Figura 22. Harta e vizionit të zhvillimit ..... 85
Figura 23 Harta e drejtimeve te zhvillimit ..... 93
Figura 24 Harta e konvertimeve të tokës ..... 96
Figura 25 Shembull pyetësori i plotësuar nga banorët e Bashkisë Roskovec, gjatë takimeve publike ..... 112
Figura 26 Harta e fazave të projekteve të bashkisë Roskovec ..... 113

# LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Shpërndarja e rrjedhjeve mujore të lumit Seman në vendmatjen Mbrostar......47
Tabela 2 Trendet demografike 2011-2034 sipas popullsisë rezidente......58
Tabela 3 Trendet demografike 2010-2034 sipas popullsisë së regjistruar në Gjendjen civile......59
Tabela 4 Diferençat midis popullsisë rezidente dhe asaj të gjendjes civile......60
Tabela 5 Sistemet territoriale......69
Tabela 6 Kategoritë e përdorimit të tokës......73
Tabela 7. Shembull skede projektesh prioritare......109
Tabela 8 Tranfertat Specifike......117
Tabela 9. Tabela me të dhënat e indikatorëve të monitorimit për bashkinë......126

# LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1 Projeksioni i piramidës së moshës Bashkia Roskovec 2016 -2031......62
Grafiku 2 Popullsia sipas grup-moshës, 2016......63
Grafiku 3 Popullsia sipas grup-moshës, 2021......63
Grafiku 4 Popullsia sipas grup-moshës, 2026......64
Grafiku 5 Popullsia sipas grup-moshës, 2031......64
Grafiku 6 Koeficienti i varësisë Bashkia Roskovec - 2016......65
Grafiku 7 Koeficienti i varësisë Bashkia Roskovec - 2021......66
Grafiku 8 Koeficienti i varësisë Bashkia Roskovec – 2026......66
Grafiku 9 Koeficienti i varësisë Bashkia Roskovec - 2031......67
Grafiku 10 Transferta e pakushtëzuar......117
Grafiku 11 Transfertat në vite......118
Grafiku 12 Të ardhura dhe Shpenzime në vite......120


...arëve", Nr. 35, ... Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail ...

# AKRONIME

AdZM Administrata e Zonave të Mbrojtura
AKBN Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKZM Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
ALUIZNI Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ARRSH Autoriteti Rrugor Shqiptar
ARZM Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura
ASIG Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
ATRAKO Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
AZHBR Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
b.e banorë ekuivalent
CCTV Closed-circuit television- sistem survejimi me kamera
CENSUS Procesi i mbledhjes të të dhënave për popullsinë vendase
DAR Drejtoria Arsimore Rajonale
DIH Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DPUK Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve
EFLUENT Mbetje të derdhura në sipërfaqe ujore
FSHZH Fondi Shqiptar i Zhvillimit
IAP Ioanian Adriatic Pipeline- Gazsjellësi Jon- Adriatik
IMHOFF Vaskat Imhoff: vaska për mbledhjen dhe përpunimin e ujërave të ndotura
INK Intensitet i Ndërtimit me Kusht
INSTAT Instituti i Statistikave
IPARD Instrument for Pre-Accession Assistance in Rural Development- Mbështjetje për zhvillimet rurale dhe bujqësore
IPUP Impianti i Pastrimit të Ujërave të Përdorura
ISKSH Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetsor
ISPU Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Urbanistike
ITUN Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
ITUP Impianti i Trajtimit të Ujërave të Pijshëm
IUCN International Union for Conservation of Nature
KKT Këshilli Kombëtar i Territorit
KPTHN Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës
LED Llampat LED: Light-emitting diode
MAS Ministria e Arsimit dhe Sportit
MEI Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MTI Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHETTS Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MZHU Minsitria e Zhvillimit Urban

OSHEE Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
PBA Plan Buxhetor Afatmesëm
PDV Plan i Detajuar Vendor
PDZRK Plan i Detajuar në Zonë me Rëndësi Kombëtare
PGM Pikë Grumbullimi Mbetjesh
PIK Plan i Investimeve Kapitale
PKS Plan Kombëtar Sektorial
PMNZSH Policia e Zjarrfikësve e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
PNR Park Natyror Rajonal
PPK Plan i Përgjithshëm Kombëtar
PPV Plan i Përgjithshëm Vendor
PSV Plan Sektorial Vendor
RAMSAR Konventa Ndërkombëtare mbi ligatinat për të siguar mbrojtjen dhe përdorimin e duhur e tyre
RNM Rezervat Natyror i Menaxhuar
RSH Republika e Shqipërisë
STK Strategjia Kombëtare e Transportit
SWOT [Strengths, Ëeaknesses, Opportunities, Threats] Analiza e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve
SHGJSH Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
TeR Termat e Referencës
VKM Vendim i Këshillit të Ministrave
VMS Variable Message Signs- Tabela me të dhëna përgjatë akseve rrugore
ZNUAE Zonat e Ndërmjetme dhe Ultësirat Agro-Ekologjike

# 1 HYRJE

## I.Projekti "Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore për bashkitë Peqin, Roskovec, Patos dhe Mallakastër"

Ky projekt do të formulojë Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkive Peqin, Roskovec, Patos, Mallakastër. Qëllimi është që t'u sigurojë këtyre bashkive një dokumentacion udhëzues të zhvillimit që do të shërbejë si një kushtetutë lokale e zhvillimit për administrimin e territorit të bashkive gjatë 15 viteve të ardhshme.

Formulimi i Plani të Përgjithshëm Vendor do të bazohet në kornizën ligjore, udhëzimet dhe rekomandimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planeve Sektoriale (kombëtare apo rajonale) si dhe në materialet e siguruara nga bashkitë e që japin informacion mbi situatën aktuale.

Synimi është që plani të mos jetë thjesht një dokument, rregullator i ndërtimit, por një instrument nxitës i zhvillimit, veçanërisht në rastin e Bashkive si Peqin-Roskovec-Patos-Mallakastër që kanë pësuar rënie të popullsisë në vitet e fundit si pasojë e migrimit.

Trajtimi i këtyre bashkive si një lot i vetëm bën sens për karakteristikat e përbashkëta që ato kanë, por qëllimi këtu nuk është unifikimi i karakteristikave, por nxjerrja në pah e veçorive: pikave të forta apo problematikave përkatëse për të dhënë një zgjidhje *ad hoc* për secilën bashki.

Procesi i hartimit të PPV-së synon disa objektivave, si më poshtë:

*Mbështetje ndaj Bashkive për të promovuar një menaxhim urban e rural më të mirë të territorit, nëpërmjet përgatitjes së një sistemi të ri rregullator.*

Qëllimi kryesor i Projektit është të promovojë një menaxhim më të mirë të zhvillimit territorial. Kuptohet se ky qëllim nuk mund të arrihet vetëm nëpërmjet PPV, por edhe me instrumenta të tjerë zbatues (si rregulloret, masat incetivuese apo ndëshkuese në përputhje dhe me legjislacionin në fuqi etj), si dhe me masat e duhura për ngritjen e kapaciteteve të bashkisë. Për këtë arsye, propozohet një qasje koherente ndaj menaxhimit të zhvillimit urban, duke përcaktuar një rol të ri pro-aktiv për Bashkitë në "udhëheqjen" e proceseve të zhvillimit urban e ekonomik me anë të përcaktimit të projekteve madhore me impakt edhe rajonal, krahas rolit tradicional për "drejtimin" e zhvillimit nëpërmjet instrumentave të kontrollit të territorit (lejet e ndërtimit).

Për këtë qëllim Projekti:

- Krahas përcaktimit të Vizionit dhe Strategjisë të zhvillimit urban do përcaktojë, në përputhje dhe me TeR projektet e programet prioritare të lidhura me Buxhetin Bashkiak ose të shoqëruara me skeda projekti që krijojnë mundësinë e aplikimit në fonde rajonale, kombëtare apo bashkëpunime ndërkombëtare.

- Aktualisht, bashkitë menaxhojnë territore urbane edhe rurale, ndaj projekti do gërshetojë dhe harmonizojë 2 mënyra të ndryshme të jetesës me anë të një vizioni të përkrahur nga të gjithë aktorët e zhvillimit.
- Kuptimi nga ana e bashkisë të rolit të ri që duhet të kryejë, dikton përfshirjen e stafit të planifikimit urban, zhvillimit ekonomik, etj, në përpunimin e instrumentave të përshtatshëm për planifikim pro-aktiv, si dhe në zbatimin e PPV në zonat prioritare të zhvillimit. Përfshirja dhe rritja e kapaciteteve bashkiake është pjesë e rendësishme e punës sonë.

*Sigurimi i një Plani "në koherencë me situatën social-ekonomike të bashkisë".*

PPV e propozuar do bazohet në një analizë të plotë të raporteve dhe studimeve të disponueshme për Bashkinë, në studimin e kontekstit gjeografik, historik, natyror, ekonomik, demografik dhe social të vendbanimeve, në analizën e strukturës territoriale e funksionale dhe dinamikës së saj, në vlerësimin e infrastrukturës ekzistuese dhe të sistemeve të shërbimeve. Kushtet dhe sfidat që do identifikohen gjatë fazës së analizës do të krijojnë bazat e propozimeve të Strategjisë Territoriale dhe të Planit të Zhvillimit Territorial.

*Zhvillimi i një "sensi të fortë "pronësie" tek aktorët e zhvillimit dhe të interesit"* arrihet me anë të prezantimit dhe diskutimit të planit pranë komunitetit lokal, bizneseve, grupeve të veçanta që operojnë ose gjenden në territor, etj

*Propozimi i një Sistemi Rregullator që të jetë në përputhje me bazën ligjore në fuqi.*

Roli pro-aktiv i propozuar i Bashkisë, në proceset e zhvillimit urban, si dhe të gjitha propozimet e PPV-së do filtrohen për të siguruar përputhjen e plotë më kuadrin ligjor në fuqi duke propozuar sipas rastit ndryshime në kuadrin ligjor vendor për të mundësuar dhe lehtësuar zbatimin e vetë PPV-së.

### i.Objektivat e projektit

Duke ndjekur objektivat e përgjithshme të Ligjit Ligj Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, si dhe objektivat strategjike të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe të strategjive kombëtare sektoriale, ky projekt ka si objektiv realizimin e një Plani të Përgjithshëm Vendor të qëndrueshëm, që siguron menaxhimin e tokës nëpërmjet sigurimit të instrumentave të planifikimit dhe kontrollit të territorit.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor:

- Balancimi i nevojave dhe interesave kombëtare e vendore për zhvillimet në territor;
- Krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve ligjore;
- Drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;

- Rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane.

Planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar:

- Rigjenerim urban;
- Mbrojtje të mjedisit;
- Zhvillim të qëndrueshëm
    a. të burimeve natyrore,
    b. të tokës së kultivueshme,
    c. të peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;
- Rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturat publike e servitutet publike;
- Rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike.

Objektivat specifike përfshijnë:

- Krijimin, detajimin dhe aplikimin praktik të metodave planifikuese që t'i përshtaten tregut;
- Formulimin e veprimtarive të partneritetit ndërmjet bashkisë, zhvilluesve, pronarëve të tokës, pushtetit qendror dhe grupeve të tjera të interesit nëpërmjet një procesi konsultimesh dhe pjesëmarrjes aktive;
- Rritjes së kapacitetit të planifikimit, kontrollit të zhvillimit dhe menaxhimit të tokës në departamentet përkatëse të pushtetit lokal;
- Sigurimin e një menaxhimi më të mirë të territorit, duke siguruar një produkt koherent me situatën social-ekonomike bazuar në ekulibrimin e interesave publike dhe private;
- Krijimin e një sensi të fortë "pronësie" tek aktorët e zhvillimit dhe të interesit.

### ii.Produktet e projektit

Që të realizohen objektivat e mësipërme, bazuar dhe në kërkesat e Termave të Referencës, një sekuencë logjike e aktiviteteve të mëposhtme do të përmbahet në dokumentat në vijim:

- DOKUMENT 0 RAPORTI PARAPRAK
- DOKUMENT I RAPORTI 'ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT'
- DOKUMENT II RAPORTI 'STRATEGJIA TERRITORIALE'
- DOKUMENT III RAPORTI I 'PLANIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT'
- DOKUMENT IV RREGULLORE VENDORE
- DOKUMENT V VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

### iii.Metodologjia për Fazën 2 – Strategjia Territoriale

Puna për hartimin e planit ka filluar me një njohje të zonës, të kontekstit rajonal e morfologjik, të dinamikave ekonomike dhe sociale, që kanë gjeneruar situatën aktuale me të mirat dhe problematikat e saj. Dinamikat aktuale lokale dhe rajonale, çështje që kërkojnë një kooperim me

bashkitë fqinje apo me pushtetin qëndror diktojnë formulimin e një vizioni që shkon përtej territorit administrativ bashkiak. Dinamikat aktuale kanë si aspekte pozitive, që nxisin zhvillimin, ashtu dhe aspekte frenuese dhe negative. Këto të fundit, me anë të planifikimit duhet të ndryshohen dhe/ose të parandalohen. Elementët e fortë territorialë, pikat e forta në kapitalin njerëzor dhe ekonomik do jenë themelet e strategjisë së zhvillimit të ardhshëm të territorit. Strategjia e zhvillimit do synojë të trajtojë problematikat aktuale të evidentuara si dhe të marrë masa për të evituar kërcënimet e mundshme që mund të vërtetohen nëse do të vijojë trendi aktual i zhvillimit. Detajimet dhe saktësimet e orientimeve strategjike, do të thellohen dhe formëzohen në planin e përdorimit të tokës dhe në rregulloret përkatëse duke krijuar bazën për zhvillimin territorial si nga sektori publik ashtu dhe nga ai privat.

Në Raportin e "Analizës dhe Vlerësimit të Territorit" janë shqyrtuar në detaje dinamikat urbane, sociale ekonomike, lidhjet infrastrukturore dhe impakti i tyre në sistemet natyrore, bujqësore dhe ujore. Raporti i "Analizës dhe Vlerësimit të Territorit" ka trajtuar edhe rekomandimet e PPK-së dhe strategjive në nivel kombëtar.

Dokumenti i Strategjisë territoriale fillon me një përmbledhje të gjetjeve kryesore të "Analizës dhe Vlerësimit Territorial", prezanton Strategjinë e Zhvillimit mbështetur në Vizionin dhe Objektivat Strategjikë të cilët janë detajuar bazuar në drejtimet kryesore të zhvillimit dhe kapitulli i fundit tregon rrugëtimin që vizioni do të ndjekë për t'u materializuar në terren me anë të planit të veprimeve, investimeve strategjike, instrumentave financiarë dhe instrumentave monitorues.

Për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit bazë janë pyetësorët e shpërndarë gjatë takimeve ku krahas stafit teknik edhe komuniteti ka shprehur opinionin e tij për zhvillimin e ardhshëm.

Projektet kryesore janë detajuar në skeda (Aneksi A) me anë të të cilave bashkia mund të aplikojë për fonde dhe pranë donatorëve të ndryshëm.

Procesi i konsultimeve (Aneksi C) mjaft i rëndësishëm, jo vetëm për të mundësuar njohjen e produktit te publiku i gjerë, por dhe për të mundësuar një informacion polivalent mbi problematikat, potencialet dhe nevojat e popullsisë ka filluar që në fazën e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit ku qytetarëve krahas kërkesës për njohjen e problematikave që ato hasin në territor i është kërkuar dhe plotësimi i pyetesorëve se si ata shohin zhvillimin e territorit në 15 vitet e ardhshme.

# 2 PARASHIKIMET E DETYRUESHME QË RRJEDHIN NGA PLANIFIKIMI NË NIVEL QENDROR

## 2.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar

PPK ofron kornizën strategjike referuese për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, për 15 vitet e ardhshme, me qëllim sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të vendit, menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij, mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar njëkohësisht edhe përdorimin racional të tokës

Vizioni i Planit të Përgjithshëm Kombëtar e sheh Shqipërinë si një qendër të integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Evropian, me ekonomi të shumëllojshme dhe konkuruese në hapësirën ballkanike, si një shtet që synon barazinë në aksesin në infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Siguron mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore me synimin për t'u shndërruar në një destinacion autentik. Në objektivat strategjikë të planit parashtrohet si fillim, sigurimi i integritetit fizik dhe territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin shqiptar. PPK-ja synon një riorganizim të territorit shqiptar, duke strukturuar vendbanimet në qendra urbane: primare, sekondare dhe terciare, strukturon lidhjet dhe aksesin si pjesë e korridoreve evropiane dhe ballkanike, duke krijuar rajone të forta ekonomike që kanë marrëdhënie plotësuese me njëri-tjetrin.

PPK vendos si prioritet strategjik realizimin dhe finalizimin e projekteve strategjike ***infrastrukturore*** rrugore dhe energjitike (TAP, IAP, interkonjeksionit 400 kV Fier-Elbasan-Maqedoni) që lidhin vendin me Europën. PPK-ja vendos prioritetet në rrjetin hekurudhor: Rikonstruksioni i plotë i sistemit ekzistues dhe ndërtimin e linjave hekurudhore për të përkrahur lëvizjen ndërqytetase për distanca të largëta dhe lëvizjen ndërkufitare, etj.

Plani Kombëtar për ***sistemin urban*** propozon:

- Zhvillim hapësinor policentrik dhe një marrëdhënie të re urbane - rurale;

- Kontroll i ekspansionit fizik të qyteteve dhe zonave të urbanizuara, duke promovuar densifikimin në vend të shpërhapjes urbane;

- Akses më të mirë në një infrastrukturë multimodale, e cila është jo vetëm më e efektshme, por edhe miqësore ndaj mjedisit;

- Funksione mikse dhe komplementare;

- Përdorim dhe menaxhim inteligjent i ekosistemit urban në veçanti i ujit, energjisë dhe mbetjeve;

- Konservim dhe zhvillim të pasurive natyrore dhe të trashëgimisë historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane.

Plani prezanton hierarkizimin e qendrave dhe profilizimin e tyre në akomodimin e sektorëve ekonomike të përshtatshëm duke shfrytëzuar potencialet ekzistuese.

***Sipas ndarjes dhe klasifikimit të vendbanimeveRoskoveci është një qendër terciare urbane. Ndërsa vendbanimet e tjera janë Lokalitete..***

Vizioni i PPK-së për ***sistemin natyror*** shprehet nëpërmjet dy koncepteve: Promovim dhe Akses.

Në këtë kuadër, zgjidhjet, që propozon PPK-ja, janë:

a) Rritje të zonave natyrore nëpërmjet shtimit të zonave të mbrojtura dhe korridoreve lidhëse natyrore përgjatë luginave të lumenjve.

b) Shtimi i tri parqeve kombëtare në rrjetin kombëtar të zonave të mbrojtura:

- Parku i Bunës
- Parku i Alpeve
- Parku i Vjosës

Gjithashtu, propozohet që në rrjetin e zonave të mbrojtura të shtohet edhe rrjeti Emerald.

Në sistemin e zonave të mbrojtura bëjnë gjithashtu pjesë edhe korridoret natyrore, të cilat duhet të konsiderohen si hapësira të përshtatshme për zhvillimin e një infrastrukture të butë, miqësore me mjedisin.

***Bashkia e Roskovec përfshihet në Korridorin Natyror të Semanit.***

Në këto zona rekomandohet ndër të tjera:

Krijimi i hapësirave rekreative dhe atraksioneve natyrore përgjatë luginave të lumenjve. Futja e rrjetit kombëtar të biçikletave, i cili akseson dhe përshkon zonat natyrore dhe ato të trashëgimisë historike e kulturore.

Përfshirja e sistemit natyror në zinxhirin e zhvilimit ekonomik.

Projekte ripyllëzimi dhe rigjenerimi në zonat e degraduara nga dukuri natyrore, si erozioni dhe përmbytjet, por edhe nga aktiviteti njerëzor.

Politikat që mbështet Plani Kombëtar në drejtim të ***sistemit bujqësor*** janë:

- Ruajtje.

- Konsolidim.



Rr. "E Kosovarëve", Nd.35, H. 6.Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel +3554 2227804 / 7420155, e mail info@atelier4.al

- Modernizim.

Në mbrojtje të ***Sistemit Ujor***, PPK vendos:

- vijën Blu, e cila ka për qëllim:

  - mbrojtjen nga përdorimet e ndaluara të hapësirës së brezit bregdetar, të përcaktuar sipas legjislacionit sektorial për mbrojtjen e burimeve ujore;

  - monitorimin e aktiviteteve për shfrytëzim ekonomik në hapësirën e brezit bregdetar;

  - për rrjedhat lumore, rigjenerimi i korridoreve natyrore që shoqërojnë rrjedhën e tyre.

- Njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të peizazhit natyror të territorit që shtrihet nga vija bregdetare deri në kreshtën e brezit të parë kodrinor malor.
- Marrjen në mbrojtje të pellgut ujëmbledhës të Vjosës. Vjosa dallon nga të gjithë lumenjtë e tjerë në Ballkan për shkallën e lartë të ujëshmërisë, ndërtimin gjeologjik të formacioneve që përshkon dhe larminë e peizazheve përgjatë luginës.

***Poli i zhvillimit rajonal Vlorë - Fier – Berat*** do të ketë 3 qendra kryesore, bashkinë Vlorë, bashkinë Berat dhe bashkinë Fier. Bashkia Lushnje dhe bashkia Kuçovë parashihen si qendrat e specializuara të polit të zhvillimit rajonal, ndërsa bashkitë e tjera do të jenë qendra terciare. Në total poli i zhvillimit rajonal Vlorë-Fier-Berat përfshin 13 bashki dhe 75 njësi administrative. Në aspektin e zhvillimit ekonomik si dhe falë burimeve të konsiderueshme natyrore, ky pol konkurron denjësisht me motorrin më të madh ekonomik të vendit, atë Durrës-Tiranë. Në rajon ndër potencialet kryesore natyrore përmenden fusha e Myzeqesë, rafineritë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës dhe gazit natyror, laguna e Nartës, porti i Vlorës, vija e pastër bregdetare, kalimi i aksit kryesor rrugor, kalimi i linjës energjetike TAP etj.

Propozohet:

• Përmirësimi i kushteve dhe fuqizimi i kapacitetit akomodues të portit të Vlorës dhe Petroliferës, si nyjat portuale kryesore të transportit detar.

• Integrimi dhe funksionimi me kapacitet të plotë sipas modalitetëve të stacioneve të rrjetit hekurudhor: Levan, Nartë dhe Rafineri si stacione mallrash; Vlorë, Fier, Lushnjë dhe Ballsh si stacione qendrore, si dhe rigjallërimi i stacioneve për pasagjerë, Dushk, Gradishtë, Libofshë si edhe Novoselë, Kraps dhe Kasnicë.

• Shtimi i linjës hekurudhore drejt Kakavijës, duke bërë lidhjen nëpërmjet Ballshit me Memaliajn.

• Rruga bregdetare peizazhistike, përgjatë qendrave: Divjakë-Pishë Poro-Nartë-Vlorë- Dhërmi, rrjeti i biçikletave, i cili përshkon zonën referuar rrjetit kombëtar të biçikletave, propozuar nga PPK-ja. Në këtë pol kalojnë itinerari peizazhistik blu dhe itineraret horizontale kombëtare.

• Projekte strategjike për shfrytëzimin e gazit TAP, që kalon në këtë territor. Realizimin e projektit për linjën energjetike TAP të gazit, Fier - Mali i Zi - Bosnjë - Hercegovinë - Kroaci.

• Një nga këto projekte strategjike është lidhja e TAP-it me HEC-in e Vlorës, në mënyrë për ta bërë funksionale edhe këtë vepër energjetike, me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit për jugun e vendit. Projekti i linjës së gazit Fier-Vlorë, për furnizimin e Vlora Thermal Poëer Plant është parashikuar për t'u hartuar si projekt teknik.

• Vlerësimi i mundësive nga sektorët përkatës për ripërdorim të termocentraleve ekzistues apo të rinj, që përdorin energjinë nga gazi.

• Vlerësimi i potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë së rinovueshme dhe asaj alternative, duke konsideruar rrezatimin prej 2700 orë/vit për ndërtimin e parqeve fotovoltaike.



*Figura 1. Harta e rekomandimeve të PPK-së*

## 2.2 Plani i Integruar Sektorial për zhvillimin e prodhimin e hidrokarbureve në Vendburimet e Patos-Marinëz

Ky plan i integruar që përfshin pjesë të territorit administrativ të Bashkisë Roskovec është miratuar me vendim te KKT-së nr. 28, datë 10.05.2013. Ky studim dhe rregullorja përkatëse janë hartuar bazuar në ligjin 10119 datë 23.04.2009 dhe aktet e tij nënligjore, përe rrjedhojë përdorimi i propozuar i tokës nuk është në përputhje me VKM 686 datë 22.11.2017. Për këtë arsye rekomandimi që propozimet e PPV-së duhet të bëhen sipas kategorive të propozuara në studim nuk mund të merret në konsideratë.

Territori i Bashkisë Roskovec përfshirë në këtë plan, Marinza dhe Jagodina bëjnë pjesë në Zonën e zhvillimit primar/sekondar me intensitet të lartë të industrisë së hidrokarkureve (P). Në secilën nënndarje parashikohen 5-7 sheshe për shpim pusesh, 2 gropa ekologjike, një grup grumbullimi, tubacione, rrugë lidhëse, linja elektrike.

Sipas rregullores së studimit, *bazuar në raportin e METE, vendvendosja e puseve të naftës është:*

*-puset e naftës në terren vendosen sipas projektit të përpunimit të vendburimit*

*-distanca e vendosjes së puseve, në përputhje me qëllimin e tyre, karshi objekteve industriale e social-kulturore jepen në tabelën që vijon*

| *Nr.* | *Objekti afër pusit* | *Distanca në m* | |
|---|---|---|---|
| | | *Puse shfrytëzimi* | *Puse kërkimi* |
| *1* | *Banesa të veçuara* | *60* | *100* |
| *2* | *Qendra të banuara* | *100* | *150* |
| *3* | *Rrugë automobilistike kombëtare* | *50* | *70* |
| *4* | *Rrugë automobilistike zonale* | *30* | *40* |
| *5* | *Rrugë hekurudhore* | *60* | *80* |
| *6* | *Linja elektrike TU-TL (paralel)* | *50-60* | *60-80* |
| *7* | *Objekte industriale* | *100* | *150* |
| *8* | *Objekte social kulturore* | *100* | *150* |
| *9* | *Tubacione magjistrale nafte e gazi* | *20* | *30* |
| *10* | *Depo (magazinë) bujqësore* | *100* | *150* |

- *Bazamenti i lëkundësit, si rregull, ndërtohet në mënyre të tillë që gryka e pusit të jetë jo më lartë së 60 cm nga kuota e sheshit të punës së pusit.*
- *Vendi i ndërtimit të bazamentit të lëkundësit do të jetë 90, karshi skelës së tubove të prodhimit*

*Përsa i përket zonave të mbrojtura natyrore apo monumenteve të kulturës të përfshira brenda zonave të këtyre vendburimeve, distancat e faciliteteve të industrisë hidrokarbure nga këto zona përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e zonave mjedisore e kulturore.*



*Figura 2 Plani i Integruar Sektorial për zhvillimin e prodhimin e hidrokarbureve*


Rr. "Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al

## 2.3 Strategjitë kombëtare për zhvillim

Plani i Përgjithshëm Kombëtar ka përfshirë dhe është mbështetur në strategjitë kombëtare sektoriale. Krahas tyre në zhvillimin e ardhshëm do të merren në konsideratë dhe strategji të tjera të miratuara, në proces hartimi apo rishqyrtimi/përditësimi.

Në vijim jepet një përmbledhje e strategjive kryesore:

- Strategjia Kombëtare e Transportit
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013-2020
- Strategjia Kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020
- Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018-2030
- Strategjia Kombëtare e Ujit (Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027)
- Strategjia e strehimit Social
- Studimi i adaptimit për bujqësinë
- Strategjia Kombëtare e Turizmit 2017- 2020
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020
- Strategjia Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë" 2015-2020
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020

### *Strategjia Kombëtare e Transportit*




*Figura 3. Korridori i Transportit Pan-Evropian në Rajonin e Ballkanit*

Objektivi i Planit Kombëtar të Transportit (ose ANTP2), i financuar nga BE (Bashkimi Evropian) dhe i kryer nga Louis Berger, ishte rinovimi i Planit të parë Kombëtar Shqiptar të Transportit (ANTP1), i cili është hartuar në vitin 2004, me qëllim ofrimin e një vendi të sigurië, të besueshëm, të një sistemi frytdhënës dhe plotësisht të integruar të transportit dhe infrastrukturës në Shqipëri, të cilat do të plotësojnë më mirë nevojat e lëvizjes së mallrave dhe pasagjerëve, duke qenë ekologjikisht dhe ekonomikisht të qëndrueshme. Ky studim synon zhvillimin e nën-sektorëve deri në vitin 2030.

Aktualisht ky plan është në procesin e rishikimit të tij të dytë (ANTP3).

Në ANTP2, së bashku me investimet dhe planet e veprimit është siguruar një strategji për zhvillimin dhe koordinimin për nën-sektorët e transportit. Në mënyrë të veçantë, është siguruar që rrjeti shqiptar i transportit duhet të integrohet në rajonin e Ballkanit dhe në atë Pan-Evropian, duke reflektuar zhvillimin ekonomik dhe parashikimet e trafikut. Mbi të gjitha, Korridori VIII-të është i një rëndësie të madhe për Shqipërinë, pasi ai lidh qytetet kryesore të mëposhtme: Durrës-Tiranë-Shkup-Sofje-Plovdiv-Burgas-Varna-Konstanta, me një gjatësi prej 1,500 km, duke zgjeruar gjithnjë e më shumë bashkëpunimin industrial dhe tregtar në Evropën Juglindore.

Plani Kombëtar i Transportit, evidenton se Rrjeti Rrugor i Shqipërisë është rreth 18'000 km, nga të cilat (i) 3'136 km Rrugë Kombëtare (Autostrada), (ii) 10'500 km Rrugë Interurbane, (iii) 4'000 km Rrugë të tjera. Nga ky rrjet rrugor (i) 1'138 km janë Rrugë Primare që lidhin qendrat kryesore, (ii) 1'998 km janë Rrugë Dytësore.

Objektivi kryesor i këtij studimi është përgatitja e një programi të optimizuar 20 vjeçar të investimeve në infrastrukturë dhe ndryshimeve institucionale/menaxhuese, që do të mundësojnë që rrjeti kombëtar i transportit të arrijë qëllimin e integrimit dhe zhvillimit kombëtar në mënyrën më efikase, duke pasur parasysh kufizimet buxhetore. Detyra e dytë e studimit konsiston në vlerësimin e kapaciteteve aktuale dhe problemeve të institucioneve dhe sistemeve të transportit, për secilin modalitet: transportin rrugor, hekurudhor, portin dhe detar, aeroportet dhe aviacionin civil, rrugët ujore dhe tubacionet.




*Figura 4. Programi i Investimit për Ndërtimin e Rrugëve deri në Vitin 2030*

Plani Kombëtar i Transportit përbëhet nga një sërë investimesh (ose jo investime) për të rritur (ose ulur) kapacitetin e sistemeve të transportit, të kombinuara me masa për të përmirësuar menaxhimin dhe rrjedhimisht produktivitetin e këtyre sistemeve. Të gjitha këto veprime synojnë përmbushjen e kërkesës së parashikuar për transport.

Bazuar në parashikimin e fluksit të trafikut, Plani Kombëtar i Transportit ka rekomanduar ndërtimin e rrugëve të reja deri në vitin 2030, siç paraqitet në Figurën 4.

ANPT3 thekson nevojën për përfundim të rrjetit rrugor kombëtar, studimeve të fisibilitetit për akset e rëndësishme, përafrim të legjislacionit me objektivat e BE, reformim të transportit rrugor, aplikim të standardeve të BE në infrastrukturë dhe


R. "E Kosovarëve", Nd 35, H 6 Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel +3554 2222904 / 2430195, e mail:

vëzhgim i standardëvë tëknike për të rritur sigurinë rrugore. ANTP synon integrimin e mënyrave të transportit, duke mbështëetur mënyra miqësore ndaj mjedisit si hekurudha ose transporti i kombinuar. Përmirësimet në hekurudhë, shikohen si një nga përparësitë e këtij plani.

## *Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013-2020*

Situata e viteve të fundit po tregon që bilanci i energjisë elektrike është mjaft i shtrënguar dhe KESH-i është shndërruar në një importues neto të sasive të konsiderueshme të energjisë elektrike dhe pritet që në vitet e ardhshme të vazhdojë të importojë akoma edhe më shumë për të përballuar nevojat gjithnjë në rritje deri në ndërtimin e centraleve të reja.

Qëllimi i Strategjisë të Energjisë është zhvillimi i një sektori energjitik efektiv që:

- garanton sigurinë e furnizimit me burime energjitike në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti,
- nxit përdorimin eficient, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis ne menyrë të tillë që sektori energjitik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndruesheëm të të gjithë sektorëve ekonomik dhe shoqëror.

*Objektivat specifike të Strategjisë Kombëtare të Energjisë janë:*

1. Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë në furnizimin me energji në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë rajonal;

2. Krijimi i një sektori energjitik të aftë si nga ana financiare ashtu edhe nga ajo teknike;

3. Krijimi i një kuadri efektiv institucional dhe rregullator dhe ristrukturimi i plotë i kompanive të energjisë;

4. Rritja e eficiencës së energjisë, si gjatë prodhimit ashtu dhe gjatë përdorimit të burimeve energjitike, me synim ndotjen minimale të mjedisit;

5. Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjitike duke u mbështetur në konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis;

6. Rritjen e ndjeshme të investimeve në sektorin e energjisë nëpërmjet tërheqjes së kapitalit nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare si dhe të kapitalit privat;

7. Krijimin e një tregu elektrik konkurrues bazuar në kërkesat e Bashkimit Europian për reformimin e sektorit elektroenergjitik (Direktiva 96/92 EU) dhe detyrat e Shqipërisë në kuadrin e Memorandumit të Mirekuptimit të Athinës, (15 Nentor 2002), per integrimin e sektorit elektroenergjitik shqiptar në Tregun Rajonal Energjitik të Europes Juglindore dhe interkonjeksionin me rrjetin e UCTE-së.

- *Ndotja e Mjedisit nga Prodhimi dhe Shfrytëzimi i Burimeve Energjitike*

Prodhimi i lëndëve djegëse ka qenë një nga kontributet kryesorë të ndotjes së mjedisit në vend. Ndotjet e ngurta nga prodhimi i qymyrit dhe naftës, kur këto industri punonin me kapacitet të plotë, llogariteshin mbi 1.5 Mton/vit për 1989 dhe janë zvogëluar afërsisht me 0.2 Mton/vit në 2001.

Mbështetur në analizën e territorit, zonat e rafinerise së Ballshit dhe zona e Patos-Marinzes janë shpallur "zona të nxehta" nga ana e UNEP-it. Probleme të ndotjes së mjedisit janë shkaktuar gjithashtu edhe nga prodhimi i energjisë elektrike. Ndërtimi i HEC-eve shpesh ka çuar në impakte mjedisore lidhur me ndërtimin e rezervuarëve shumë të mëdhenj, humbjen e tokave bujqësore, humbjen e fushave sezonale shumëpjellore, keqësim të përgjithshëm të cilësisë së ujit dhe ndryshimin e mikroklimës në zonën ku janë ndërtuar këto rezervuarë.

- *Strategjia e zhvillimit të rritjes të prodhimit të naftës bruto*

Strategjia Kombëtare e Energjisë mbështet ecurinë e prodhimit të naftës nga vendburimet ekzistuese me një maksimum prodhimi 650 mijë ton në vit deri në vitin 2012 i cili më pas fillon rënien për të arritur në 400 mijë ton në vitin 2015. Investimet në zonat ku operon Albpetroli janë mbështetur në programet e kësaj kompanie, të cilat parashikohen të jenë rreth 25 milion dollarë, ndërsa kompanitë e huaja që operojnë në zonën Patos-Marinëz deri tani investimet kapitale të tyre janë rreth 73 milion dollarë. Gjatë viteve 2003-2004 parashikohej të investohen në sektorin e prodhimit të naftës edhe 220 milion USD. Zonat më të mundshme për zbulim nafte dhe gazi janë ajo e Shpiragut (Sqepurit), Palokastrës në Vlorë, Jugut të Tiranës dhe në Durrës-Kepi i Pallës (në det). Rezervat gjeologjike të naftës në tokë vlerësohen të jenë rreth 260 milion m3 dhe nga këto 54 milion m3 janë të nxjerrshme, deri tani po studohet ana ekonomike e këtyre rezevave ku pritet që për 3 vitet e ardheshme të merren rezultatet. Rezervat gjeologjike të naftës në det vlerësohen të jenë 200 milion m3 dhe nga këto rreth 50 milion m3 janë të nxjerrshme. Zbulimet e deritanishme nuk kanë rezultuar ekonomike, sidoqoftë në vitet në vazhdim do të studiohen disa zona detare për të arritur në konkluzionin përfundimtar mbi vlefshmërinë ekonomike të zonave të detit. Aktualisht janë shpenzuar rreth 350 milion USD për kërkimet në zonat e reja. Kompanitë e huaja operojnë në vendin tonë në bazë të Marrëveshjes me ndarje prodhimi ku në termat e kësaj marrëveshje kompanitë kanë marrë përsipër riskun e investimeve i cili do të rikuperohet në rast zbulimi të vendburimit.

- *Kapacitetet e Prodhimit të naftës*

Treguesit kryesorë që kanë përcaktuar rënien e ndjeshme të nivelit të prodhimit të nxjerrjes së naftës për periudhen 1990-2002 janë:

• Zvogëlimi i ndjeshëm i numrit të puseve të shfrytëzimit në punë.

• Zvogëlimi i ndjeshëm i numrit të puseve ë rinj të shfrytëzimit.

• Pakësimi deri në ndërprerje i punimeve intensifikuese.

• Ulja e ndjeshme e prodhimit të naftës me metodat e veprimit në shtresë.

• Investimet tepër të kufizuara për sektorin e nxjerrjes së naftës.


Rr. "E Kosovarëve", Nd.35, H. 6, Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail. info@atelier4.a

Duke patur parasysh kapacitetet e mundshme të vendburimeve ranore, për të rritur shfrytëzimin e tyre, me datë 05.09.1994 u nënshkrua marrëveshja e hidrokarbureve "Për zonën e Patos-Marinzës dhe Dumresë", ndërmjet kompanisë Albpetrol dhe Kompanive të Huaja të Naftës.




*Figura 5 Harta e Venburimeve dhe e Blloqeve të kërkimit të naftës dhe gazit*

Pas plotësimit, sipas fazave përkatëse, të detyrimeve që rridhnin nga licensa, partnerët kanë hequr dorë nga operacionet e kërkimit në Dumre, kështu që kjo licensë mbetet në fuqi vetëm për vendburimin e Patos-Marinzës. Plani i Zhvillimit të vendburimit Patos-Marinzë paraqet me detaje mënyrën e rehabilitimit dhe zhvillimit të këtij vendburimi nëpërmjet shpimit të 400 puseve të rinj, rritjes së prodhimit nëpërmjet përdorimit të një teknologjie të re dhe investimet e nevojshme për të garantuar fitimet e pritshme. Aktualisht projekti për zonën e Patos-Marinzë ka një ecuri normale ku jane shpuar 20 puse të rinj dhe rezultatet paraqiten premtuese.

## *Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve*

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, jo-bashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri. Strategjia është hartuar për herë të parë në vitin 2010. Drejtimet kryesore të dokumentit të parë të Strategjisë kanë qenë planifikimi, edukimi, kuadri ligjor dhe burimet e financimit.

Strategjinë e rishikuar qe mbulon periudhën 2018-2033[1] ka si qëllim kryesor të përditësojë politikat dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe të rivlerësojë aftësitë e vendit për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) që rrjedhin nga acquis communautaire, Kapitulli 27 për mjedisin. Krahas përmbushjes së synimeve në planin e detyrimeve të antarësimit në BE, dokumenti synon te përshtasë drejtimet strategjike për ti bërë ato me efikase

[1] Draft Strategjia e Menaxhimit të Mbetjeve 2018-2033, në proces miratimi

dhe të realizueshme për zbatuesit e politikave të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi, si në nivelin qendror ashtu edhe atë vendor.

Strategjia përbën rrugën e qasjes për të përmbushur detyrimet specifike që lindin nga Direktiva Kuadër 2008/98 e KE e amenduar, të cilat janë mishëruara më së shumti, por jo plotësisht, në Ligj Nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe teknike të cilat plotësojnë kuadrin rregullator të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri. Nën këndvështrimin e ri, Strategjia do të përbëjë rrugën për të përbushur detyrimet që rrjedhin nga të gjitha ndryshimet në Direktivat e BE mbi mbetjet, përfshirë edhe objektvat ambicioze të Paketës së Ekonomisë Qarkulluese.

Ky dokument strategjik merr parasysh zhvillimet planifikuese dhe infrastrukturore që janë zhvilluar ose që janë në zhvillim në këtë sektor gjatë 7 viteve të fundit që janë kryer si në nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirjen më të madhe që ka biznesi privat dhe investimet që janë bërë në nivelin e grumbullimit, transferimit dhe veçanërisht të trajtimit të mbetjeve.

Vizioni i përgjithshëm i strategjisë dhe planit të menaxhimit të mbetjeve 2018 – 2033 eshte "Krijimi i një kuadri strategjik dhe rregullator në Shqipëri, për të ulur sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet e gjeneruara në linjë me objektivat e Direktivës Kuadër të Mbetjeve të BE dhe marrëveshjet ndërkombëtare".

Koncepti i menaxhimit të mbetjeve synon arritjen e ojektivave dhe treguesëve në respekt të zbatimi të hierarkisë së mbetjeve. Koncepti i menaxhimit të mbetejve do të bazohet mbi Zonën e Mbetjeve në respekt të parimeve bazë për menaxhimin e mbetjeve duke përfshire, por duke mos u kufizuar në:

- Parimin e afërsisë dhe përballueshmërisë,
- Parimin ndotësi paguan;
- Parimin e zgjeruar të prodhuesit të mbetjeve;
- Parimi i zbatimit të teknologjisë më të mirë të mundëshme

Zona e Mbetjeve është një territor i mbuluar nga juridiksioni i një osë më shumë bashkishë, të cilat karakterizohen nga tipologji gjeografike e ngashme dhe që siguron një rrjeto rrugor komunikimi të pandërprere që lehtëson mbledhjen dhe transportin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit (stacionet e transferimit) në desinacionet e trajtimit paraprak dhe përfundimtar të mbetjeve në përputhje me parimin e afërsisë dhe përballueshmërisë.

Zona e Mbetjeve përfaqëson njësinë bazë për planifikimin e menaxhimit të integruar të mbetejve. Kufijtë e Zonës së Mbetjeve përcaktohen paraprakisht nga Master Plani për menaxhimin e integruar

të mbetjeve. Kufijtë përfundimtar të Zonës së Mbetjeve janë subjekt dhe përcaktohen definitivisht bazuar mbi përfundimet e një Studimi Fizibilitieti.

Zona e Mbetjeve e përcaktuar nga Studimi i Fizibilitetit miratohet nga këshillat bashkiake të njësive që bëjnë pjesë në të dhe ligjërohen nga autoriteti përgjegjës (potencialisht nga Këshilli i Ministrave pasi ka janë pranuar nga ministritë përgjegjëse për mjedisin dhe infrastrukturën.

Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve: 1) Parandalimi (i gjenerimit të mbetjeve); 2) Ripërdorimi; 3) Riciklimi; 4) Rikuperimi; dhe 5) Asgjësimi i mbetjeve. Strategjia merr parasysh dhe rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve sipas parimit të ekonomisë qarkulluese për të mundësuar mbrojtjen sa më të plotë të burimeve natyrore dhe rritjen e efiçencës së përdorimit të produkteve.

*Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020*

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020, përbën një nga dokumentet më të rëndësishme në fushën e mjedisit. Vizioni i strategjisë është: "Shqipëria, një vend me një zhvillim të qëndrueshem social dhe ekonomik, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre dhe duke promovuar vlerat mjedisore e duke i vendosur ato në perfitim të prosperitetit ekonomik". Ky vizion mbështetet në parimin e zhvillimit të integruar ku mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së mediumeve mjedisore garanton sigurinë e rritjes ekonomike dhe mirëqënien sociale.

Përsa i përket mbrojtjes së mjedisit, politikat mjedisore gjatë periudhës 2015 -2020 do të fokusohen në menaxhimin qendrueshem të mjedisit nëpërmjet:

- Përmirësimit të cilësisë dhe reduktimin e ndotjes së ajrit dhe ndotjes akustike në zonat kryesore urbane dhe zonat turistike;
- Parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes dhe rreziqeve nga ndotja dhe aksidentet industriale duke monitoruar dhe kontrolluar zbatimin e normave dhe standarteve të shkarkimeve në mjedis nga operatorët industrialë;
- Kryerjes së vlersimeve të ndikimit në mjedis për projektet e zhvillimit, si dhe përfshirjen e publikut dhe të gjithë aktorëve gjatë procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- Kryerjes së vlerësimeve strategjike mjedisore për planet apo programet, për vlerësimin e pasojave në mjedis të një plani ose programi të propozuar për zbatim, me qëllim që të sigurojë që këto pasoja mjedisore të adresohen plotësisht që në fazat e hershme të vendimmarrjes përkrah konsideratave ekonomike dhe sociale.
- Menaxhimin e integruar të mbetjeve me fokus në përmbushjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombetare, trajtimin e mbetjeve brenda këtyre standardeve dhe rritjen e ndërgjegjes sociale mbi efektet e dëmshme të mbetjeve në mjedis.
- Ngritjes së sistemit kombëtar të menaxhimit të kimikateve;

- Mbrojtjes dhe menaxhimit te qëndrueshëm të biodiversitetit, shtimit të sipërfaqes së zonave të mbrojtura, menaxhimin e integruar të tyre dhe ngritjen e rrjetit ekologjik "natura 2000";
- Mirë menaxhimin e burimeve ujore nëpërmjet vendosjes së një kuadri monitorimi dhe kontrolli, për të reduktuar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe siperfaqësore
- Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla të ujërave detare dhe të ujërave të brendshme;
- Zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë-funksional të burimeve pyjore dhe kullosore.

*Parashikimet dhe objektivat kryesorë referuar strategjive kombetare sektoriale per ujin*

*Programi Kombëtar Sektorial për Ujin dhe Strategjia e Ujit (Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027)*

Objektivat kryesorë që synohet të arrihen deri në vitin 2030 nga implementimi i PKSU në lidhje me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve janë: *"Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të popullsisë me synim mbulimin me shërbim të sigurtë dhe të vazhdueshëm", ku për zonën urbane llogaritet mbulim në masën 98% dhe për zonën rurale në masën 72% për vitin 2030.* Në territorin e planifikimit mbulimi i zonës urbane aktualisht është mbi 90 % dhe synimi i programit është i arritshëm brenda dy fazave të para të planifikimit, kurse për sa i përket mbulimit të zonës rurale në masën 72% do nevojitet një shtrirje në investime në të gjithë fazat e planifikimit.

*"Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të përdorura me synim mbulimin me shërbimin të zonave urbane dhe rurale", ku për zonën urbane llogaritet mbulim në masën 71% dhe për zonën rurale në masën 28% për vitin 2030.* Në territorin e planifikimit mbulimi i zonës urbane aktualisht është mbi 60 % dhe synimi i programit është i arritshëm brenda tre fazave të para të planifikimit, kurse për sa i përket mbulimit të zonës rurale në masën 28% do nevojitet një shtrirje në investime në të gjithë fazat e planifikimit.

***Strategjia e Kombëtare e Ujit (MIBU) synon këto objektiva kryesore:***

*Objektivat e politikave që lidhen me sasinë e ujit*

Ky objektiv strategjik ka të bëjë me sasinë e ujit dhe, si rrjedhojë, edhe me shpërndarjen e ujit ndërmjet përdoruesve. Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni kërkon aftësi profesionale për hartimin dhe zbatimin e Planeve të Menaxhimit të Basenit Ujor, që synojnë përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes së ujit, marrjen e masave për mbrojtjen e tij si dhe marrjen parasysh të ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Aftësia për t'i bërë ballë ndryshimeve klimatike mund te shihet edhe si aftësi e sistemit për të përballuar pasojat që vijnë nga ndryshimet klimatike dhe për të ruajtur funksionet e tij, ndërkohë që përshtatet, riorganizohet dhe zhvillohet.

**Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni ujor:** Një ndër parimet kryesore të MIBU-së është menaxhimi i burimeve ujore në nivelin e duhur brenda sistemeve të integruara të menaxhimit të

baseneve me qëllim që të reflektohen kushtet vendore. Ekzistenca e gjashtë këshillave dhe agjencive të baseneve ujore përbën një bazë të shëndoshë që respekton këtë parim. Megjithatë, aktualisht autoritetet nuk kanë kapacitetet që u nevojiten për menaxhimin e burimeve ujore në mënyrë të integruar dhe që i bën ballë ndryshimeve klimatike.

**Masat për përballjen me ndryshimet klimatike:** Në sektorin e ujit, masat që duhen marrë për periudhën 2018-2020 për përballjen me ndryshimet klimatike në të cilat përfshihen edhe masat për arritjen e barazisë gjinore, në bazë të kritereve kosto-efikase, duhet të lidhen si me cilësinë ashtu dhe me sasinë e ujit. Kjo do të arrihet nëpërmjet një procesi gjithpërfshirës zbatimi i të cilit nevojitet që të përfundojë në fund të vitit 2027 dhe të përfshirë të gjitha institucionet që kanë lidhje me ujin në nivelin qendror, rajonal dhe vendor.

**Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes së ujit (infrastruktura) dhe masat për ruajtjen e tij:** Infrastruktura e ujit përfshin projekte të cilat janë të nevojshme për të siguruar që uji është në dispozicion për periudhën e kërkuar, në sasinë e duhur, me cilësinë e duhur, i shpërndarë në vendin e duhur, tek përdoruesit e regjistruar dhe që paguajnë. Elementet e infrastrukturës përfshijnë rezervuare, stacione pompimi, kanale dhe tubacione shpërndarëse, punime për ujitje, impiante trajtimi dhe punime për ruajtjen nga përmbytjet. Kostot dhe përfitimet që vijnë nga infrastruktura e ujit kanë ndikime sociale dhe mjedisore të cilat nuk kufizohen në një sektor të veçantë. Gjatë periudhave të ndryshimeve klimatike, rehabilitimi/rindërtimi i sistemeve të mbrojtjes nga përmbytjet, si argjinaturat lumore ose detare dhe rritja e sigurisë së tyre është e domosdoshme. Me qëllim rritjen e efikasitetit në përdorim, konservim, riciklim dhe ripërdorim të ujit, menaxhimi i kërkesës për ujë do të shtjellohet me në thellësi.

**Shpërndarja e barabartë e përfitimeve:** Për të shmangur pabarazitë në varfëri, mirëqënie dhe ndërmjet gjinive në zonat e baseneve, nevojitet një analizë e dallimeve sociale dhe gjinore lidhur me aksesin, kontrollin dhe përdorimin e burimeve ujore, ndërsa përcaktohen skenarët e zhvillimit të basenit.

<u>*Objektivat e politikave për cilësinë e ujit*</u>

Ky objektiv strategjik merret me cilësinë e ujit, që ndikon përdorimin e ujit dhe si pasojë ka ndikime socio-ekonomike. Cilësia e ujit në shtetet anëtare përcaktohet në nenin 1 të Objektivës Kuadër të Ujit, që pohon se "qëllimi i kësaj direktive është krijimi i një kuadri për mbrojtjen e ujrave sipërfaqësore të brendshme, ujrave të përkohshme, ujrave bregdetare dhe atyre nëntokësorë.

**Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni ujor:** Një nga parimet kryesore të MIBU-së është menaxhimi i burimeve ujore në nivelin e duhur brenda sistemeve të integruara të menaxhimit e baseneve me qellim që të mbahen parasysh kushtet vendore. Ekzistenca e gjashtë këshillave dhe autoriteteve të baseneve ujore është një bazë e shëndoshë. Duke patur parasysh cilësinë e ujit, në vitin 2018 duhet të zhvillohen dy PMBU-të bazë, që përcaktojnë përparësi dhe kritere të qarta për

përdorimin e ujit duke u bazuar në kushte specifike të secilit basen, që bëjnë të mundur monitorimin sipas parimeve të DKU-së dhe i hapin rrugën zhvillimit të PMBU-ve të mbetura.

**Përcaktimi i masave për përballjen me ndryshimet klimatike:** Duke pasur parasysh cilësinë e ujit, në Programet e Masave për secilin PMBU është parashikuar "kontroll i klimës". Qëllimi i përgjithshëm i kontrollit klimatik është të garantojë se PM-të janë përshtatur mjaftueshëm për ndyshimet e ardhshme klimatike.

**Përcaktimi i statusit "cilësi e mirë e ujit":** Pas vitit 2018, Inspektoriatet Mjedisore do të jenë institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e standardeve të reja të cilësisë së ujit në të gjithë vendin, me mbështetjen e autoriteteve të baseneve ujore.

*Objektivat e politikave lidhur me rreziqet që vijnë nga uji*

**Sigurimi i mbrojtjes nga përmbytjet:** Mbrojtja ndaj përmbytjeve në shtetet anëtare (kandidate) përcaktohet nga Direktiva e Përmbytjeve (DP) e cila u miratua në vitin 2007. Kjo direktivë ka si qëllim të ulë pasojat e dëmshme për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe të aktiviteteve ekonomike që vijnë si pasojë e përmbytjeve. Kjo përfshin përmbytjet si nga lumenjtë ashtu edhe nga deti, por jo përmbytje nga rrjeti i kanalizimeve.

**Përgatitja për përballje me thatësirat dhe kufizimet e ujit:** Thatësirat janë me origjinë natyrore ndërsa pamjaftueshmëria e ujit përkufizohet si një situatë ku burimet ujore janë të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat afatgjata për përdorim të ujit. Planifikimi për t'i bërë ballë thatësirave dhe menaxhimi i sasirave të pakta të ujit është një ndërthurje e ndërlikuar e monitorimit të tendencave hidro-meteorologjike me menaxhimin teknik të burimeve ujore dhe lehtësimin e ndikimeve socio-ekonomike.

**Plane kontrolli dhe masa për përballjen me ndryshimet klimatike:** Përsa i përket rrezikut nga uji, kryerja e një "kontrolli klimatik" për Programet e propozuara të Masave është shumë e rëndësishme. Qëllimi i përgjithshëm i kontrollit klimatik është të sigurojë se PM-të janë përshtatur mjaftueshëm ndaj kushteve klimatike të ardhshme.

*Objektivat e politikave lidhur me informacionin për ujin*

**Përcaktimi i rrjetit të monitorimit të ujit:** Një nga strategjitë e zakonshme për zbatimin e Objektivën Kuadër të Ujrave është zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi të përshtatshëm monitorimi i cili mbledh dhe analizon të dhënat në mënyrë të tillë që të sigurojë kryerjen e planifikimit dhe menaxhimit të sistemeve ujore në mënyrë efikase dhe duke kërkuar kështu një inventar gjithpërfshirës të burimeve ujore.

**Nxitja e kërkimeve shkencore:** Lehtësimi i një sistemi kërkimor dhe ndërtimi i kapaciteteve që kërkohen për të zhvilluar bazën e dijeve.


Rr. "E Kosovarëve", Nd 35, H 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2272804 / 2430195, e-mail:

**Përmirësimi i aksesit në informacion dhe i prodhimit të të dhënave:** Ky program mundëson zhvillimin e ndërfaqeve të përdoruesve që mund të shkëmbejnë nivele të ndryshme informacioni, në varësi të nevojave të grupeve te interesit.

**Krijimi i një kuadri institucional të përshtatshëm për ujin dhe klimën:** Të dhënat edhe analiza e mangësive të informacionit na cojnë në përfundimin se funksionet e menaxhimit të burimeve ujore që aktualisht janë të shpërndara ndërmjet institucioneve të ndryshme duhet të centralizohen dhe të vendosen nën ombrellën e një institucioni të vetëm kombëtar, një autoritet kombëtar ose agjenci e burimeve ujore me degë në nivel baseni ujor dhe vepron në mënyrë të pavarur nga institucionet e tjera.

*Objektivat e politikës lidhur me menaxhimin e ujit*

**Përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësive në MIBU:** Përcaktimi i Kuadrit Komunitar për Veprim në Fushën e Politikës së Ujërave, i ndryshuar me direktivën 2008/105/EC. Nevoja për studime në lidhje me zhvillimin institucional duhet t'i japë përparësi hartimit të ligjeve, në veçanti atyre që lidhen me dicka komplekse si Direktiva Kuadër e Ujit.

**Zbatim i plotë i parimeve të BE-së për ujin dhe mjedisin:** Duhet theksuar se harmonizimi ligjor është i arsyeshëm vetëm nëse vendi ka burime për të zbatuar me efikasitet legjislacionin përkatës. Duke pasur parasysh dicka te tillë, fazat e mëposhtme të harmonizimit të legjislacionit duhet të jenë të përshtatshme, pa vendosur në këtë fazë afate që mund të ndikojnë rezultatin e negociatave me BE-në.

**Arritja e zhvillimit të kapaciteteve:** Për të arritur këtë, pritet që një gamë e madhe programesh dhe materialesh trajnimi do të zhvillohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, me mbështetjen e konsulentëve, nëse është e nevojshme, duke u bazuar mbi Propozimin për Zhvillimin e Kapaciteteve të krijuar në Projektin Burimet Ujore dhe Ujitja. Ofrimi i kurseve të trajnimit mund të shihet si një proces shumë vjecar, i paraprirë nga një vlerësim vjetor i nevojave për trajnim.

*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020;*

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, është dokumenti kryesor në shkallë kombëtare që orienton veprimtarinë e administratës publike deri më 2020. Për të arritur vizionin dhe objektivin primare, "anëtarësimin në Bashkimin Europian", qeveria shqiptare orientohet nga 6 prioritet që prekin fusha të ndryshme si,

(1) shërbime publike inovatore, që kanë në qendër qytetarin (qeverisja e mirë);
(2) rimëkëmbja dhe konsolidimi financiar i sektorit të energjitikës (energjia);
(3) nxitja e novacionit dhe konkurrueshmërisë (investimet e huaja direkte dhe të brendshme);
(4) menaxhimi i integruar i ujit;
(5) menaxhimi i integruar i tokës ; dhe

(6) reforma strukturore financiare.

Nga pikëpamja territorial dhe e planifikimit, "Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020" vendos theksin mbi përdorimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin territorial përmes menaxhimit të integruar të ujit energjinë, menaxhimin e integrua të tokës, mirëqeverisja, zhvillimin e kapitalit njerëzor, konkurrueshmërinë, stabilitetin ekonomik dhe fiskal etj.

Krahas aspekteve territoriale, të cilat detajohen dhe në planin kombëtar, Strategjia kombëtare vendos theksin dhe në zhvillimin e shërbimeve, mirëqeverisjes, dhe eficencës financiare. Për këtë arsye, janë ndërmarrë nisma të ndryshme, qoftë nga pikëpamja ligjore, qoftë nga pikëpamja e eficencës institucionale dhe administrative. Në kuadër janë ndërmarr nisma të ndryshme si në kuadrin ligjorë ashto dhe në kuadrin institucional, për shembull përmirësimi i sistemit buxhetor dhe krijimi I instrumenteve të standardizuara të hartimit të buxhetit afatmesëm është një nga elementët kryesor në përmirësimin e strukturës financiare.

Në këtë kontekst objektivat dhe fushat e veprimit të përcaktuara në këtë strategji kanë orientuar dhe strategjitë, dokuementet dhe programet sektoriale dhe ndërsektoriale të institucioneve të administratës publike.

*Strategjia Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë" 2015-2020*

Strategjia Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë" 2015-2020, është një nga dokumentet strategjik kryesor që orienton zhvillimin, drejtë *"Një shoqërie e bazuar në dije dhe informacion, nëpërmjet konsolidimit të infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike online dhe rritjes së transparencës së qeverisjes."*.[2] Falë këtij vizioni dhe nga objektivat e përcaktuar në këtë strategji, vendoset theksi në nevojën për të zhvilluar eficencën institucionale falë dixhitalizimit. Zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të brendshëm, integrimi i tyre me sistemet e qendërzuar, dhe harmonizimi i strukturave institucionale dhe rrjedhës së punës, janë elementët kryesorë drejtë përmirësimit të shërbimeve, transparencës, ndërveprimit të shpejt dhe efektiv, mirëqeverisjes, reduktimit të korrupsionit etj. Projekti STAR II është një nga shembujt kryesor që mbështet zhvillimin e dixhitalizimit në shkallë lokale, për shkak se ofron një mbështetje të rëndësishme në zhvillimin e funksionimit bashkiak, falë një sistemi të brendshëm që strukturon në mënyrë eficente funksionet e ndryshme të bashkisë. Mbështetur në Teknologjinë e komunikimit dhe informacionit, synohet një funksionim më eficent i të gjitha strukturave të pushteti qendror dhe lokal.

*Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020*

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020; është një tjetër dokument strategjik i cili synon të përkthej vizionin kombëtar në shkallë lokale, duke marrë në

[2] Strategjia Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë" 2015-2020;

konsideratë rolin dhe funksionet bashkiakë në përmbushjen e objektivit madhor "anëtarësimin në Bashkimin Europian". Reforma administrative, përmirësimi i strukturave të qeverisjes vendore, Decentralizimi fiskal, Ndarja e qartë e funksioneve (funksionet e pushtetit lokal, funksionet e përbashkëta dhe funksionet e deleguara), zhvillimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore, roli i qeverisjes vendore në Integrimin evropian, renditen si aspektet kryesore në të cilat do të fokusohet veprimi i pushteti publik. Ndarja e re territoriale ka qënë një nga veprimet e para të ndërmarra në këtë kuadër.

Në një këndvështrim të përgjithshëm, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe të gjitha strategjitë, dokumentet dhe programet sektoriale dhe ndërsektoriale të institucioneve të administratës publike, janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të këtij plani.

## *Strategjia e Strehimit Social*

Politika e Strehimit Social zbatohet në Njësitë e Qeverisjes Vendore në përputhje me Strategjinë e Strehimit Social[3]. Qëllimi i strategjisë është përmirësimi i kushteve të jetesës të 25,000 familjeve shqiptare me të ardhura të ulëta dhe të mesme, që nuk mund të përballojnë një shtëpi në tregun e lirë, duke përfshirë familjet në pozita të pafavorizuara, të cilat banojnë në zonat urbane dhe rurale që vuajnë nga përjashtimi social përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.

Prioritetet strategjike të Strategjisë Kombëtare të Strehimit janë[4]:

1. Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave rreth strehimit social;
2. Përmirësimi i qasjes në strehim të grupeve të pafavorizuara;
3. Rritja e numrit të përfituesve në pozita të pafavorizuara përmes zgjerimit të instrumentave financiare;
4. Sigurimi i strehimit të përballueshëm nëpërmjet zgjerimit dhe riorientimit të programeve të strehimit social.

Buxheti i nevojshëm i parashikuar sipas strategjisë së strehimit për periudhën 2016-2025 për 61 njësitë vendore rreth [41.2 milion euro] është i orientuar kryesisht:

1. Zhvillimi i programeve të ndryshme për strehimin e grupeve në pozita të pafavorizuara me një buxhet rreth 15.8 milion euro;
2. Zhvillimi i subvencioneve të ndryshme dhe granteve për strehimin e grupeve të mesme dhe grupeve në pozita të pafavorizuara në 61 njësitë vendore [buxheti i nevojshëm 25.4 milion euro].

Gjithashtu, objektiva dhe aktivitete që lidhen me strehimin social në nivel Njësie Qeverisje Vendore janë përfshirë dhe në disa dokumenta të tjerë politike të hartuara nga MMSR[5], si në skemë.




[3] Miratuar me VKM Nr. 405, datë 1.6.2016, 'Për miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016–2025'
[4] Strategjia e Strehimit Social, Fletore Zyrtare nr. 100
[5] Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

MZHU[6] ka hartuar ligjin e ri për programet sociale të strehimit, 6 programe sociale të strehimit të parashikuara për t'u zbatuar nga 61 NJQV[7] të tjera janë:

a. Programin e banesave sociale me qira [BSQ];
b. Programin për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese ose të përmirësimit të kushteve, deri në një ndërtim të ri;
c. Programin e banesave me kosto të ulët [BKU];
d. Programin për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;
e. Programin për krijimin e strehave të përkohshme;
f. Programe për ndërtimin e banesave të specializuara.

Bazuar në ligjin 22/2018 "Për strehimin social", përfitojnë strehim 24 kategori të cilat nuk i kanë mundësitë e sigurimit të një banese të re. Kështu do të përfitojnë nga programet sociale: personat me aftësi të kufizuar; punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH); punonjësit e repartit RENEA; viktimat e dhunës në familje; viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit; anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian; të miturit në konflikt me ligjin, pas ekzekutimit të dënimit; vajzat nëna; familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve; përfaqësues të LGBT; individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç; familjet që nuk u janë legalizuar shtëpitë për shkak të vendit ku kanë ndërtuar; personat e pastrehë që kanë mbetur si rezultat i fatkeqësive natyrore; familjet e policëve të vrarë në krye të detyrës; familjet që nuk disponojnë banesë në pronësi apo që banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi; familjet ose individët që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor; familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna; të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore; familjet me më shumë se katër fëmijë; bashkëshortët, mosha e përgjithshme e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.

## *Studimi i adaptimit për bujqësinë*

Nga studimi i adaptimit për bujqësinë janë arritur disa mundësi dhe sfida për sektorin e agrikulturës në Shqipëri, duke marrë në konsideratë ndryshimet klimaterike:

- *Temperatura do të rritet dhe rreshjet do të bëhen më të luhatura në Shqipëri, si rezultat i ndryshimeve klimatike.* Këto rezultate janë në përputhje me ndryshimet e fundit klimaterike në Shqipëri dhe do të vazhdojnë të rriten me kalimin e dekadave të ardhshme;

[6] Ministria e Zhvillimit Urban
[7] Njësitë e Qeverisjes Vendore

- *Efektet e temperaturës dhe rreshjeve nga ndryshimet e ardhshme klimaterike mbi kulturat bujqësore janë të përziera.* Ndryshimi i klimës parashikohet të ketë potencial për të përmirësuar rendimentet e grurit (nëse dëmtimi insekteve nuk rritet) dhe jonxhës së ujitur, për të reduktuar prodhimet e rrushit dhe ullirit, dhe të ketë efekte relativisht modeste në të lashtat e tjera të studiuara. Këto rezultate janë prezantuar për fermerët shqiptarë dhe ata pajtohen se këto efekte janë në përputhje me përvojën e tyre. Disa ekspertë shqiptarë kanë vënë në dukje, se rënia e kohëve të fundit në rendimentet e grurit mund t'i atribuohet rritjes së dëmtuesve të kësaj kulture;
- *Fermerët në Shqipëri janë përshtatur në mënyrë joadekuate me klimën e tanishme; ky efekt njihet si deficiti i përshtatjes, i cili është i konsiderueshëm në Shqipëri.* Si rezultat, shumë nga masat e përshtatjes klimatike të identifikuara në këtë studim mund të kenë përfitime të menjëhershme në përmirësimin e rendimenteve, si dhe përmirësimin e elasticitetit ndaj ndryshimeve të ardhshme klimatike;
- *Burimet e ujit janë të bollshme në Shqipëri dhe do të vazhdojnë të jenë edhe gjatë 2050, duke marrë në konsideratë një gamë të gjerë të skenarëve të mundshëm të ndryshimeve klimatike.* Në shumë raste, trajnimi fermerëve është i nevojshëm në Zonat e Ndërmjetme dhe Ultësirat Agro-Ekologjike (ZNUAE), për të siguruar përdorimin më efikas të ujit gjatë sezoneve të thata dhe investimi shtesë është i nevojshëm në këto rajone në ujitje dhe në infrastrukturën e ruajtjes së ujit, për të përfituar në mënyrën më nga këto burime ujore në sektorin bujqësor. Për më tepër, përmirësimi i kapaciteteve të sistemeve të kullimit është i nevojshëm për të shmangur dëmtimet nga përmbytjet. (Këto rezultate janë konfirmuar nga fermerët);
- *Efektet direkte të ndryshimeve klimatike në sektorin e blegtorisë, veçanërisht tek viçi, pula, madje edhe delet, mund të jenë negative.* Metodat për të matur me saktësi këto efekte, për momentin nuk janë të zbatueshme në Shqipëri, mund të thuhet se ndryshimet në temperaturë do të bëhen gradualisht me kalimin e kohës. (Fermerët kanë konfirmuar se ende nuk kanë vënë re ndikim në blegtori për shkak të ndryshimeve klimaterike).
- *Përshtatja në nivel kombëtar dhe rritja e kapaciteteve është një prioritet i lartë.* Ndërsa rënia e deficitit të përshtatjes në sektor është një proces afatgjatë, ka disa masa që mund të ndërmerren menjëherë për të përforcuar kapacitetet e përshtatjes në sektor. Këto përfshijnë: zgjerimin e kapacitetit të shërbimeve; përmirësimin e ofrimit të parashikimeve afatshkurtra dhe afatgjata të meteorologjisë për fermerët; inkurajim të konsolidimit të tokës bujqësore në struktura më të mëdha për të lehtësuar më shumë investime të konsiderueshme për teknologji të fermave; dhe inkurajim të sektorit privat për t'u përshtatur me ndryshimin e klimës.
- *Studimet duhet të kryhen në nivel kombëtar për të pozicionuar dhe vlerësuar në mënyrë më specifike përshtatshmërinë e kulturave bujqësore dhe funksionalitetin e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve të kullimit, në veçanti në zonat e prirura të përmbytjeve, dhe duhet të merren parasysh standardet e reja të kapaciteteve të sistemeve të kullimit.* Përmirësime të


Rr. "T Kosovarëve", Nd 35, H. 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë. Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al

tjera të kapaciteteve institucionale duhet të fokusohen në identifikimin e farërave të varieteteve tolerante ndaj thatësirës dhe llojshmëria e bagëtive tolerante ndaj temperaturës, në tregun ndërkombëtar për përshtatjte në Shqipëri, si dhe trajnimi i fermerëvë në përdorim më efikas të ujit dhe për të përdorur parashikimit e ri afatshkurtër të motit.

- Në ZNUAE dhe në ferma, masat me prioritet të lartë për përshtatje përfshijnë përmirësimin e sistemit të kullimit [në Zonat e Ndërmjetme dhe Ultësira], rehabilitimin e kapaciteteve të mesme të ujitjes [Ultësira], duke optimizuar përdorimin e ujit [të gjitha ZNUAE], duke siguruar varietete farërash më të përshtatshme për klimën dhe mundësinë për të kuptuar efektivisht rendimentet e tyre të larta [të gjitha ZNUAE]. Përmirësimi i kapaciteteve të sistemit të kullimit është metoda më efektive për të përmirësuar çështjet që lidhen me përmbytjet. Të gjitha këto masa, kanë raporte të lartë përfitim-kosto dhe janë të favorizuara nga fermerët shqiptarë.

### *Strategjia Kombëtare e Turizmit*

Nisur nga rëndësia e sektorit turistik në zhvillimin ekonomik të vendit, ministria e linjës për turizmin ka hartuar një draft Strategji për zhvillimin e Turizmit për 5 vitet e ardhshme (2017-2022).

Nga analiza e sektorit, Strategjia Kombëtare e Turizmit propozon vizionin strategjik të mëposhtëm:

*"Shqipëria do të njihet si një destinacion turistik tërheqës, autentik dhe mikpritës në rajonin e Mesdheut dhe Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike, të arritshme lehtësisht nga tregjet ndërkombëtare. Turizmi luan një rol kryesor në ekonominë shqiptare, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe duke krijuar një mjedis tërheqës për investimet."*[8]

Ky vizion do të zbërthehet në tre objektiva kryesorë:

- **Objektivat ekonomikë** që synojnë: rritjen e PBB-së; përmirësimin e tregut të punës; kualifikimin e forcës punëtore; rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tatimet; rritjen e të ardhurave nga transporti i udhëtarëve; rritja e numrit të bizneseve; rritjen e investimeve publike dhe private; etj.
- **Objektivat cilësorë** që synojnë: zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit; zhvillimin e produkteve turistike; zhvillimin e infrastrukturës; informimin dhe orientimin e vizitorëve; përmirësimin e imazhit turistik kombëtar; përmirësimin e cilësisë së jetës; mbrojtjen e mjedisit; etj.
- **Objektivat strukturorë** që synojnë: të rrisin qëndrimin e vizitorëve në territor; orientimin e ofertës drejt segmenteve turistike potenciale; diversifikimi i produkteve turistike; përmirësimi i cilësisë; rritja e numrit të kapacitetit pritës; rritja e strukturave akomoduese në zonat rurale; zhvillimi i strukturave akomoduese kamping dhe strukturave akomoduese familjare, etj.

Këto tre objektiva do të fokusohen në drejtime të ndryshme strategjike, si:

[8] Draft "Strategjia e Zhvillimit të turizmit 2017-2022"

- Marketingu (promovimi i produkteve turistike, integrimi i teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit, etj.);
- Produkti turistik (zhvillimi i produkteve kryesore si: turizmi bregdetar, kulturor, natyror, shëndetësor dhe biznesit dhe konferencave.);
- Burimet njerëzore (krijimi i strukturave të formimit profesional dhe trajnimit për forcën punëtore dhe për komunitetet lokale.);
- Investimet (rritja e investimeve strategjike, përmirësimi i klimës së investimit, përthithja e investimeve private, etj.)
- Menaxhimi i procesit të implementimit të strategjisë së turizmit.

Nga një analizë e thelluar e situatës aktuale dhe potencialit të ardhshëm të sektorit të turizmit, Draft Strategjia Kombëtare e Turizmit (2017-2022) evidenton 5 produkte turistike kryesore:

- Turizmi Bregdetar:
  - Turizmi i diellit dhe detit;
  - Turizmi detar/ marinave;
- Turizmi i Kulturës:
  - Historik/ arkeologjik;
  - Trashëgimia kulturore;
  - Fetar;
  - Kulinari;
  - Folklor;
  - Art;
- Turizmi i Natyrës:
  - Malor;
  - Rural;
  - Ekoturizmi;
  - Aventurës;
  - Agriturizmi;
- Turizmi shëndetësor:
  - Turizmi i ujërave termale (SPA);
  - Turizmi mjekësor;
- Turizmi i konferencave/biznesit.

Specializimi i destinacioneve në produktet turistike specifike, të cilat bazohen në avantazhet konkurruese, ka për efekt të orientojë destinacionet drejt segmenteve të caktuara turistike. Në shkallë kombëtare, specializimi i destinacioneve, ka për efekt rritjen e numrit të turistëve dhe zgjerimin e segmenteve kryesore që do të frekuentojnë Shqipërinë. Segmentet e synuara nga Strategjia Kombëtare e Turizmit do të fokusohen në: Moshat e reja (18 deri 24 vjeç); Çiftet pa fëmijë dhe me të ardhura të dyfishta; familjet; Çiftet me moshë 50 – 65 vjeç, të cilët jetojnë më vete nga fëmijët e tyre; mosha e tretë; organizatorët e specializuar të udhëtimeve turistike.

## 2.4 Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare



*Figura 6. Çështjet e rëndësisë kombëtare*

Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësisë kombëtare, sipas përcaktimeve të nenit 7 dhe 9 të ligjit Nr. 107/2014 PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT dhe nenit 30 dhe 31 të VKM 686 datë 22.11.2017 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT", përcaktohen nga planet kombëtare dhe/ose me miratim të KKT-së, përfshirë ato të shpallura me vendim të Këshillit të Ministrave.

Çështjet e rëndësisë kombëtare në territorin e Roskovecit grupohen në:

- Zona të mbrojtura:
    - Zonat e mbrojtura historike
    - Zonat e mbrojtura natyrore
- Në objekte të veçanta:
    - Monumente kulture
    - Monumente natyre
- Objekte të një rendësie të veçantë, subjekt leje nga KKT
- Në rrjete dhe struktura infrastrukturore:

Gjatë hartimit të PPV-së zonave të listuara më lart mund t'i shtohen çështje dhe zona të tjera si rezultat i aplikimit të strategjisë territoriale.

Ndër elementët e rëndësisë të veçantë në Roskovec listojmë:

*Zonat e Mbrojtura Natyrore*

Në bashkinë e Roskovecit nuk ka zona të mbrojtura natyrore apo monumente natyre.

*Zonat e Mbrojtura të Trashëgimisë Kulturore*

Monumentet e kulturës në Bashkinë Roskovec janë detajuar në kapitujt në vijim.

*Industria e rëndë nxjerrëse*

Bashkia e Roskovecit është e pasur me rezerva hidrokarburesh, naftë dhe më pak gaz natyror. Ky resurs shfrytëzohet masivisht në Marinëz, Njësia Administrative Kuman dhe në Jagodinë, Njësia Administrative Roskovec. Aktualisht për nxjerrjen dhe përpunimin e hidrokarbureve operojnë në këtë zonë dy kompani: kompania shtetërore "Albpetrol" sh.a. dhe "Bankers Petroleum Albania" LTD.

*Infrastrukturë*

Aksi kryesor kombëtar që përshkon, territorin e Bashkisë Roskovc, nga kthesa e fshatit Marinëz , deri në fshatin Velmish, është aksi Fier-Berat. Sot ky aks ndodhet në një gjendje jo të mirë nga Roskoveci deri në daljen nga kufijtë e Bashkisë. Kjo përbën ndoshta edhe rrugën më të rëndësishme të zonës pasi të gjitha institucionet publike janë orientuar drejt saj, apo drejt rrugëve që kanë akses në këtë aks. Aktualisht për rikonstruksionin e këtij aksi ekziston një projekt nga ARRSH.

Infrastruktura e ujitjes – Rezervuarët

Hidrografia në territorin e Bashkisë Roskovec përbëhet nga :

- Këneta e Zezë;
- Rezervuari i Kurjanit, i cili furnizohet nga Përroi i Kurjanit dhe Përroi i Cukalatit;
- Rezervuari i Ngjeqarit, i cili furnizohet nga mbledhja e ujërave natyrore (shirave dhe burimet ujore nëntokësore);

Të gjitha këto burime ujore kanë vlerë të madhe, pasi nëpërmjet tyre realizohet vaditja e tokave, e cila bën të mundur realizimin e prodhueshmërisë bujqësore.

*Lumenjtë*

Semani është i rëndësishëm jo vetëm nga pikëpamja hidrike, por dhe nga impakti mjedisor që shkakton apo pëson. Nga lumi Semanmarrin sasi të konsiderueshme për vaditjen e tokave banorët e zonës në fshatrat Jagodinë, Suk 1 dhe Arapaj.

*"Programi 100 fshatrat"*

Fshati Luar një ndër katër fshatrat e Njësisë Administrative Kuman, është përzgjedhur së fundmi nga qeveria shqiptare si pjesë e programit të rilindjes rurale "100 fshatrat". Investimet e integruara do të bëjnë të mundur që të investohet në 3 fusha kryesore: përmirësimi i infrastrukturës publike, zhvillimi


Rr. "E Kosovarëve", Nd 35, H 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipër - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e mail: info@atelier4.al

ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike, si dhe zhvillimi i kapitalit social dhe njerëzor.

## 2.5 Zonat e Mbrojtura Mjedisore

Në Bashkinë e Roskovecit nuk ka zona apo monumente të mbrojtura mjedisore, gjatë shqyrtimit të PPV-së do të shihet mundësia e vlerësimit të potencialeve dhe propozimi i tyre për t'i klasifikuar në përputhje me ligjin Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura".

Element shumë i rëndësishëm është "Këneta e Zezë" në fshatin Strum. Ajo u ka rezistuar kohërave, është një monument natyror, , me kallëma të egër nënujor, peshq, shpendë dhe me karakteristikën kryesore, uijin e zi dhe asnjëherë shterues.



*Figura 7. Këneta e Zezë,Roskovec*

## 2.6 Zonat dhe Objektet e Trashëgimisë Kulturore

Në maj 2018 u miratua Ligji Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Ligji është në përputhje me konventat e UNESCO-s dhe Konventat e Këshillit të Evropës, përkatësisht Konventën Evropiane për "Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike", si dhe Konventën mbi "Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë".

Në territorin e Bashkisë Roskovec gjenden 2 monumente të veçanta kulturore. Këto elementë trajtohen në vijim dhe janë pasqyruar dhe në hartën përkatëse.

*Kisha "Shën Kollit", Kurjan* është një monument i shekullit të XIII, i ndërtuar në stilin bizantin. Pikturat murale që zbukurojnë brendësinë e kësaj Kishe, janë veprat e ikonografit Nikolla, biri i Onufrit dhe ndihmësit të tij, Joanit. Kjo kishë është shpallur monument kulture nga:

- Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963;
- Ministria e Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kultures, Vendim Nr. 68/7, datë 30.05.1970;
- Ministria e Arsimit dhe Kulturës Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973.;

Rishtazi ka pqërfunduar restaurimi i kësaj kishe sipas projektit të hartuar nga specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe financuar nga Bashkia Roskovec dhe që konsistoi në restaurimin e plotë të Kishës së Shën Kollit, monument kulture i kategorisë së I-rë.

*Kisha e "Shën Gjergjit", Strum*, e ndërtuar në shekullin e XVII, e ngritur në një bregore të butë dhe e veshur me gjelbërim. Kjo Kishë është e ndërtuar në vitin 1782 dhe ka një gjatësi prej 10 metra dhe lartësi 3.5 metra. Këmborja është pjesa me e ruajtur e objektit; Kjo kishë ka nevojë për ndërhyrje restauruese, ku rekuperimi i çatisë është prioritar për të ruajtur vlerat monumentale.

- Ministria e Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kulturës, Vendim nr. 68/7, datë 30.05.1970;
- Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendim nr.1886/ datë 10.06.1973


Rr. "D Kosovarëve", Nd.33, H. 6,Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipër – Tel. +3554 2222804 / 2430155, e-mail: info@atelier4.al



Figura 8. Harta e zonave të mbrojtura

# 3 REZULTATET E ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË TERRITORIT



*Figura 9. Pozicioni në rajon dhe ndarjet administrative*

## 3.1 Ndarja administrative

Reforma territoriale e vitit 2014 krijoi bashkinë e re të Roskovecit duke bashkuar në një administrim të vetëm një bashki – Roskovecin dhe 3 komuna: Kuman, Kurjan dhe Strum, të cilat sot janë njësitë administratrive të bashkisë. Aktualisht Bashkia e Roskovecit ka në perbërjen e saj 1(një) qytet dhe 14 (katërmbëdhjetë) fshatra. Bashkia e Roskovecit bën pjesë në qarkun e Fierit dhe kufizohet në veri nga Bashkia Lushnje, në lindje me Bashkinë Ura Vajgurore, në juglindje nga Bashkia Berat, në perëndim me Bashkinë Patos dhe Fier, ndërsa në jug me Bashkinë Mallakastër.

### 3.1.1 Zhvillimi historik i Bashkisë Roskovec

Territori aktual i Bashkisë së Roskovecit është midis krahinës së Mallakastrës dhe Myzeqesë së poshtme. Territoret kanë qënë të banuara që në lashtësi, sikurse dëshmohet nga tumat e Strumit.

Zona e Roskovecit ka qënë përshkuar nga rrugët historike të formuara që në lashtësi.


Rr. "F. Kosovarëve", N.135, H 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222904 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al

*Si rrugë tradicionale, që përshkojnë krahinën e Mallakastrës dhe që e lidhin me krahinat përqark, kanë shërbyer luginat e lumejve Vjosë e Gjanicë si dhe kurrizet e buta të vargjeve kodrinore. Për kohën antike ishin kryesore rrugët që ndiqnin kurrizet kodrinore duke evituar përrejnjtë dhe kalimet e lumit. Prej tyre më e rëndësishme ishte ajo gjatë kurrizit në të majtë të Gjanicës, e cila fillonte nga Apollonia, vazhdonte me kodrat e Radostinës, Koshovicës Gjorgosit, Gurzezës, Kasnicës, Drenovës dhe duke kaluar në Hekal (Bylis) e Klos vazhdonte nëpër bregun e djathtë të Vjosës. Kalimi i këtij lumi bëhej në Kalivaç për të vazhduar në bregun e majtë. Rruga tjetër më pak e rrahur ndiqte vargun lindor duke u futur nëpërmjet fushës së Roskovecit drejt Kurjanit, Ngjeqarit dhe nëpërmjet qafës së Ngraçanit dilte në Aranitas, më tej në Gjerbës, Bardhaj, Rabije, duke u degëzuar në qafën e Gllavës, njëra drejt luginës së sipërme të Osumit dhe tjetra në luginën e sipërme të Vjosës. Drejtimin e këtyre rrugëve gjatë kurrizeve kodrinore që në periudhën antike e piketojnë vendbanime të fortifikuara apo të hapura, të cilat duke qenë larg territoreve bujqësore duket se ishin në funksion të vetë rrugës.*[9]

Në pjesën veriore të territorit të sotëm të bashkisë përgjatë rrjedhës së Semanit mendohet të ketë kaluar aksi jugor i rrugës Egnatia që lidhte Apoloninë duke shmangur Kënetën e Lushnjës kalonte në krahun e majtë të Semanit. Stacioni i parë i kësaj rruge ishtë "mutatio" Stefanafana –Roskoveci i sotëm. Në studimin e Camillo Praschniker ,"Muzakhia und Malakastra; archäologische Untersuchungen in Mittelalbanien"- Ëien, A. Hölder, 1920 përmenden mjaft gjurmë të trasesë së rrugës antike. Kjo rrugë e kalonte Apsosin (Semanin) në fshatin Kuç ku ka dhe gjurmë të urës së periudhës romake. Ky degëzim bashkohej me rrugën kryesore Egnatia në Clodiana (Peqin). Ky degëzim supozohet që mbledh dhe rrugët që vinin nga Bylisi e Dimali, drej luginës së Shkumbinit. Një studim i dytë e lokalizon këtë aks me disa gjurmë kalldrëmi pranë Jagodinës.

9 Muçaj Skënder. Vendbanime të antikitetit te vone në krahinën e Mallakastrës, Iliria, vol. 9-10, 1979




*Figura 10 Rrugët në shek V p.e.s.-IV e.s.*[10]

[10] Shtylla,Valter. Rrugët dhe urat e Vjetra në Shqipëri, Toena 1997

Periudha VII-XV është e karakterizuar nga lëvizje dhe dyndje që shkaktuan dëme ekonomike dhe kulturore. Kultura arbëreshe e mesjetës së hershme dëshmon lidhje me kulturën provinciale të antikitetit të vonë, ndërkohë që qënia në kryqëzimin e vijave të rëndësishme të qarkullimit solli ndikime të arkitekturës bizantine. Në shekujt XIII-XIV ndodhi një fenomen i rëndësishëm urban zhvillimi i qyteteve jashtë mureve rrethuese, por në shekullin XV, me pushtimin osman u shkatërruan qytete, kala dhe vepra të shumta arkitektonike. Në këtë periudhe vihet re një rënie e lulëzimit të qytetërimit ilir të mesjetës së hershme. Territori i Roskovecit, nga pikëpamja e zhvillimit urban kalon në plan të dytë, duke marrë një karakter rural, zona përmendet si pikë kalimi tranzit në akset e rëndësishme të kohës që ndiqnin gjurmët e rrugëve antike.

Territori aktual i Roskovecit rifillon të zhvillohet me kërkimet për naftë në Shqipëri (1918), dhe pas luftës së dytë botërore në 1947, kur në Patos ngrihet i pari kantier për nxjerrjen e naftës.

Në vitin 1957 zbulohet vendburimi i rëndësishëm i Marinzës. Fusha naftëmbajtëse Patos-Marinzës është baseni tokësor më i madh naftëmbajtës në Europë.
Zhvillimet e pas 90, kanë patur ndikim dhe në Roskovec, ndonëse një numër i lartë banorësh janë larguar, periferitë e qytetit janë prekur nga ndërtimet informale. Aktualisht trendet e zhvillimit janë të orientuara të bujqësia ndonëse industria luan ende një rol të rëndësishëm në punësimin e rezidentëve.

### 3.1.2 Dinamikat rajonale të Zhvillimit




*Figura 11. Densiteti i popullsisë në nivel Rrjeti*

Shpërndarja dhe përqendrimit demografik janë elementë të rëndësishëm në studimin dhe shfrytëzimin territorit. Të dhënat mbi densitetin e popullsisë në nivel "rrjeti" (Census 2011), mundësojnë identifikimin e baseneve demografike dhe qendrën e gravitetit të tyre. Këto qendra graviteti (ose përqendrimi i popullsisë në zona të caktuara), ndikojnë në dinamikat demografike, aktivitetin ekonomik, shtrirjen territoriale të qyteteve/fshatrave, zhvillimin social, shërbimeve publike etj.

Përqendrimi i popullsisë në një territor të caktuar, falë aktivitetit ekonomik social dhe shërbimeve administrative, tërheq popullsinë dhe aktivitete ekonomike të zonave periferike dhe të qendrave më një peshë më të ulët.

Në shkallë kombëtare, qyteti i Tiranës renditet si qendra e gravitetit kryesor në vend, duke shënuar një densitet prej 23,997 banorë/km$^2$[11], dhe duke u pozicionuar në basenin me të rëndësishëm nga pikëpamja ekonomike, sociale dhe administrative. Krahas qytetit të Tiranës (ose metropolit të Tiranës), evidentohen dhe qendra primare si: Durrësi, Elbasani, Kavaja, Lushnje, Fier, Ballsh, Vlorë, Berat, Gjirokastër, Sarandë, Korçë, Pogradec, Lezhë, Laç, Peshkopi, Kukës dhe Shkodër; të cilat shfaqin një densitet të popullsisë rezidente që tejkalojnë vlerën e 5,000 banorë/ km$^2$. Janë pikërisht këto qytete, që përbëjnë basenet demografike kryesore të vendit, dhe klasifikohen nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar, si pole ekonomike dhe sociale me ndikim të lartë në dinamikat demografike rajonale.

Në jug të metropolit të Tiranës, identifikohen qendra primare si Fieri, Vlora , Berati, Gjirokastra të cilat ndikojnë në qendrat sekondare dhe terciare, që kanë një densitet kryesisht të ulët, të karakterizuar me qendra urbane të vogla dhe të shpërndara gjeografikisht. Pra jugu i basenit të Tiranës, shfaq një shtrirje të lartë e popullsisë dhe një densitet relativisht të ulët.

[11] Census 2011, Grid 1km.

Nëse fokusohemi në basenin e Fierit, evidentohen tre qendra terciare : Patos, Ballsh, Roskovec, të cilat i përkasin bashkive Patos, Mallakastër dhe Roskovec, të cilat regjistrojnë një densitet të ulët, krahasuar me qendrën Fier. Lidhjet ekonomike dhe sociale tradicionale me Beratin dhe Tepelenën janë zbehur paksa për shkak të mungesës së investimeve në infrastrukturë. Aktualisht bashkitë e Mallakastrës, Patosit dhe Roskovecit orientohen drejt Fierit për shërbime por dhe si akses më i shpejtë ndërlidhjeje.




*Figura 12. Densiteti i popullsisë në nivel rrjeti.*

Krahas shpërndarjes së lartë të popullsisë në territor, dhe përqendrimit të popullsisë në zonat e urbanizuara, vlen të përmendim se vërehet një densiteti i lartë përgjatë akseve rrugore kombëtare. Ky përqendrim i popullsisë përgjatë akseve kryesore rrugore, rrjedh si pasojë e nevojave të popullsisë për akses ndaj shërbimeve publike dhe ndërlidhjes me qendrat urbane dhe polet ekonomike të vendit etj.

*Në një këndvështrim zhvillimi territorial, densiteti i ulët i popullsisë dhe afërsia gjeografike me një qendër graviteti si Fieri (që përfiton më tepër nga efekti i ekonomisë të përshkallëzuar), renditen si faktorë frenues në përmirësimin e shërbimeve publike dhe për pasojë, të cilësisë së jetës në qendrat periferike si Patosi, Ballshi dhe Roskoveci.*

*Mungesat e infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe të shërbimeve, si dhe një mungesë vëmendjeje në promovimin e vlerave tradicionale, kulturore dhe mjedisore mund të konsiderohet problematika kryesore që duhet të adresohet në nivelin rajonal.*



*Figura 13. Dinamikat e Zhvillimit Rajonal*

## 3.2 Analiza metabolike e flukset kryesore me rëndësi për territorin

Analiza metabolike bazohet në konceptin e urbanizimit si një ekosistem, planifikimi nuk ka të bëjë thjesht me vendndodhje por me lidhjen e flukseve (energjia, uji,ushqimi, ajri dhe nxehtësia, mallrat, mbetjet, sedimentet, njërëzit, të dhënat etj[12]) shpesh të ndërprera. Analiza metabolike gërshëton gjetjet nga burimet zyrtare, vizitat në terren, tregimet e banorëve të zonës. Duke qenë se territori i bashkisë ka një dendësi shumë të ulët banimi dhe një territor mbi 80% bujqësor, flukset metabolike janë të fragmentuara.

Territori i Roskovecit mban potenciale të shumta natyrore ashtu dhe në prodhimtari e në vlera njerëzore, kulturore dhe tradita, por shfrytëzimi i këtyre potencialeve dhe flukset janë të "cunguara" nga mungesat e infrastrukturës dhe investimeve.

Janë analizuar flukset e Ujit, Ushqimit, Energjisë dhe Turizmit (lëvishshmëri dhe ekonomi), bazuar dhe në Metabolizmin e Shqipërisë.

### 3.2.1 Flukset e Ujit

Bashkia Roskovec, ka burime të shumta ujore. Territori përshkohet nga lumi i Semanit dhe përrenj të vegjël. Në territorin e Roskovecit gjendet rezervuari i Kurjanit, një nga rezervat më të mëdha për ujitjen e tokave bujqësore.

Në zonën e Roskovecit hyrjet e ujit në territory janë rreshjet, ujërat ipëerfaqësorë të lumenjve të grumbulluara në rezervuarë dhe ujërat nëntokësorë.

Sipas të dhënave të stacionit matës të Lushnjës (më i afërti me Roskovecin) rreshjet mesatare vjetore luhaten rreth 1000 mm, sasi kjo që në rreth 70-80 % bie gjatë perjudhës 5-mujore Tetor-Shkurt.

Prurja mesatare shumëvjeçare vjetore e Semanit në vendmatjen Mbrostar, më e afërta me zonën në studim, është 90.1 m3/s, kurse pruerjet mesatare mujore po në këte vendmatje jepen në tabelën në vijim.

*Tabela 1 Shpërndarja e rrjedhjeve mujore të lumit Seman në vendmatjen Mbrostar*

| I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | Vjetore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 143 | 156 | 161 | 143 | 116 | 52.2 | 19.9 | 11.7 | 22.0 | 41.2 | 99.7 | 117 | 90.1 |

Lumi Seman, i cili është dhe burimi kryesor i ujërave në këtë zonë, monitorohet në gjashtë stacione monitorimi duke përfshirë dy degët e tij lumin Osum dhe lumin Devoll, si dhe në pjesën fundore të tij pas bashkimit të këtyre degëve. Në këtë rrjet monitorimi është përfshirë edhe një stacion në degën e lumit Gjanicë, të ndikuar nga shkarkimet urbane dhe ujërave të zonës së nxjerrjes dhe të përpunimit të naftës. Vlerat më të larta të nitrateve rezultojnë në stacionin e Gjanicës ku luhaten nga 0.85 mg/l në 1.02 mg/l N-NO3 dhe në stacionet e tjera ky parametër ka luhatje në varësi të kohës së kampionimit si dhe të prurjeve të lumit. Në përgjithësi në stacionet e këtij pellgu lumor,

[12] Referencë "The metabolism of Albania", published by IABR/UP

kemi vlera të larta të lëndëve ushqyese me përmbajtje azoti që tregon ndikimin e ndotësve me natyrë organike e nga plehrat kimike që vijnë si pasojë e mjedisit fushor dhe me bujqësi të zhvilluar të këtij zone.

Ujërat e lumit Seman për përmbajtjen e fosforit total klasifikohen si ujëra të cilësisë mesatare për stacionin e Kozarës, Ura Vajgurore dhe Mbrostar (në afërsi të Roskovecit), që do të thotë se vlerat mesatare të tyre luhaten brenda intervalit 0.011–0.020 mg/l P.

Përroi tjetër i rëndësishëm në territor ai i Kurjanit, që furnizon dhe rezervuarin me të njëjtin emër, ka prurje të vogla dhe që ndikohen lehtësisht nga rreshjet atmosferike; prurjet maksimale mbrijnë rreth 20-30 m3/s në periudhë rreshjesh intensive atmosferike, kurse në stinën e thatë rrjedhin disa l/s. Përroi i Kurjanit në stinën e verës përdoret tërësisht për ujitje.

Ujërat e puseve në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz i përmbushin kërkesat e ujit të kategorisë A1 (sipas Direktivës EC/CEC 440) për shumicën e parametrave të matur dhe ato mund të përdoren si ujë i pijshëm pas trajtimeve të nevojshme. Përjashtim është pusi Nr. 8 (Zharrëz) ujërat e të cilit janë kryesisht të kategorisë A2 (Vallja, 2012). Me cilësi më të mirë kanë rezultuar ujërat e puseve në zonat Marinëz, Kallm dhe Belinë, të cilat janë ujëra të thellësive 1300 deri 2000 m. Cilësi më të keqe paraqesin ujërat e puseve në Zharrëz dhe deri diku në Sheqisht.

Një ndër elementët hidrologjikë më interesantë të Bashkisë së Roskovecit që dallohet për vlerat e saj të shumta natyrore është Këneta e Zezë e njohur dhe si Ligatina e Roskovecit. Këneta ndodhet ndërmjet Roskovecit dhe Fshatit Strum, rreth 2 km larg qendrës së qytetit. Këneta e Zezë ndodhet në pjesën më të ulët të fushës që vendoset në jug të lumit Seman dhe për këtë shkak ajo nuk mund të drenohet nga sistemi egzistues i kullimit të tokave i cili përmirëson gjithë fushën në fjalë. Këneta mbushet nga rreshjet atmosferike si dhe nga drenimi i ujërave nëntokësore të zonës që e rrethon.

Zona kodrinore jugore ka sasi më të pakët uji, sasia aktuale nuk mjafton për të mbuluar nevojat e popullsisë të fshatit Ngjeqar, për të cilin duhet evindentuar burime ose mënyra të tjera furnizimi.

Skemat ujitëse në Bashkinë Roskovec janë skema të vogla me bazë fshati, janë rreth 7 skema ujitëse me vetë rrjedhje me bazë burimi të ujit të rezervuareve ekzistues, kryesisht të Kurjanit si dhe nga lumi Seman. Megjithate eficienca e tyre është rreth 65 %, si nga sasia e sipërfaqes që mbulojnë ashtu edhe nga sasia e ujit disponibël për periudhën e ujitjes.


Rr. "Kosovarëve", Nr 35, H. 5, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al




Figura 14. Metabolizmi rrjeti ujor

### 3.2.2 Flukset e Ushqimit

Bashkia Roskovec është një Bashki rurale, ku jo vetëm struktura e popullatës por edhe struktura ekonomike ka një drejtim të theksuar rural. Si Bashki ka një koeficient të ulët të sipërfaqeve të pa kultivuara, vetëm 42 ha ose 0,5 % të sipërfaqeve bujqësore. Baza e prodhimit bujqësor në territorin e Bashkisë Roskovec janë drithrat me destinacion për konsum të familjeve të rajonit dhe për ushqim koncentrat për blegtori.

Ullishtet zënë një sektor me prodhimtari dhe me të ardhura te konsiderueshme. Shtrihen në një sipërfaqe me rreth 1684.3 ha, nga ku merret nje prodhim me rreth 24.885 kv ullinj në 331.535 rrënjë. Pemët frutore zënë një sipërfaqe rreth 88.3 ha nga ku 25.270 kv fruta merren si prodhim i 113.654 rrënjëve. Vreshtat zënë një sektor në rritje nga ku merret 16.079 kv rrush ne 136.8 ha vreshta.

Blegtoria është dega më e rëndësishme e prodhimit ekonomik të fermave rurale private në territorin e Bashkisë Roskovec. Kjo vërehet jo vetëm nga struktura e numrit të krerëve në territor por edhe të raportit 60:40 kundrejt prodhimit bujqësor. Prodhohet rreth 19.400 ton qumësht si bashki. Rendimentet e qumështit janë të kënaqshme edhe për të imtat ku mund të themi që prodhimtaria për krerë është më e lartë se e vendit,gjithashtu prodhohen rreth 5.6 milion kokrra vezësh. Bashkia Roskovec prodhimet e freskëta dhe të përpunuara i drejton në destinacionin e tregut rajonal të Fierit dhe atë kombëtar.

Bletaria është një sektor me shumë të ardhme dhe që po rritet ndjeshëm pothuaj në gjithe territorin. Mjalti është një nga produktet e rëndësishme të prodhimit blegtoral i shpërndarë në të gjithë vendin.


Rr. "E Kosovarëve", Nd.35, H. 6 Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al




*Figura 15. Metabolizmi ushqimi*

### 3.2.3 Flukset e Energjisë

Në bashkinë e Roskovecit ndodhen burimet naftëmbajtëse të Marinzës. Në Marinzë dhe Jagodinë shfrytëzohen intensivisht burimet naftëmbajtëse. Nga kjo zonë përfitohet pjesa më e madhe e hidrokarbureve në rang kombëtar. Këto burime nuk përdoren në territor për krijimin e energjisë por lënda e parë lë zonën në stadin bruto. Gazi natyror është një potencial tjetër i rëndësishëm por që aktualisht nuk përdoret por digjet në natyrë.

Territori ka potenciale dhe për shfrytëzimin e energjisë diellore falë një rrezatimi prej 1450-1650 këh/m$^2$. Shpërndarja territoriale e diellzimit në fushën e Myzeqesë arrin mbi 2700 orë. [13] Ky potencial është një mundësi e mirë për përdorimin e paneleve diellore për prodhim të energjisë.

Popullata ende përdor si burim kryesor energjinë e prodhuar mbi bazë hidrike, kjo energji nuk prodhohet në territorin administrativ, pasi pasuritë hidrike nuk janë të përshtatshme në këtë segment. Sipas INSTAT në qarkun Fier burim kryesor për ngrohje vazhdon të jëtë lënda drusore, trend ky që duke parë pasuritë energjitike dhe konsideruar dëmtimin e zonës natyrore në Roskovec, duhet kthyer drejt burimeve alternative: energji diellore dhe gaz. Përdorimi i gazit natyror si për ngrohje ashtu dhe për gatim është një mundësi konkrete pasi në territorin e Roskovecit krahs pasurive natyrore kalon TAP dhe është ndërtuar stacioni i këtij gazsjellësi.

[13] Burimi: "Energjia Diellore_ëebpage- pnud 2016 " - http://ëëë.akbn.gov.al/energjia-diellore/


Rr. "Kosovarëve", Nd 35, H. 5 Ap 47, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222604 / 2430135, e-mail: info@atelier4.al




*Figura 16. Metabolizmi energjia*

### 3.2.4 Flukset e Turizmit

Turizmi lidhet me aksesin e territorit. Ndonëse Bashkia e Roskovecit ka potencial në turizmin rural, vecanërisht njësia Kurjan, mungesa e infrastrukturës dhe prania në rajon e territoreve me vlera më të larta, natyrore, kulturore e turistike bën që në këtë drejtim kjo bashki të mos ofrojë vlera konkuruese.



*Figura 17. Metabolizmi turizmi*

## 3.3 Elementët përjashtues të zhvillimit

Gjatë hartimit të planit vendor merren në konsideratë brezat mbrojtës dhe distancat e sigurisë bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Planifikimin Kombëtar. Këto kufizime në territorin e Roskovecit përmblidhen:

- **Kufizime për ruajtjen e mjedisit natyror dhe historik**

Këto kufizime vendosen për ruajtjen e mjedisit natyror për shkak të vlerave specifike natyrore ose vlerës së peizazhit natyror apo të ndërtuar. Në këtë kategori përfshihen, fashat dhe brezat mbrojtës të lumenjve, përrenjve, monumenteve të natyrës, zonave apo ekosistemeve të ndjeshme mjedisore si dhe momumentet e kulturës.

Baza ligjore aktuale ka shfuqizuar një numër të lartë kufizimësh të këtyre elementeve duke i lënë detyra të planifikimit apo të rregulloreve sektoriale.

PPK në lidhje me lumenjtë dhe brigjet ka parashikuar një distancë prej 200 m për të krijuar hapësirat e korridoreve natyrorë lumorë.

Konkretisht në territor janë evidentuar:

- Kufizimi përgjatë Semanit – 100 m dhe 200 m (për t'u detajuar më tej në fazën e hartimit të PPV-së).
- Kufizimi perreth Kënetës së Zezë – 100 m (për t'u detajuar më tej në fazën e hartimit të PPV-së).
- Kufizimi përreth rezervuarit të Kurjanit - 100 m. Ky kufizim krahas ruajtjes së ekosistemit shërben dhe si një fashë e parë për mirëmbajten dhe sigurinë e kësaj vepre inxhinierike.
- Kufizimi përreth monumenteve të Kulturës (kisha e "Shën Kollit, Kurjan", kisha e "Shën Gjergjit", Strum) 100 m - sipas Nenit 77, pika 2, shkronja "ç", të ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"

- **Kufizime për arsye sigurie dhe mirëmbajtje**

Në këtë kategori për fshihen të gjitha infrastrukturat që kanë nevojë për breza mbrojtës si për të rritur sigurinë ashtu dhe për të siguruar mirëmbajten e duhur të tyre. Këtu përmendim brezat mbrojtës së rrugëve urbane dhe interurbane, hekurudhave, kabllot e tensionit të lartë, etj.

Në këtë kategori përfshihen dhe kufizimet në zona me ndjeshmëri mjedisore, aksesi i të cilave do të përbënte rrezik për njerëzit (zona me rrezik hidro-gjeologjik, si për shembull erozioni dhe përmbytjet, etj)

Konkretisht në territor janë evidentuar:

Kufizimi i aksit kombëtar SH73 – 30m paralel në të dy krahët.

Kufizimi i rezervuarëve Kurjan, Ngjeqar etj – 100 m

Kufizime të linjave ajrore të tensionit të lartë - 10 m paralel në të dy krahët e linjës.

Kufizime të kanaleve vaditës dhe kullues për efekt mirëmbajtjeje - 8 m së paku në njërin krah të kanalit integruar në rrugët bujqësore.

Në territorin e Roskovecit nuk zona të prekura nga rreziqet gjeologjike dhe hidrogjeologjike.

- **Kufizime për arsye sanitare**

Këto kufizime kanë si qëllim primar ruajtjen e higjenës dhe shëndetin publik. Janë breza mbrojtës që duhen marrë në konsideratë gjatë planifikimit dhe duhet të jenë pjesë përbërësë e lejeve të ndërtimit dhe lejeve mjedisore të strukturave si industri e rëndë, infrastrukturë përpunim mbetjesh urbane, struktura bujqësore si depo farmaceutike, thertore, stalla etj Këto kufizime janë të ndryshueshme në varësi lejes mjedisore, pjesë e terrenit në dispozicion të funksionit konkret.

Në territorin e bashkisë Roskovec gjenden zonat industriale të nxjerrjes së hidrokarbureve e cila është e rrethuar por në territor ka dhe puse të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë. Këto të fundit duhet të rrethohen duke rritur sigurinë.

Pika e grumbullimit të mbetjeve në Marinëz do të mbyllet me të filluar punë Inceneritori i Fierit dhe do të reabilitohet.

Të gjitha kufizimet janë paraqitur në hartën e mëposhtme (fig. 18).


Rr. "L Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap.4/', Njësia Administrative Nr. 5.1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2272804 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al



*Figura 18. Harta e kufizimeve të zhvillimit*

## 3.4 Trendi i rritjes së popullsisë dhe nevojat

### 3.4.1 Popullsia rezidente në Bashkisë Roskovec

Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë (Census 2011) dhe projeksioni i popullsisë rezidente i Bashkisë Roskovec, shfaq për 15 vitet ardhshme një variacion të theksuar të popullsisë rezidente, duke kaluar nga 21,742 banorë në 2011 në 20,215 në 2018 dhe vetëm në 18,094 banorë në 2031. Tendencat aktuale tregojnë qartë një rënie të popullsisë, për 15 vitet e ardhshme (ku pritet një rënie prej gati 2,121 banorësh nga 2018 ne 2034).

*Tabela 2 Trendet demografike 2011-2034 sipas popullsisë rezidente*

| Njësia Administrative | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Kuman | Kurjan | Roskovec | Strum | Bashkia Roskovec |
| 2011 | 5 611 | 3 618 | 4 975 | 7 538 | 21 742 |
| 2018 | 5 240 | 3 358 | 4 660 | 6 958 | 20 215 |
| 2019 | 5 191 | 3 324 | 4 618 | 6 883 | 20 015 |
| 2020 | 5 143 | 3 290 | 4 576 | 6 807 | 19 816 |
| 2021 | 5 094 | 3 256 | 4 534 | 6 732 | 19 616 |
| 2022 | 5 048 | 3 223 | 4 494 | 6 660 | 19 425 |
| 2023 | 5 002 | 3 191 | 4 454 | 6 587 | 19 234 |
| 2024 | 4 956 | 3 158 | 4 414 | 6 515 | 19 043 |
| 2025 | 4 910 | 3 126 | 4 374 | 6 442 | 18 852 |
| 2026 | 4 865 | 3 093 | 4 334 | 6 370 | 18 661 |
| 2027 | 4 847 | 3 081 | 4 319 | 6 344 | 18 590 |
| 2028 | 4 829 | 3 069 | 4 304 | 6 317 | 18 519 |
| 2029 | 4 811 | 3 057 | 4 289 | 6 291 | 18 448 |
| 2030 | 4 794 | 3 045 | 4 274 | 6 265 | 18 378 |
| 2031 | 4 776 | 3 033 | 4 259 | 6 238 | 18 307 |
| 2032 | 4 758 | 3 021 | 4 244 | 6 212 | 18 236 |
| 2033 | 4 741 | 3 009 | 4 230 | 6 186 | 18 165 |
| 2034 | 4 723 | 2 997 | 4 215 | 6 159 | 18 094 |

Burimi Census 2011, Raportit për "Projeksionet e Popullsisë së Shqipëri 2011-2031", Instat, Përpunoi Atelier 4.

Tendencat aktuale demografike të popullsisë rezidente, pritet të shënojnë mesatarisht një rënie prej gati 10.5% në 15 vitet e ardhshme.

Projeksioni i popullsisë rezidente, tregon tendencat e ardhshme të popullsisë duke u bazuar në një imazh statik të numrit të banorëve në një zonë të caktuar, në një momentin e regjistrimit të popullsisë (tetor 2011, Census). Për këtë arsye studimi i tendencave demografike të regjistruar nga gjendja civile janë një tregues tejet i rëndësishëm mbi dinamikat dhe tendencat demografike.

## 3.4.2 Tendencat demografike të popullsisë së regjistruar në Gjendje Civile

Të dhënat e Gjendjes Civile të Bashkisë Roskovec, tregojnë popullsinë e regjistruar nga pikëpamja administrative, duke përfshirë dhe popullsinë e migruar jashtë vendit. Popullsia e regjistruar në Gjendje Civile, është një tregues mbi popullsinë lokale ekzistuese dhe potenciale.

Hulumtimet në terren dhe konstatimet e Institutit të Statistikave[14], theksojnë se vitet e fundit vërehet një fenomen i rikthimit të popullsisë së migruar, si pasojë e krizës ekonomike botërore 2009-2012. Në këtë kontekst, studimi më i thelluar i tendencave të popullsisë së regjistruar në Gjendje Civile, bëhet i domosdoshëm.

Popullsia e regjistruar në gjendjen Civile Roskovec, shënon 32,041 banorë në 2018, duke shfaqur një tendencë lineare pozitive. Nisur nga tendenca lineare aktuale e lëvizjeve demografike të popullsisë së regjistruar në gjendje civile, përafrohet projeksioni i popullsisë për 15 vitet e ardhshme.

*Tabela 3 Trendet demografike 2010-2034 sipas popullsisë së regjistruar në Gjendjen civile*

| | Roskovec | Kuman | Kurjan | Strum | Bashkia Roskovec |
|---|---|---|---|---|---|
| 2010 | 8 509 | 8 189 | 5 263 | 8 977 | 30 938 |
| 2011 | 8 501 | 8 263 | 5 298 | 9 033 | 31 095 |
| 2012 | 8 469 | 8 316 | 5 347 | 9 071 | 31 203 |
| 2013 | 8 604 | 8 354 | 5 309 | 9 120 | 31 387 |
| 2014 | 8 646 | 8 418 | 5 341 | 9 204 | 31 609 |
| 2015 | 8 777 | 8 506 | 5 351 | 9 263 | 31 897 |
| 2016 | 8 911 | 8 573 | 5 363 | 9 316 | 32 163 |
| 2017 | 8 919 | 8 603 | 5 409 | 9 345 | 32276 |
| 2018 | 8 859 | 8 519 | 5 318 | 9 345 | 32 041 |
| 2019 | 8 935 | 8 596 | 5 345 | 9 408 | 32 285 |
| 2020 | 8 986 | 8 641 | 5 350 | 9 456 | 32 437 |
| 2021 | 9 037 | 8 687 | 5 355 | 9 505 | 32 590 |
| 2022 | 9 088 | 8 732 | 5 359 | 9 554 | 32 743 |
| 2023 | 9 140 | 8 778 | 5 364 | 9 603 | 32 897 |
| 2024 | 9 191 | 8 823 | 5 369 | 9 652 | 33 051 |
| 2025 | 9 243 | 8 869 | 5 374 | 9 701 | 33 206 |
| 2026 | 9 295 | 8 915 | 5 379 | 9 751 | 33 361 |
| 2027 | 9 347 | 8 961 | 5 383 | 9 800 | 33 517 |
| 2028 | 9 399 | 9 007 | 5 388 | 9 850 | 33 673 |
| 2029 | 9 451 | 9 054 | 5 393 | 9 900 | 33 829 |
| 2030 | 9 503 | 9 100 | 5 398 | 9 950 | 33 986 |
| 2031 | 9 556 | 9 147 | 5 403 | 10 000 | 34 143 |

[14] Raporti Instat 2014, për "Projeksionet e Popullsisë së Shqipëri 2011-2031"

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2032 | 9 609 | 9 194 | 5 407 | 10 051 | 34 301 |
| 2033 | 9 662 | 9 241 | 5 412 | 10 101 | 34 459 |
| 2034 | 9 715 | 9 288 | 5 417 | 10 152 | 34 617 |

Nga projeksioni i popullsisë së regjistruar në gjendje Civile vërehet një rritje prej rreth 8%, duke kaluar nga 32,041 banorë në 2018 në 34,617 banorë në 2034.

Në përfundim mund të theksohet se, tendencat aktuale të lëvizjeve demografike të popullsisë së Bashkisë Roskovec janë pozitive.

### 3.4.3 Diferenca e popullsisë rezidente dhe asaj të regjistruar në gjendjen civile

Rezultatet e Census 2011 regjistrojnë 21,742 banorë në bashkinë Roskovec, kurse për të njëjtin vit në Gjendje Civile regjistrohen 31,095 banorë. Kjo diferencë tepër e lartë, rrjedh si pasojë e nivelit të lartë të migrimit jashtë vendit, ku kjo kategori mbeten ende të regjistruar në gjendje civile por nuk janë më rezident të Bashkisë Roskovec.

Nisur nga projeksionet, diferenca ndërmjet popullsia rezidente dhe popullsisë se regjistruar në Gjendje Civile, vlerësohet të jetë e qëndrueshme dhe për vitet e ardhshme, duke lënë të kuptohet se pritet të kemi një nivel të lartë i migrimit jashtë vendit dhe migrimi të brendshëm.

*Tabela 4 Diferencat midis popullsisë rezidente dhe asaj të gjendjes civile*

| | Popullsia 2018 | | Popullsia 2023 | | Popullsia 2028 | | Popullsia 2033 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pop. rezidente | Pop. Gj.C | Pop. rezidente | Pop. Gj.C | Pop. rezidente | Pop. Gj.C | Pop. rezidente | Pop. Gj.C |
| Bashkia Roskovec | 20,215 | 32,041 | 19,234 | 32,897 | 18,519 | 33,673 | 18,165 | 34,459 |

Krahas faktit se projeksioni e Popullsisë rezidente shfaq një tendencë negative, dhe popullsinë së regjistruar në gjendje civile shfaq një tendencë pozitive, projeksionet tregojnë përshpejtim të fenomenit të migrimit, par shkak se kjo diferencë bëhet gjithnjë e më e lartë. Në këtë kontekst, shfaqen nevojat për një monitorim më të saktë të numrit të popullsisë rezidente dhe popullsisë së regjistruar në Gjendje Civile. Evidentimi i popullsisë është një nga indikatorët kryesor në ofrimin e shërbimeve publike. Për këtë arsye është e nevojshme të evidentohet me saktësi, popullsia rezidente, popullsia e migruar jashtë shtetit por dhe popullsia sezonale e migruar brenda vendit. Identifikimi i këtyre kategorive të popullsisë, lehtëson orientimin e shërbimeve publike, nevojat për investim dhe nevojat specifike për secilën nga këto kategori.

Migrimi i popullsisë përbën një nga problematikat kryesore të Bashkisë Roskovec. Në këtë kontekst frenimi i migrimit shtyn bashkinë të ndërmarrë e politikave lokale në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ekonomisë rajonale, për të garantuar qëndrueshmërinë demografike për 15 vitet e ardhshme.


Rr. "E Kosovarëve", Nr 35, H 5, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr 5.1019, Tiranë, Shqipëri - Tel +3554 222804 / 243095, e-mail info@atelier4.a

### 3.4.4 Densiteti i popullsisë

Dëndësia e banimit në sistemin urban varion nga 1000 banorë/km2 në Qytetin e Roskovecit dhe Strum, në 100 banorë/km2 në fshatrat periferikë të bashkisë. Densiteti i ulët dhe shpërndarja gjeografike e popullsisë (kryesisht në zonat rurale), privojnë shërbimet publike nga efektit i ekonomisë së shkallës, pra rrisin koston dhe vështirësojnë ndërhyrjet në përmirësimin e shërbimeve publike. Mungesat në shërbime publike dhe shërbime plotësuese të aktiviteteve kulturore dhe sociale janë një shtysë për migrimin e popullsisë.

### 3.4.5 Tendenca demografike sipas grup-moshave.

*Piramida e moshës dhe projeksioni i popullsisë rezidente Bashkia Roskovec*

Piramida e moshës së Bashkisë Roskovec për vitin 2016 shfaq një piramidë e moshës në formë "dardhe", formë e cila është karakteristike e një popullsie kryesisht në moshë të re, megjithëse në bazën e saj vërehet një rënie e lehtë e lindshmërisë dhe e rinovimit të popullsisë.

Piramida e moshës, shfaq gjithashtu dy zgjerime për fasha të moshës 5-30 vjeç dhe 45-60 vjeç, të cilat vendosin dhe theksin mbi nevojat e bashkisë.

Për sa i përket fashës 5-30 vjeç, mund te përmendim nevojën për strukturat arsimore për grupmoshat 0-20 vjeç dhe nevojat për integrimin në tregun e punës të popullsisë në moshë të re. Nga ana tjetër fasha 45-60, tregon nevojat e ardhshme për rritjen e shërbimeve të dedikuara për moshat e treta.

Rënia e lindshmërisë dhe rritja e popullsisë të moshuar, pritet të jenë të qëndrueshme dhe në 15 vitet e ardhshme, këto tendenca përmenden dhe në "Projeksionin e Popullsisë 2011-2031" nga INSTAT 2014. Si vërehet dhe në projeksionet e piramidës së moshës, parashikohet një tranzicion nga poshtë- lart i grupmoshave, që do të thotë se ka një tendencë plakjeje të popullsisë dhe rritje të jetëgjatësisë, dhe një tkurrje të piramidës në bazën e saj, që nënkupton vazhdimësinë e fenomenit të migrimit në 15 vitet e ardhshme.

*Grafiku 1 Projeksioni i piramidës së moshës Bashkia Roskovec 2016 -2031*




Burimi: Census 2011, "Shqipëri, Projeksionet e Popullsisë 2011-2031", Instat, përpunoi Atelier 4

Në përmbledhje mund të themi se projeksioni i piramidës së moshës tregon se tendencat demografike në 15 vitet e ardhshme shfaqin : një rënie të lindshmërisë; një plakje të popullsisë; dhe një vazhdimësi të trendit të migrimit të popullsisë në moshë të re.

Nga ana tjetër mund të vlerësohet se pjesa e popullsisë në moshë pune mbetet ende e konsiderueshme, gjë që tregon potencialin demografik të Bashkisë Roskovec, të shtjelluar në vijim.

### 3.4.6 Përbërja e ardhshme e popullsisë rezidente në Bashkinë Roskovec

Bashkia Roskovec konsiderohet të ketë një popullsi kryesisht të re, për shkak se 68.4% të popullsisë rezidente është në moshë pune, dhe vetëm 31.6% e popullsisë rezidente është në moshë në varësi.

Nisur nga ky fakt, projeksioni i popullsisë sipas grupmoshave është një tregues kryesor mbi tendencat e ardhshme demografike.

*Grafiku 2 Popullsia sipas grup-moshës, 2016[15].*




Census 2011, Census 2011, Instat, përpunoi Atelier 4

*Grafiku 3 Popullsia sipas grup-moshës, 2021[16].*




Census 2011, Census 2011, Instat, përpunoi Atelier 4

[15] Rezultate të përllogaritura falë Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë (Census 2011), të dhënat Instat dhe "Projeksionet e Popullsisë së Shqipëri 2011-2031" Instat maj 2014

[16] Rezultate të përllogaritura falë Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë (Census 2011), të dhënat Instat dhe "Projeksionet e Popullsisë së Shqipëri 2011-2031" Instat maj 2014

*Grafiku 4 Popullsia sipas grup-moshës, 2026*[17].




Census 2011, Census 2011, Instat, përpunoi Atelier 4

*Grafiku 5 Popullsia sipas grup-moshës, 2031* [18].




Census 2011, Census 2011, Instat, përpunoi Atelier 4

Projeksioni i popullsisë sipas grupmoshave shfaq disa variacione ku vlen të përmenden:

- Pjesa e popullsisë në moshë pune (15-65 vjeç), preket nga një tkurrje e lehtë, vërehet një rënie nga 68.4% në 2016 në 66.9% në 2031.
- Pjesa e popullsisë nën 15 vjeç, reduktohet ndjeshëm në vitet në vijim pasi preket nga një rënie nga 18.7% në 2016 në vetëm 13.5% në 2031.

[17] Rezultate të përllogaritura falë Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë (Census 2011), të dhënat Instat dhe "Projeksionet e Popullsisë së Shqipëri 2011-2031" Instat maj 2014

[18] Rezultate të përllogaritura falë Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë (Census 2011), të dhënat Instat dhe "Projeksionet e Popullsisë së Shqipëri 2011-2031" Instat maj 2014


Rr. "E Kosovarëve", Nd 35, H 6, Ap.47, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri Tel. +3554 2222604 / 2430195, e-mail info@atelier4.al

- Pjesa e popullsisë mbi 65 vjeç njeh një rritje nga 12.9% në 2016 në 19.6% në 2031, çdo të thotë se popullsia e ardhshme do të jetë një popullsi më e vjetër.

Fenomeni i rënies të grup-moshës nën 15 vjeç dhe rritja e pjesës së grupmoshave mbi 65 vjeç, prek të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Roskovec.

Bazuar në këto tendenca, dalim në përfundimin se pushteti, kryesisht ai lokal, duhet të ndërmarri masa për të parashikuar nevojat e reja, specifike të secilës grupmoshë. Që ndërhyrja publike të jetë eficiente Bashkia Roskovec duhet jo vetëm t'i përgjigjet me prioritet kërkesave të grupmoshave nën 15 vjeç dhe mbi 65 vjeç, por duhet të mbështesë njëkohësisht dhe popullsinë në moshë pune (në të cilën përfshihet dhe popullsia aktive që është burim të ardhurash dhe aktiviteti ekonomik).

Rëndësia e popullsisë në moshë pune dhe popullsia në varësi.

Popullsia aktive (e përfshirë në grupmoshën 15-65 vjeç) është një nga motorët ekonomik territorial, për shkak se kontribuon në sigurimet shoqërore dhe sociale dhe në aktivitetit prodhues dhe ekonomik të një territori.

Në këtë kontekst, koeficientet e varësisë janë treguesit të rëndësishëm të kapacitetit që ka një popullsia në një territor të caktuar, për të mbështetur popullsisë në varësi. Projeksioni i koeficientit të përgjithshëm të varësisë, i koeficientit të varësisë së moshës së re dhe projeksioni i koeficientit të varësisë të moshuarve, shërbejnë si indikatorë të rëndësishëm në vlerësimin e nevojave të ardhshme dhe orientimin e veprimit publik.

*Grafiku 6 Koeficienti i varësisë Bashkia Roskovec - 2016*




Census 2011, Instat, përpunoi Atelier 4

*Grafiku 7 Koeficienti i varësisë Bashkia Roskovec - 2021*




Census 2011, Instat, përpunoi Atelier 4

*Grafiku 8 Koeficienti i varësisë Bashkia Roskovec – 2026*




Census 2011, Instat, përpunoi Atelier 4


Rr. "Të Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap 47, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@...

*Grafiku 9 Koeficienti i varësisë Bashkia Roskovec - 2031*




Census 2011, instat, përpunoi Atelier 4

Projeksioni i koeficienteve të varësisë shfaq disa variacione ku vlen të përmenden:

- Koeficienti i varësisë të moshave të reja njeh një rënie nga 27% në 2016 në vetme 20.2% në 2031, Kjo grupmoshë nuk do të ketë me nevojë për të njëjtën mbështetje si sot.
- Koeficienti i varësisë të të moshuarve njeh një rritje nga 18.8% në 2016 në 29.4% në 2031. Popullsia rezidente e moshuar do të ketë më shumë nevojë për përkrahjen e popullsisë në moshë pune.
- Koeficienti i përgjithshëm i varësisë njeh një rritje nga 46.1% në 2016 në 49.5% në 2031. Kontributi I popullsisë në moshë punë, duhet të jetë dhe më i lartë në vitet e ardhshme

Në përfundim, mund të theksojmë se:

- mbështetja për moshat e reja pritet të jetë më e ulët,
- mbështetja për moshat e treta pritet të jenë më të larta,
- dhe në përgjithësi kontributi i popullsisë në moshë punë duhet të jetë më i lartë se ditët e sotme.

Thënë ndryshe tendenca e rënies se koeficientit të varësisë të moshave të reja, si dhe rritja e koeficientit të varësisë të të moshuarve, do të kërkojë rishikimin e ofertës së shërbimeve dhe investimeve publike, gjithashtu do të jetë e nevojshme të përmirësohet tregu i punës, të rritet aktiviteti ekonomik, të rriten kontributet në sigurime shoqërore dhe sociale, të rritet vlera e shtuar e krijuar etj.

Për një përgjigje efikase dhe eficiente ndaj tendencave demografike (migrimin, uljen e lindshmërisë, vjetërsimin e popullsisë dhe nevojat për mbështetje nga popullsisë në moshë punë) pushteti lokal duhet që:

- Të përmirësojë tregun e punës, duke synuar aktivizimin e të gjithë popullsisë aktive, dhe kryesisht popullsisë aktive të re.
- Të orientojë tregun e punës në sektorë me eficiencë ekonomike më të lartë, gjë që do të thotë zhvillimin e sektorit të shërbimeve dhe të industrisë (sektorë që ofrojnë të ardhura dhe një vlerë të shtuar më ta lartë se sektori i bujqësisë)
- Të rrisë kualifikimin e forcës punëtore, për të synuar përthithjen e bizneseve të reja në territor.
- Të rrisi aktivitetin ekonomik, duke mbështetur implementimin e bizneseve me potencial të lartë zhvillimi dhe vlere të shtuar,
- Të përmirësojë ndërlidhjet me tregjet rajonale dhe kombëtare, etj.
- Të shtojë shërbimet për të moshuarit.
- Të riorganizojë në mënyrë eficiente shërbimet arsimore primare dhe sekondare.
- Të stimulojë lindshmërinë dhe rinovimin e popullsisë në moshë pune.
- Të rrisi cilësinë e jetës dhe ndërveprimit social etj.


"Rr. Kosovarëve", Nd 35, H 6 Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2450105, e-mail: info@atelier4.al

## 3.5 Përcaktimi i territorit të bashkisë sipas 5 sistemeve

Njësitë e qeverisjes vendore, për qëllime planifikimi, ndahen në sisteme territoriale. Në territorin e bashkisë Roskovec gjënden 5 sistemet territoriale si në tabelën në vijim.

*Tabela 5 Sistemet territoriale*

| KODI I SISTEMIT | SISTEMI | SIPËRFAQE | |
|---|---|---|---|
| | | (ha) | % |
| UB | URBAN | 1528.76 | 12.12 |
| IN | INFRASTRUKTUROR | 146.27 | 1.16 |
| B | BUJQËSOR | 9897.26 | 78.46 |
| N | NATYROR | 898.78 | 7.12 |
| U | UJOR | 143.58 | 1.14 |
| TOTAL | | 12614.65 | 100% |

*Sistemi urban*

Sistemi urban zë një sipërfaqe prej 1528.76 ha të territorit të bashkisë Roskovec. Në pjesën më të madhe zgjerimi i zonës urbane ka ruajtur një linjë konstante në vite, duke veçuar qendrat e njësive administrative dhe qytetin e Roskovecit si zonat me përqëndrimin më të lartë të popullsisë dhe territori i cili ka pësuar ndryshimin më të madh të zonës urbane. Qyteti i Roskovecit, Strumi dhe Kumani janë territoret ku ka ndodhur dhe përqendrimi më i madh i ndërtimeve informale. Një element që ndikon ndjeshëm në sistemin urban në Bashkinë e Roskovecit është zona naftëmbajtëse në Marinëz e cila është fragmentuar nga puset dhe platformat e naftës duke humbur karakterin bujqesor duke u kthyer në segment shumë specifik të sistemit urban. Ky segment do të kërkojë një trajtim të veçantë në propozimet e PPV-së.

*Sistemi natyror*

Territori i Bashkisë Roskovec ka një sipërfaqe prej 898.78 ha që i përket sistemit natyror. Ky sistem është i përqëndruar në zonën më jugore të bashkisë. Sistemi natyror përbën një pasuri me potencial për zhvillimin e turizimit natyror dhe aktiviteteve të ndryshme në natyrë. Në vite sistemi natyror është transformuar në sistem bujqësor, tokat natyrore me bimësi të rrallë ose shkurre i kanë lënë vendin ullishtave duke ndikuar ndjeshëm në ekonominë e bashkisë.

*Sistemi bujqësor*

Sistemi bujqësor zë rreth 9897.26 ha dhe përbën sipërfaqen më të madhe të bashkisë, një sektor mjaft i rëndësishëm ekonomik. Bujqësia është e favorizuar nga klima e butë, sasia e bollshme e rreshjeve, rrjeti i pasur i lumenjve, rezervuareve dhe përrenjeve, duke ofruar prodhimtari të madhe të produkteve bujqësore për kulturat sezonale por edhe ato të përhershme. Pjesën më të madhe të tokave e zënë ato me pjerrësi 5-25%, të cilat takohen kryesisht në kodrat e buta. Sistemi bujqësor aktualisht përfaqësohet nga toka të lira, ndonëse serrat dhe aktivitetet ekonomike (magazina dhe punishte) kanë filluar të jenë një tranformim në rritje. Infrastruktura bujqësore zë një peshë të

rëndësishme në bashkinë e Roskovecit. Këtu përmendim Rezervuarin dhe skemat ujitëse të Kurjanit të cilat i shërbejnë jo vetëm bashkisë Roskovec por dhe Patos e Fier.

*Sistemi ujor*

Sistemi ujor ka një sipërfaqe prej 143.58 ha, përbëhet nga lumi Seman i cili shërben edhe si një kufi ndarës administrativ i territorit të bashkisë në pjesën veri-perëndimor, dhe këneta e zezë. Ruajtja e këtij sistemi është mjaft e rëndësishme për habitatet dhe ekosistemet që rriten pranë tij ndaj mbrojtja nga ndotja është një nevojë e menjëhershme.

*Sistemi infrastrukturor*

Sistemi infrastrukturor zë një sipërfaqe prej 146.27 ha. Ky sistem përfshin të gjithë rrjetin rrugor (rruge dhe sheshe) të bashkisë, si dhe rrjetet inxhinjerike nëntokësore apo ajrore dhe strukturat e shërbimit të këtyre rrjeteve: nënstacion elektrik, stacion TAP, pikë grumbullimi mbetjesh urbane etj. Përsa i përket rrjetit rrugor në territorin administrativ peshë zë aksi interurban dytësor SH73, ndërsa rrugët e tjera janë rrugë lokale me disa përjashtime në qytetin e Roskovecit ku ka rrugë urbane dytësore. I gjithë territori i bashkisë është i aksesueshëm por në disa fshatra rrugët e shtruara me çakull janë amortizuar së tepërmi dhe e bëjnë të vështirë aksesin.

Nga tabela vihet re se dominon sistemi bujqësor, ndjekur nga ai urban. Sistemi urban zë vetëm 12.12 % të territorit, por shpërndarja e madhe bën që çdo pjesë e territorit administrativ të jetë e banuar. Dëndësia e banimit në sistemin urban varion nga 1000 banorë/km$^2$ në Qytetin e Roskovecit dhe Strum, në 100 banorë/km$^2$ në fshatrat periferikë të bashkisë.


Rr. "F. Kosovarëve", Nd.35, H. 6, Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222604 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al



Figura 19. Harta e sistemeve territoriale

### 3.5.1 Analiza e përdorimit ekzistues të tokës

Nëse bëjmë një krahasim të përdorimit aktual të tokës me 22 kategoritë e VKM 686, verejmë që territori i Roskovecit përmban 19 kategori, mungojnë kategoritë ZU-Zonë ushtarake dhe NAR-Natyrë dhe argëtim. Ndërsa kategoria ITK - Infrastrukturë telekomunikacioni është pikësore dhe e mbivendosur me sistemin bujqësor dhe urban.

Në kategoritë e sistemit urban vërehet mbizotërimi i kategorisë A-Banim. Mbizotërimi i kësaj kategorie i krahasuar dhe me përqindjen e ulët të kategorive të shërbime publike apo atyre terciare është dëshmi e homogjenitetit të territorit por dhe e nevojës aktuale për lëvizje të popullsisë për të aksesuar shërbimet bazë. Përveç qytetit të Roskovecit ku ka një miksitet funksionesh dhe aktivitetesh, vendbanimet rurale janë kryesisht të orientuara drejt banimit, me një numër të vogël shërbimesh me pak ose aspak funksione dhe aktivitete sociale dhe kulturore.

Zëri i dytë me peshë në sistemin urban përbëhet nga kategoria IE-Industri dhe ekonomi. Kjo kategori përfaqësohet nga industria nxjerrëse e hidrokarbureve, që ndonëse shtrirjen e madhe territoriale ka pak ndikim në punësimin e popullsisë, e cila burim kryesor të të ardhurave ka bujqësinë.

Kategoria AS-Arsim dhe Kategoria SH-Shëndetësi ndonëse me sipërfaqe të kufizuara sigurojnë mbulimin e territorit me shërbime.

Kategoria S-Shërbime ka një shpërndarje në të gjithë territorin urban. Funksionet e kësaj kategorie gjenden të ndërthurura dhe në nënkategorinë A2-Banim dhe shërbime. Në territorin e bashkisë Roskovec nuk ka zona të mirëfillta shërbimi (qendra tregtare, qendra biznesi etj) por shërbimet janë në nivelin e lagjes dhe fshatit.

Kategoria IS-Institucione dhe kategoria SHA-Aktivitete shoqërore dhe argëtimi shtrihen kryesisht në qytetin e Roskovecit duke lëmë pa mbuluar pjesën tjetër të territorit.

Kategoria M-Monumente përfaqësohet nga 2 kisha të cilat ndodhen në zonë rurale.

Kategoria V-Varreza ndodhet në afërsi të vendbanimeve ose e rrethuar nga zona urbane, në rastine dytë problematika e afërsisë do të trajtohet rast pas rasti në propozimet e PPV-së.

Në sistemin infrastrukturor, kategoria INT-Infrastrukturë transporti zë sipërfaqen më të madhe të këtij sistemi në territor, kjo për faktin që kategoritë IEN-Infrastrukturë energjitike, ITK-Infrastrukturë telekomunikacioni, IUK- Infrastrukturë ujësjellës kanalizime janë lineare dhe pikësore, pjesa më e madhe e rrjeteve janë nëntokësore ose ajrore (linjat elektrike, Telekomunikacion), ndërsa janë strukturat si nënstacion, depo uji etj që zënë hapësirë territoriale. Përsa i përket këtyre kategorive në territor ka nevoja të ndjeshme për plotësime si të rrjetit ashtu dhe të strukturave.

Kategoria IMB–Infrastrukturë menaxhimi mbetjesh ka një impakt të lartë mjedisor në zonën e Marinzës. Kjo pikë grumbullimi hapur me ndërtimin e Inceneritorit të Fierit duhet reabilituar.

Në kategoritë e sistemit bujqësor, krahas kategorisë B-Tokë bujqësore, kategoria IB-Infrastrukturë bujqësore ka një rëndësi të veçantë nisur dhe nga fakti që kjo infrastrukturë shërben jo vetëm bashkinë Roskovec por një territor më të gjerë. Në sistemin bujqësor kategoria BA-Bujqësi banim është dëshmi e fragmentimit të tokës dhe të ndërtimeve pa kriter ndodhur në vitet e fundit.

Kategoria EB-Ekonomi bujqësore zë një sipërfaqe të papërfillshme krahasuar me nevojat e tregut dhe të vetë fermerëve për të strukturuar filierat bujqësore si në drejtim të prodhimit e magazinimit ashtu dhe në drejtim të shërbimeve plotësuese si agroturizmi etj.

Në sistemin natyror në territorin e bashkisë gjejmë vetëm kategorinë N-Tokë natyrore. Kjo kategori falë zhvillimit të bujqësisë është reduktuar duke u përqendruar vetëm në pjesën jugore të bashkisë. Ky segment natyror, pjesë e sistemit kodrinor që paraprijë malin e Shpiragut duhet ruajtur si pjesë një ekosistemi më të madh.

Kategoria U-Ujëra përfaqësohet nga 2 elementë të rëndësishëm territorial: lumi i Semanit dhe përrenjtë afluetë në tij dhe Këneta e Zezë. Këto dy sisteme janë një vlerë shumë e rëndësishme territoriale si nga pikëpamja e ekosistemit ashtu dhe nga përdorimi i tyre për ujitje. Këneta e Zezë


Rr. "Kosovarëve", Nd 35 H 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1010, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222604 / 2430195, e mail

e ndodhur në një pikë të ulët të fushës së Roskovecit është një burim i mirë furnizimi me ujë në raste kur rezervuari i Kurjani ka problematika thatësire. Ndërsa vetë uji i Semanit është integruar në sistemet vaditëse me ndërtimin e Stacioneve të Pompimit.

| KODI I SISTEMIT | SISTEMI | SIP (ha) | KODI | KATEGORIA | SIP (ha) |
|---|---|---|---|---|---|
| U | URBAN | 1528.76 | A | BANIM | 870.29 |
| | | | S | SHËRBIME | 11.21 |
| | | | IE | INDUSTRI DHE EKONOMI | 617.39 |
| | | | IS | INSTITUCIONE | 1.21 |
| | | | AS | ARSIM | 5.64 |
| | | | SH | SHËNDETËSI | 0.64 |
| | | | SHA | AKTIVITETE SHOQËRORE DHE ARGËTIMI | 5.13 |
| | | | M | MONUMENTE | 1.54 |
| | | | ZU | ZONA USHTARAKE | - |
| | | | V | VARREZË | 15.68 |
| IN | INFRASTRUKTUROR | 146.27 | INT | INFRASTRUKTURË TRANSPORTI | 144.53 |
| | | | IEN | INFRASTRUKTURË ENERGJITIKE | 0.01 |
| | | | ITK | INFRASTRUKTURË TELEKOMUNIKACIONI | - |
| | | | IUK | INFRASTRUKTURË UJËSJELLËS- KANALIZIME | 0.02 |
| | | | IMB | INFRASTRUKTURË MENAXHIMI MBETJESH | 1.69 |
| B | BUJQËSOR | 9897.26 | B | TOKË BUJQËSORE | 9450.89 |
| | | | IB | INFRASTRUKTURË BUJQËSORE | 286.88 |
| | | | EB | EKONOMI BUJQËSORE | 14.58 |
| | | | BA | BUJQËSI-BANIM | 144.90 |
| N | NATYROR | 898.78 | N | TOKË NATYRORE | 898.78 |
| | | | NAR | NATYRË DHE ARGËTIM | - |
| U | UJOR | 143.58 | U | UJËRA | 143.58 |

*Tabela 6 Kategoritë e përdorimit të tokës*



Figura 20. Harta e kategorive të përdorimit të tokës



Figura 21. Harta e nënkategorive të përdorimit të tokës


Rr. "E Kosovarëve", Nd 35, H. 6 Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430165, e-mail:

## 3.6 Analiza e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve [SWOT]

Analiza SWOT është një mënyrë për vlerësimin e aftësive konkuruese të bashkisë, si dhe një instrument që ndihmon autoritetet lokale të përqendrojnë kapacitetet e tyre në përfitimin maksimal nga pikat e forta territoriale, si dhe në zgjidhjet më efikase të problematikave për të synuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe për të siguruar një territor fleksibël në kohë.

"Pikat e forta" janë asete dhe potenciale të trashëguara të territorit bashkiak si peizazhet, lidhjet rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, kushtet e mira klimaterike, potencialet turistike, sisteme të mira bankare, potenciale investimi, menaxhim i mirë bashkiak dhe shërbime sociale e infrastrukturore.

"Dobësitë" janë faktorët që pengojnë zhvillimin e bashkisë, siç janë infrastruktura e pamjaftueshme, menaxhimi i dobët bashkiak, procedura administrative të komplikuara dhe menaxhimi i keq i trafikut.

"Mundësitë" mund të jenë ato projekte kombëtare ose ndërkombëtare që krijojnë vende pune dhe mundësi biznesi.

"Rreziqet" mund të rrjedhin nga problematika mjedisore ose mangësi në kapacitetet njerëzore.

Qëllimet e kësaj analize janë:

*Të nxjerrë në pah dhe të vlerësojë avantazhet konkuruese dhe potencialet e Bashkisë Roskovec;*

*Të analizojë perspektivën e zhvillimit të ardhshëm në lidhje me kërkesën dhe ofertën;*

*Të identifikojnë masat e nevojshme për të minimizuar efektet e kërcënimeve.*

SWOT është i artikuluar në katër shtylla kryesore për zhvillimin e vizionit. Këto shtylla janë bazuar në sistemet urbane dhe në dinamikat njerëzore dhe ekonomike të bashkisë. Shtyllat janë: Sistemi Natyror dhe Ujor, Sistemi Bujqësor, Sistemi Urban, Sistemi Infrastrukturor. Sistemet urbane janë detajuar në disa aktivitete ekonomike dhe nevoja të administratës publike, që janë kyçe në planifikimin e ardhshëm. Kjo ndarje është bërë sepse koncepti i planifikimit, nuk duhet të kufizohet vetëm me përcaktimin e hapësirës fizike, por bazohet më shumë në vlerësime ekonomike që trajtojnë çështje që lidhen me cilësinë e jetesës, ambientin dhe klimën për investime, menaxhimin e zonës urbane dhe rurale të bashkisë, sfidat e reja me të cilat qeverisja vendore përballet, si dhe kontekstin socio-ekonomik.

| BASHKIA ROSKOVEC | | | |
|---|---|---|---|
| SISTEMI BUJQËSOR | | | |
| PIKAT E FORTA | PIKAT E DOBËTA | MUNDËSITË | KËRCËNIMET |
| Rreth 81% e territorit të bashkisë Roskovec kategorizohet si tokë bujqësore. | Mungesë e formave të kooperimit dhe fragmentizimi i pacelave bujqësore | Vëmendje ndaj programeve në zhvillimin e mëtejshëm të formimit profesional për përmirësimin e kualifikimit të forcës punëtore në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | Burime financiare të kufizuara ne infrastrukturë bujqësore rrezikon degradimin dhe mos funksionimin e tyre. |
| Kushte klimatike të favorshme për prodhimin e një game të gjerë produktesh. | Fragmentizimi i tokës bujqësore, përshkak të puseve të naftës (Marinëz) | Preferenca e lartë e konsumatorëve Shqiptar për produkte vendase | Mungesa e përmirësimeve të rrjetit të infrastrukturës bujqësore. |
| Ofron forcë pune të mjaftueshme dhe relativisht të re. | Mungesë informacioni rreth standarteve të marketingut në tregjet Europiane dhe preferencat e konsumatorit. | Incentiva për zhvillimin e agroturizmit është një mundësi e re për promovimin e produkteve vendase. | Dështimi apo ulja e cilësisë së produkteve të fresketa, si rezultat i mungesës së pikave të grumbullimit, ruajtjes dhe vonesës së tregtimit, jashtë territorit te bashkisë. |
| Prodhimi i ullirit dhe përpunimi i vajit, traditë në bashkinë e Roskovecit. | Menaxhim jo i mirë i prodhimit (humbje pas vjeljes). | Mundësi në rritje për përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale. | Mbetja stok e prodhimeve bujqësore e blegtorale, si dhe të përpunuara, si rezultat i cilësisë së dobët dhe konkurencës së rajoneve të tjera e produkteve të importit. |
| Ekzistenca e disa pikave të grumbullimit për produktet bujqësore. | Mungesa e thertoreve, pikave të grumbullimit dhe ruajtjes së produkteve të gatshme e të përpunuara bujqësore e blegtorale. | Ngritja e pikave moderne të përpunimit dhe ruajtjes e magazinimit rrit sigurinë ushqimore të produktit dhe cilësinë e tij dhe nevojën për të prodhuar më shumë e me cilësi të pranueshme nga tregjet. | Ndotja e burimeve ujore, i tokes pjellore dhe kullotave nga mbetjet e industrisë nxjerrëse të naftës. |


Rr. "E Kosovarëve", Nd.33, H. 6,Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al

| | | | |
|---|---|---|---|
| Fillimi i disa iniciativave në sektorin bujqësor e blegtoral për krijimin e fermave të specializuara, me drejtim ullishtarinë, perimtarinë dhe fermat blegtorale me mbarështrimin e gjedhëve dhe shpendëve. | Mungesa e brendimit dhe e paketimeve të produkteve bujqësore e blegtorale, për paraqitjen e produktit në treg. | | |
| Ekzistenca e disa serave për prodhime të ndryshme. | | | |
| SISTEMI URBAN | | | |
| PIKAT E FORTA | PIKAT E DOBËTA | MUNDËSITË | KËRCËNIMET |
| Pozicion gjeografik i përshtatshëm (distancë relativisht e shkurtër me qendra me potencial të lartë të zhvillimit ekonomik si Fieri, Berati). | Mungesa e regjistrimit të pronësisë. | Mbështetje nëpërmjet instrumentëve financiare të BE dhe granteve konkurruese, fondit të zhvillimit të rajonit, etj. | Kriza ekonomike dhe emigrimit në Rajon. |
| Kosto e ulët e forcës së punës | Ekzistenca e varrezave pranë objekteve të banimit. | Zhvillimi i turizmit natyror, ekologjik, rural dhe agro-turizmit redukton efektin ekonomik negativ të sezonalitetit, rrit qëndrueshmërinë e turistëve. | Burime financiare të kufizuara |
| Zona urbane kryesisht të përqendruara, me intensitet të ulët ndërtimi, të përshtatura me relievin ekzistues. | Mungesa e një tregu lokal me standarte. | Projekti "100 fshatrat" në Luar sjell promovim të territorit drejt turizmit. | Largim i popullatës për shkak te mungesës së shërbimeve e mundësive të punësimit |
| Territor i pasur me gjurmë të vendbanimeve të lashta ilire dhe me objekte monument kulture. | Mungesa e rregullave dhe distancave minimale nga puset e nxjerrjes së naftës në vendbanime, dhe anasjelltas. | | |
| Forcë pune e mjaftueshme dhe relativisht e re | Forcë pune e pa profilizuar. | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesë e lartë e tregjeve të huaja për fruta-perimet e rajonit | Largimi i kuadrove si pasojë e migrimit. | | |
| | Mungesa e shërbimeve në fshatra. | | |
| | Shfrytëzim i pakët i pasurisë kulturore, për shkak të mungesës së promovimit. | | |
| **SISTEMI NATYROR DHE UJOR** | | | |
| **PIKAT E FORTA** | **PIKAT E DOBËTA** | **MUNDËSITË** | **KËRCENIMET** |
| Prania e disa zonave të mbrojtura me vlera të larta si: monumente Kulture, Kisha e "Shën Kollit" në Kurjan dhe e "Shën Gjergjit" në Strum. | Ndotja e elementëve natyrorë, përbën problem mjedisor, bujqësor dhe shëndetësor. (Puset e naftës, mbetjet urbane, etj) | Sinjalistikë e përshtatshme në funksion të monumenteve të natyrës | Zgjerimi i zonave urbane të paplanifikuara, mungesa e trajtimit të mbetjeve urbane dhe ujërave të zeza, cenojnë jo vetëm tokat bujqësore, por dhe pasuritë natyrore të rajonit. |
| Peizazh i padëmtuar natyror. | Vendgrumbullimi i mbetjeve pranë vendbanimit (Marinëz) | Propozimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar për zonën e Semanit. | Mosmarrja në konsideratë e pasurive natyrore mund të sjell degradim dhe shkatërrim gradual të tyre. |
| Burime ujore të mjaftueshme në dispozicion për furnizimin me ujë dhe kanalizimet. | Prerjet e pyjeve. | Pyllëzimi i disa zonave. | Probleme mjedisore që shkaktohen nga degradimi i pikës së grumbullimit të mbetjeve urbane. |
| Prania e lumit Seman ne kufirin verior te Bashkise | Problematika kryesore në rrjetin e furnizimit me ujë në Bashkinë e Roskovecit është riparimi i rrjetit kryesor shpërndarës në qytetin e Roskovecit, në Njësinë Strum dhe në Njësinë Kuman. | Permiresimi vlerave peisazhistike nepermjet investimeve ne teknologjine e nxjerrjes se naftes. | Mungesa e investimeve nga kompanitë naftenxjerrese dhe shtetit shqiptar |


Rr. "Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1010, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430155, e-mail: info@atelier4.al

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Mbulimi i vetem 35% e territorit të Bashkisë Roskovec nga rrjeti i UK ndërkohe që pjesa tjetër është me gropa septike. | Prania e një strategjie kombëtare të furnizmit me ujë dhe kanalizimeve. | |
| SISTEMI INFRASTRUKTUROR | | | |
| PIKAT E FORTA | PIKAT E DOBËTA | MUNDËSITË | KËRCËNIMET |
| Infrastrukturë e rrugëve urbane pjesërisht të rehabilituara | Mungesa e sinjalistikës përgjatë akseve kryesore.<br>Prania e zonave - njollave të zeza në aksin kryesor. | Përmirësim i infrastrukturës per aksesim më të mirë mes fshatrave- mundësi zhvillimi për ekonominë lokale dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare. | Mungesa e fondeve sjell degradim të infrastruktures. |
| Kalimi i TAP dhe ndërtimi i Stacionit në territorin bashkiak. | | Reabilitimi i aksit SH73 nga qeveria qëndrore. | Mungesa e funksionimit me energji në sasinë dhe cilësinë e duhur, rëndon ekonominë e zonës. |
| Vendbanime kryesisht të grupuara që lehtësojnë pajisjen me infrastrukturë | | | |

### 3.6.1 Përmbledhja e aspekteve pozitive

Nga analiza e gjithë elementëve të listuar në pikat e forta dhe mundësitë, mund të bëhet një përmbledhje më unifikuese e tyre, në referencë të sistemeve që ato përfaqësojnë.

Në lidhje me **sistemin infrastrukturor** spikasin pozicionimi dhe lidhja me zonat ekonomike Fier dhe Berati, e cila mundëson lidhje më të forta dhe potencial në zhvillimin e mëtejshëm të bashkisë.

Infrastruktura kryesore rrugore në gjendje të mirë mundëson krijimin me lehtësësi të infrastrukturës së transportit publik.

Prania e rrjetit TAP dhe stacioni të cilat në të ardhmen përbëjnë një potencial të rëndësishëm në furnizimin e popullsisë me gaz.

Prania e fushës naftëmbajtëse dhe gazi që sot digjet në natyrë përbëjnë një potencial për prodhimin e energjisë nga ky nënprodukt i hidrokarbureve.

Potenciali i lartë i rrezatimit diellor është një potencial tjetër në prodhimi në energjisë që duhet të shfrytëzohet në vitet në vijim.

Në lidhje me **sistemin urban** mund të listohen shërbimet institucionale në shkallë bashkie, monumentet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Bashkia ka realizuar dhe ka në planifikuar të realizojë ndërhyrje të rëndëshme në territor si në strukturimin e qendrave ashtu dhe në rikonstruksionin e objekteve publike. Ky fakt do të mundësojë në periudhën afat gjatë përqendrimin e bashkisë në përmirësime rrënjësore duke qënë se Bashkia e Roskovecit e ka kaluar fazën e ndërhyrjeve emergjente për normalizim të vendbanimeve.

Mbulimi i territorit me struktura arsimore dhe shëndetësore, fokuson ndërhyrjet e bashkisë në përmirësim të kushteve si rritja e eficencës energjitike, sigurimi i ngrohjes qëndrore etj.

Bashkia ka mundësitë të përqendrohet në programe konkrete në mbështetje të biznesit, si në rritje të kualifikimit të forcës punëtore ashtu dhe në orientimet ekonomike në territor.

Në lidhje me **sistemin bujqësor** ajo që spikat më shumë janë potencialet, që derivojnë prej kushteve të përshtatshme klimatiko-tokësore për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Territori i bashkisë ka filluar të orientohet drejt ullirit në kodra dhe serrave në fushë.

Infrastruktura bujqësore mirëmbahet rregullisht, ndonëse ende nuk ka një mekanizim të plotë të saj (psh veprat shkarkuese të rezervuarut të Kurjanit.)

Në lidhje me **sistemin natyror dhe ujor** mund të përmenden elementët që përbëjnë relievin gjeografik të bashkisë si: elementët e fortë natyrorë, pyjet, pasuritë e nëntokës, rezervat ujore, cilësia e ajrit, etj.

### 3.6.2 Problematikat dhe nevojat e evidentuara dhe rekomandimet për zbutjen e impaktit

Në linja të përgjithshme problematikat që hasen në sistemet që përbëjnë territorin e Bashkisë Roskovec janë të ndryshme.

Problematikat e **Sistemit Bujqësor** përfshijnë:

- Fragmentimin e tokës bujqësore
- Zënien e tokës nga ndërtimet informale
- Prania e puseve të naftës dhe ndotja që shkaktohet prej tyre
- Mungesa e filierës së plotë bujqësore e blektorale (mungesa pika grumbullimi, përpunimi etj)
- Mungesa në specialistë dhe në dije
- Organizim i dobët i komunitetit të fermerëve
- Nevoja për investime të vazhdueshme në infrastrukturën bujqësore, etj.

Në **Sistemin Natyror** problematika kryesore qëndron në tranformimin e tij në tokë bujqësore duke ndikuar negativisht në ekosistemet territoriale. Pasuritë natyrore janë pak të njohura dhe pak të shfrytëzuara.

Në **Sistemin Ujor** problematika qëndron në ndotjen e Semanit, ndonëse kjo ndotje është më e ndjeshme në grykëderdhjen e tij pas bashkimit me Gjanicën. Këneta e Zezë një pasuri e rëndësishme hidrike duhet vendosur në fokusn e duhur dhe shfrytëzuar si potencial për aktivitete në natyrë.

**Sistemi infrastrukturor** përballet me problematikat e investimeve të munguara në disa dhjetravjeçarë.

- Rruga Kombëtare SH73 është dëmtuar nga mjetet dhe për shkak të cilësisë së shtresave.
- Rruga bujqësore në jug të Semanit, nuk ka profilin e duhur për mjetet bujqësore dhe industriale që e përdorin.
- Ndonëse akset kryesore janë realizuar nga Bashkia, rrjeti rrugor ka nevojë të plotësohet në akset e vendbanimeve.
- Transporti urban i vendosur rishtasi ka nevojë për terminal dhe stacione
- Pikat e zeza të evidentura në territor duhet të trajtohen me përparësi.
- Infrastruktura e ujësjellësit është e plotësuar në pjesën më të madhe të territorit, por ka nevojë për investime në rrjetin kryesor shpërndarës.
- Fshati Ngjeqar ka nevojë për infrastrukturë të plotë si dhe sigurimin e një burimi të qendrueshëm uji, pasi ka mangësi në sasinë e ujit të disponueshëm.
- Rrjetet e kanalizimeve kanë nevojë të plotësohen dhe të bëhen të reja sipas nevojave specifike të çdo vendbanimi.
- Infrastruktura e furnizimit me energji duhet të stabilizohet për të siguruar shërbim optimal.

- Territori i Roskovecit ka burime të rëndësishme enegjie (gazi natyror në Marinëz dhe rrezatimi diellor) të cilat nuk shfrytëzohen.
- Ka zona të tëra urbane ku mungon ndriçimi publik
- Vendgrumbullimi aktual i mbetjeve në Marinëz, ndonëse i pajisur me leje mjedisore është shumë problematik për vendbanimin për ndotjet që shkakton.

**Sistemi urban** krahas problemeve që i shkaktohen nga gjendja jo e mirë e infrastrukturave përballet me probleme të karakterit social dhe ekonomik. Ndër problematikat sociale përmendim plakjen e pritshme të popullsisë dhe për rrjedhojë nevojën për një tjetër qasje ndaj shërbimeve publike. Migrimi i ndodhur vitet e fundit ka ardhur dhe si përgjigje e mungesës së jetës social kulturore në vendbanime, mungesës së arsimimit cilësor, tregut të pasigurtë të punës, etj.

- Problematikat e Sistemit urban mund të përmblidhen:
- Shtrirje e madhe e banesës në territor duke rritur largësinë nga shërbimet.
- Shërbime të grumbulluara në Qytet
- Nevojë në përmirësimin e cilësisë së objekteve sociale
- Mungesë e promovimit të territorit dhe traditave
- Ofertë e kufizuar banesash, në vitet e fundit ka mbizotëruar tipologjia "banesë individuale e veçuar" që shoqërohet me kosto të lartë (toka, mirëmbajtja, taksa etj).
- Mungesë e tregjeve ushqimore apo industriale të strukturuara
- Mungesa lulishtesh e kende lojrash për fëmijë
- Mungesa në qendra komunitare, e për grupet vulnerabël të shpërndara në të gjithë territorin.

Këto problematika do të trajtohen në PPV duke parashikuar një sërë masash: administrative, ekonomike dhe ndërhyrjesh në territor:

- Ristrukturimi i bashkisë për ta orientuar në mbështetje të zhvillimit ekonomik.
- Rekomandime për rikonstruksione, rikualifikime, rindërtime të infrastrukturës inxhinierike dhe sociale
- Rekomandime për breza mbrojtës dhe kufizues sipas nevojave për të minimizuar impaktin mjedisor ose rritur sigurinë.
- Rregulla dhe incentiva për të stimuluar zhvillimin ekonomik, përmirësuar vendbanimet, diversifikuar ofertën e strehimit.


Rr. "Kosovarëve", Nr. 55, H. 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1015, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222304 / 2430195. e-mail:

# 4 VIZIONI DHE STRATEGJIA

Hapi i parë në përcaktimin e pikë mbërritjes në 2035 është analiza se ku ndodhemi sot, duke krijuar një bazë për monitorimin e planit të veprimeve. Raporti i Analizës dhe Vlerësimit bazuar në të dhënat e disponueshme paraqet një tablo të qartë të bashkisë Roskovec.

Që në fazën e Analizës u ndërmorën disa pyetësorë dhe sondazhe në popullatë dhe zyrat e bashkisë. Plotësimi i skedave të fshatrave dhe pyetësorëve mbi prioritetet janë dëshmi dhe rezultat i këtij angazhimi të komunitetit në përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit.

Bashkia e Roskovecit është e angazhuar për një zhvillim dhe rritje të qëndrueshme. Strategjia jonë dëshmon vullnetin aktual për të mbrojtur burimet, për të rritur asetet dhe për të krijuar një rrugë drejt një territori fleksibël dhe gjallërim më të madh në çdo aspekt të jetës së komunitetit.

Strategjia territoriale ndërtohet mbi parimet dhe qëllimet e Zhvillimit të Qendrueshëm duke synuar përmirësimin e jetesës duke e bërë bashkinë një nga më të gjelbërat, më gjithëpërfshirëset, dhe ekonomikisht të qëndrueshme.

Parimet e zhvillimit të qendrueshëm do të merren në konsideratë në hartimin e projekteve të infrastrukturës, në përcaktimin e hapësirave publike dhe private të zhvillimit. Këto parime janë potencial për përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetin, duke ulur konsumin e energjisë, duke përmirësuar ajrin dhe cilësinë e ujit, dhe sigurimin e sa më shumë zgjedhjeje strehimi. Rritja dhe zhvillimi do marrin në konsideratë impaktin mbi strukturën aktuale të vendbanimeve duke plotësuar, rinovuar apo krijuar. Në këtë këndvështrim do të trajtohen: rrugët, parqet, hapësirat dhe shërbimet publike si dhe ndërtesat në funksion të tyre. Strategjia do të përcaktojë llojet e ndërhyrjeve dhe do të jetë plani territorial që do të përcaktojë vendndodhjet e sakta të këtyre shërbimeve dhe infrastrukturave publike.

Strategjia përcakton projekte të mëdha si parqet e reja, qendrat rekreative, qendrat e zhvillimit ekonomik, strukturat e mbrojtjes civile, shëndetësisë dhe arsimimit, por nuk përjashton ndërhyrjet e nevojshme në nivel lagjeje apo fshati: lulishte, parkim, kënde lojrash, kopësht-çerdhe etj.

Strategjia përcakton kornizën e zhvillimit që do të detajohet më tej me planin territorial të zhvillimit, planet e detajuara vendore dhe planet sektoriale në nivel bashkiak.

Vizioni i zhvillimit të Strategjisë territoriale detajohet me anë të objektivave strategjikë të përcaktuar në bazë të drejtimeve kryesore të zhvillimit. Në mënyrë që strategjia të shërbejë si një rrugë lidhëse mes territorit dhe politivave fiskale të bashkisë, këto drejtime janë lidhur me funksionet kryesore të bashkisë. Strategjia detajohet në 3 drejtime kryesore të zhvillimit.

- Zhvillimi ekonomik
- Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve
- Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe mjedisore

## 4.1 Vizioni i zhvillimit

*" Bashkia e Roskovecit, ndodhur ndërmjet poleve të zhvillimit të Fierit dhe Beratit, e avantazhuar nga pozicioni territorial midis fushës së Myzeqesë dhe kodrave të Mallakastrës, do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm social ekonomik, duke u përqendruar në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe duke krijuar kushte për zhvillimin e agrobiznesit dhe turizmit kulturor."*

Cilësia e jetës sigurohet dhe në aftësinë për të bashkëvepruar me njëri-tjetrin në ambiente urbane të sigurta, të pastra, me shëtitore e akse ciklistike, me shkolla dhe ambiente social-kulturore, ku të gjithë grupmoshat gëzojnë pasuritë kulturore e natyrore si dhe evenimente e aktivitete; baret e restorantet ku promovohen traditat e kësaj bashkie. Komuniteti pranon dhe vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së cilësisë të jetesës për gjeneratat e ardhshme.

Zhvillimi do të japë zgjedhje realë mbi mënyrën e jetesës, nga tipologjitë e banesës, mënyrat e lëvizshmërisë drejt vendeve të punës, shërbimeve, objekteve social kulturore, fetare, tregtare, argetuese etj. Në vendbanime do të rritet siguria dhe koha e përdorimit të hapësirave publike duke siguruar shërbimet dhe të mirat bazike të jetesës. Arsimimi do të jetë i aksesueshëm për të gjithë, i orientuar sipas nevojave të komunitetit dhe shtylla kurrizore e një mjedisi ekonomik të suksesshëm.

Qeverisja vendore e hapur, e drejtë dhe e përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit, siguron që të gjithë njerëzit të trajtohen në mënyrë të barabartë, me dinjitet dhe respekt, dhe të lirë nga diskriminimi. Këto parime janë bazë për ndryshime pozitive demografike.



*Figura 22. Harta e vizionit të zhvillimit*

## 4.2 Objektivat strategjikë të zhvillimit

Realizimi i vizionit kalon në disa hallka, të cilat për të mos humbur fokusin duhet të jenë të mirëstrukturuara, si në renditje ashtu dhe në shtrirjen kohore. Në zhvillimin e ardhshëm të territorit janë përcaktuar 3 drejtime kryesore të zhvillimit.

- Zhvillimi ekonomik
- Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve
- Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe mjedisore

Këto drejtime përkojnë me disa objektiva strategjikë:

A. Zhvillimi ekonomik

**Objektivi 1** Një ekonomi e balancuar që krijon vende punë të kualifikuara dhe një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e sektorit primar, industrisë dhe shërbimeve.

**Objektivi 2** Pushteti vendor bashkëpunues dhe transparent, nxitës i zhvillimit ekonomik me anë të politikave fiskale, nismave, promovimit dhe marketingut.

B. Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve

**Objektivi 3** Lagje dhe fshatra që sigurojnë një mjedis të sigurtë, mundësi ndërveprimi social dhe shërbime të orientuara drejt mirëqenies së banorëve

**Objektivi 4** Sigurimi i një varieteti tipologjish strehimi për të gjitha nivelet e të ardhurave, në të gjithë territorin, ofrimi i një larmie alternativash në zgjedhjen e mënyrës të jetesës dhe vendbanimit si përgjigje e ndryshimeve demografike.

**Objektivi 5** Sigurimi i një rrjeti transporti dhe mobiliteti të sigurtë, të aksesueshëm, të qendrueshëm.

**Objektivi 6** Sigurimi i rrjeteve dhe struktura inxhinjerike që sigurojnë një ambient të shëndetshëm duke ulur impaktin mjedisor.

C. Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe Mjedisore

**Objektivi 7** Ruajtja dhe rivlerësimi i elementeve të trashigimisë që janë themelet e qytetërimit dhe konfimojnë të shkuarën.

**Objektivi 8** Ruajtja e mjedisit natyror duke e integruar në aspektet argëtuese dhe sportive, me anë të krijimit të aksesit dhe mundësive për argëtim dhe shijim të natyrës.

**Objektivi 9** Integrimi i elementëve natyrore dhe kulturorë në jetën kulturore dhe artistike të bashkisë për të promovuar më tej territorin.


Rr. "Kosovarëve", Nd.35, H. 6, Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430135, e-mail: info@atelier4.al

## 4.3 Drejtimet e zhvillimit

Sikurse është shpjeguar më lart, strategjia detajohet në 3 drejtime kryesore të zhvillimit.

- Zhvillimi ekonomik
- Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve
- Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe mjedisore

### 4.3.1 Zhvillimi ekonomik

> **Funksione në fushën e zhvillimit ekonomik vendor**
> - *Hartimi i planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor*
> - *Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë*
> - *Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike*
> - *Organizim shërbimevesh në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj*
> - *Publikim i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj*
> - *Dhënia e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm duke garantuar akses të balancuar gjinor.*
>
> **Funksione në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit**
> - *Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit*
> - *Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve*
> - *Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural*
> - *Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.*
> - *Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor publik*
> - *Mbrojtja e natyrës e biodiversitetit*
>
> **Ekstrakt nga LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN**

Drejtimi "Zhvillimi ekonomik" prek dhe ndikon në të gjithë territorin bashkiak. Ky drejtim lidhet me funksionet e drejtëpërdrejta të bashkisë si në drejtim të shërbimeve ndaj biznesit ashtu dhe në sektorin primar dhe zhvillimin rural që është bazë e ekonomisë lokale. Ky drejtim krahas projekteve dhe programeve të drejtëpërdrejta të lidhura me funksionet e bashkive përfshin dhe programe të investimeve në infrastrukturë apo programe që synojnë realizim nga nisma private por që janë kyç për realizimin e Vizionit të Zhvillimit.

Funksionet e bashkisë në këtë drejtim zhvillimi janë shumë të drejtuara në burime njerëzore, mbështetje fiskale dhe promovuese. Sektori privat kthehet në gjeneratorin dhe realizuesin kryesor të këtij zhvillimi, ndërsa pushteti vendor luan rolin e drejtuesit dhe lehtësuesit të zhvillimit.

Bashkia e Roskovecit sot ka një ekonomi të orientuar të bujqësia, por mekanizimi i saj dhe shtimi i hallkave në magazinim, prodhim, tregtim do të ndryshojë bilancin në favor të sektorit industrial dhe shërbimeve. Brandimi, certifikimi dhe promovimi i produkteve lokale pritet të konsolidojë imazhin dhe konkurrueshmërinë e sektorit bujqësor, jo vetëm në tregun kombëtar, por dhe në tregun ndërkombëtar. Cilësia e lartë dhe mundësia e certifikimit «Bio» e produkteve lokale, rendisin sektorin bujqësor, si një ngë aktivitetet ekonomike kryesore të bashkisë.

Kultura dhe tradita e popullsisë lokale, është një tjetër element i rëndësishem territorial, që favorizon zhvillimin e sektorit të turizmit dhe diversifikimin e aktivitetit ekonomik të fermerëve lokalë. Vlerat e larta territoriale dhe pasuritë kulturore e natyrore të shfrytëzuara pak ose aspak do të rrisin peshën e turizmit dhe agroturizmit në ekonominë e zonës. Zhvillimi i strukturave si bujtina, fjetina, fjetje dhe mëngjes dhe kamping në një kuadër rural, i jep mundësinë fermerëve lokalë të zhvillojnë një aktivitet turistik që i mbivendoset aktivitetit të tyre tradicional, duke mundësuar zhvillimin e produkteve turistike si turizmi rural, agroturizmi dhe ekoturizmi, produkte këto që tërheqin një numër gjithnjë e më të lartë vizitorësh. Monumentet e kulturës, roli historik i zonës, monumentet e kultit, folklori dhe artizanati lokal, përbëjnë një forcë të rëndësishme në zhvillimin e produkteve turistike lidhur me kulturën lokale.

Industrializimi i buqësisë dhe qasja mjedisore në aktivitetet industriale ekzistuese është indikator i një nevoje për forcë pune të kualifikuar, si në arsimin profesional ashtu dhe në përfshirjen e kuadrove me arsim universitar dhe pasuniversitar. Popullsia ekzistuese ka nevojë për përditësim periodik të dijeve ndaj synohet krijimi i klasave të trajnimit për të rritur në qendrat komunitare që do të vendosen në vendbanimet kryesore. Sigurimi i një force pune të kualifikuar, me mjedise punësimi në kushte optimale do të shërbejë dhe si frenues i migrimit duke sjellë një stabilizim dhe ndryshim të trendeve demografike.

Transparenca në proçedurat e bashkisë, monitorimi periodik i territorit dhe marrja e masave në kohë për të evituar problematikat aktuale që derivojnë nga mungesa disavjeçare e investimeve, asistenca në orientim të investimeve, ndihma për bizneset apo individë, do të ndikojnë pozitivisht në ndryshimet e dëshiruara demografike.

### *Programet dhe nën programet*

**ZHVILLIMI EKONOMIK**

| ID | Programe | Nënprograme |
|---|---|---|
| 1.1 | Zhvillimi ekonomik i sektorit primar | Zhvillimi i filierave bujqësore |
| | | Zhvillimi i filierave blegtorale |
| 1.2 | Zhvillimi ekonomik i sektorit dytësor (industri) | Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e bizneseve |
| | | Rehabilitim i zonave ekzistuese jofunksionale, kthim në pole të rëndësishme |
| 1.3 | Zhvillimi ekonomik i sektorit terciar (shërbimeve) | Zhvillim i shërbimeve në lagje dhe fshatra |
| | | Turizmi rural dhe agroturizmi si mbështetje e zonave rurale |
| | | Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse pranë pikave të interesit turistik. |
| 1.4 | Infrastruktura në shërbim të zhvillimit ekonomik | Krijimi i akseve tematike si promovues të territorit |
| | | Përmirësimi i infrastrukturës ujitëse |


Rr. "Kosovarëve", Nd.35, H. 6 Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al

| | | |
|---|---|---|
| 1.5 | Marketimi (promovimi) i vlerave, traditave dhe produkteve (brand lokal) | Rrjeti i Promovimi të destinacionit turistik<br>Krijimi dhe promovimi i produkteve dhe paketës turistike |
| 1.6 | Promovimi i arsimit profesional | Mbështetja e sistemit arsimor<br>Mbështetja e burimeve njerëzore aktive |
| 1.7 | Mbështetje e biznesit | Mbështetja e bashkëpunimit<br>Lehtësira për bizneset. |
| 1.8 | Sigurimi i aksesit në informacion dhe transparencë. | Forcim i kapaciteteve administrative dhe teknike të bashkisë<br>Zhvillim i sistemeve TIK<br>Aksesi i komunitetit dhe biznesit në shërbimeve publike. |

## 4.3.2 Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve

**Funksione në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve**
- *Prodhim, trajtim, transmetim dhe furnizim me ujë të pijshëm.*
- *Mbledhje, largim dhe trajtim të ujërave të ndotura.*
- *Mbledhje dhe largim të ujërave të shiut dhe mbrojtje nga përmbytjet në zonat e banuara.*
- *Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e rrugëve vendore dhe e sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.*
- *Ndriçim të mjediseve publike.*
- *Transport publik vendor.*
- *Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantim i shërbimit publik të varrimit.*
- *Shërbim i dekorit publik.*
- *Parqe, lulishte dhe hapësira të gjelbra publike.*
- *Mbledhje, largim dhe trajtim i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.*
- *Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.*
- *Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.*
- *Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik.*
- *Planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit.*

**Funksione në fushën e Shërbimeve sociale**
- *Krijim dhe administrim i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj*
- *Ndërtim dhe administrim të banesave për strehimin social*
- *Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.*
- *Krijim, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve*

**Funksione në fushën e sigurisë publike**
- *Mbrojtje civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse*
- *Garantimin e shërbimit të zjarrfikëse, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse*
- *Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet*
- *Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.*

**Ekstrakt nga LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE**

Drejtimi "Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve" orientohet në vendbanimet e bashkisë, synon plotësimin e funksioneve dhe rindërtimin e infrastrukturës për të arritur dhe tejkaluar standardet minimale. Natyrisht funksionet e bashkisë të trajtuara në këtë drejtim vlejnë për të gjithë territorin por kanë impakt të drejtëpërdrejtë në zonat e banuara, sikurse funksione të tjera të bashkisë që kanë peshë në drejtimin ekonomik apo atë argëtues gjejnë vend në hapësirat urbane të vendbanimeve.

Vendbanimet kanë nevojë për shërbime të dedikuara dhe të menduara specifikisht sipas profilizimit të çdo vendbanimi. PPV do të parashikojë mbulimin e territorit me shërbime, por dhe hierarkizimin e tyre.

Vendbanimet kanë potencial për ndërveprim komunitar social, kulturor dhe argëtues. Potencialet kalojnë nga parqet te lulishtet, te shkollat e objektet administrative.

Përmirësimi i strukturës dhe investimi në rritjen e përdorimit të objekteve publike: shkolla të bashkuara me qendra komunitare, biblioteka e ambiente sportive, sheshe për përdorim të përditshëm apo aktivitete të organizuara në raste festash, të shoqëruara me rritjen e sigurisë, do të rrisë atraktivitetin e vendbanimit. Lidhja me transport publik e mbështetur nga rindërtime e përmirësime të infrastrukturës rrugore, në veçanti dhe asaj inxhinierike në tërësi, do të krijojnë alternativa të reja banimi dhe do të synojnë përthithjen e një popullsie të re krahas frenimit të migrimit.


Rr. "E Kosovarëve", Nd.35, H. 6.Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri · Tel: +3554 2222804 / 2430195. e-mail: info@atelier4.al

*Programet dhe nën programet*

STRUKTURIMI DHE GJALLËRIMI I VENDBANIMEVE

| ID | Programe | Nënprograme |
|---|---|---|
| 2.1 | Ruajtja dhe vlerësimi i karakterit të çdo vendbanimi | Krijimi i qendërzimeve lokale |
| | | Permirësimi dhe krijimi i strukturave e shërbimeve publike |
| 2.2 | Krijimi i një mjedisi të sigurtë dhe të përshtatshëm për aktivtetet e përditshme | Sistemim i peizazhit urban, ndriçim publik |
| | | Përshtatja e territorit dhe strukturave publike për PAK |
| 2.3 | Trajtimi i stokut të banesave | Tipologji të ndryshme banimi |
| | | Rritje e efiçencës energjitike |
| 2.4 | Krijimi i një rrjeti të plotë qarkullimi me standarde dhe infrastrukturë rrugore të rehabilituar | Rehabilitimi dhe shtimi e zgjerimi i infrastrukturës rrugore |
| | | Përmirësimi i transportit publik |
| | | Krijimi i potencialeve për transport alternativ |
| 2.5 | Sigurimi i rrjeteve dhe strukturave inxhinierike | Sistemi I furnizimt me ujë të pijshëm |
| | | Sistemi I kolektimit I ujrave te zeza |
| | | Mbështetje në përmirësimin dhe adaptimin e rrjetit të komunikacionit dhe energjetikës. |
| | | Infrastruktura e mbrojtjes mjedisore |

### 4.3.3 Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe mjedisore

> **Funksione në fushën e Kulturës, Sportit dhe Shërbimeve argëtuese**
>
> - *Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*
> - *Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*
> - *Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.*
> - *Organizimi i aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*
>
> **Funksione në fushën e mbrojtjes së mjedisit**
>
> - *Sigurimi, në nivel vendor, i masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.*
> - *Sigurimi, në nivel vendor, i masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.*
> - *Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.*
>
> Ekstrakt nga LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE

Drejtimi "Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe mjedisore" orientohet si në vendbanimet e bashkisë, por synon shtrirjen e kulturës, sportit dhe aktiviteteve në gjithë territorin bashkiak. Mbrojtja mjedisore dhe e biodiversitetit e tokave bujqësore arrihet më mirë duke i bërë këto elemente pjesë të jetës së komunitetit. Vizitat në objektet monument kulturor dhe natyror ndërgjegjësojnë komunitetin për vlerat natyrore në funksion të rritjes së mirëqenies ekonomike. Promovimi si vlerë e rëndësishme territoriale bën që masat e nevojshme mjedisore të konkretizohen në terren dhe të mos jenë thjesht rekomandime në letër. Krijimi i rrjetit të hierarkizuar të hapësirave publike të gjelbra ndikon në përmirësimin e peizazhit natyror por dhe atij urban duke sjellë përmirësime dhe në zbukurimin e vetë vendbanimeve si sfond i aktiviteteve kulturore të lidhura me traditat dhe zejtaritë. Në trajtimin e mjedisit rëndësi do i kushtohet dhe integrimit të sistemit bujqësor që në paralel me sigurimin e ushqimit për popullsinë siguron hapësirë të vlefshme të gjelbër. Në territor do të krijohet një rrjet hapësirash të gjelbra dhe sportive që integron në një hapësirat e mëdha dhe ndërhyrjet me hapësira sportive dhe rekreative në vendbanime në përputhje me bimësitë endemike.

*Programet dhe nën programet*

**ASPEKTET KULTURORE, REKREATIVE, SPORTIVE DHE MJEDISORE**

| ID | Programe | Nënprograme |
|---|---|---|
| 3.1 | Evidentimi dhe ruajtja e elementëve të historisë | Vlerësimi i elementëve të veçantë të trashëgimisë kulturore dhe historike |
| 3.2 | Krijimi i korridoreve turistike natyrore | Krijimi i parkut të Kurjanit |
| | | Krijimi i një rrjeti hapësirash të gjelbra dhe sportive |
| 3.3 | Krijimi i ambienteve për shfaqje kulturore pranë monumenteve të natyrës dhe kulturës | |


Rr. "Kosovarëve", Nd 35, H. 6.Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@atelier4.al




*Figura 23 Harta e drejtimeve te zhvillimit*

## 4.4 Nevojat për konvertime të sistemeve territoriale

Përgjatë viteve në territorin e bashkisë kanë ndodhur ndryshime, të cilat kanë ndikuar në gjendjen ekzistuese të sistemeve territoriale të bashkisë. Bazuar nga vizitat në terren, si dhe materialet e grumbulluara dhe studiuara gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm, është bërë e mundur të kuptohen ndërhyrjet e konsideruara prioritare për bashkinë.

Në territorin bashkiak do të akomodohen ato struktura dhe shërbime të cilat do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e gjendjes ekzistuese por do i përgjigjen dhe ndryshimeve në nivel kombëtar e rajonal. Ndërhyrjet prioritare të sygjeruara janë marrë në konsideratë edhe për ndryshimet e ndikimet që kanë në sistemet territoriale ku ato gjenden, të përmendura më poshtë:

Një nga sfidat kryesore lidhet me ndryshimet demografike, si në trende ashtu dhe në ndryshimet e grupmoshave. Strategjia me anë të një sërë politikash synon të ulë migrimin duke krijuar vende pune, të sigurojë kushte sociale për popullsinë në plakje, të ofrojë alternativa për të rinjtë si në strehim ashtu dhe në aktivitete e shërbime.

- Strukturimi i vendbanimeve

Strukturimi i qendrave të banuara, veçanërisht i atyre rurale do të shoqërohet me konvertime nga sistemi bujqësor në atë urban. Qëllimi në këto vendbanime është së pari, sigurimi i banesave për familjet e reja duke densifikuar dhe në pamundësi zgjeruar vendbanimin. Kjo tendencë prek të gjitha vendbanimet pavarësisht numrit të ulët të popullsisë. Në qendrat kryesore: qytet dhe qëndrat e njësive administrative tendenca për banesa të reja dhe zgjerim është më e lartë. Në vendbanimet kryesore është domosdoshmëri plotësimi i zonave me shërbimeve tregtare, aktivitete dhe shërbime sociale.

Një kategori e veçantë e banimit në territor është kategoria Bujqësi-Banim (BA) e cila ndonëse nuk ka nevojë për konvertim, ka domosdoshmëri për shërbime dhe struktura ndihmëse. Për shkak të situatës aktuale ku rreth 1/10 e popullsisë jeton në këtë kategori të shpërndarë në territor, kjo kategori do të analizohet rast pas rasti për të vlerësuar nevojën për kufizim, ngrirje apo konvertim në zonë urbane gjatë fazës së formulimit të planit territorial.

- Kthimi i rezervuarit bujqësor të Ngjeqarit në rezervuar uji të pijshëm

Zona e Ngjeqarit është një nga zonat më problematike në sigurimin e burimeve ujore për furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm. Një alternativë e propozuar është ndërhyrja në rezervuarin aktual të Ngjeqarit për të kthyer përdorimin e ujit nga përdorim për bujqësinë në përdorim uji të pijshëm. Bashkia është angazuar në gjetjen e burimeve të tjera dhe nga territore jashtë kufirit administrativ, si psh burime në Cfir. Deri në zgjidhjen përfundimare të kësaj problematike, strategjia sygjeron


Rr. "Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail

kthimin e këtij rezervuari nga Infrastrukturë Bujqësore (IB) në Infrastrukturë Ujësjellës Kanalizime (IUK), si alternativa më konkrete në territor.

Shfrytëzimi i territorit ka ndikuar ndjeshëm në zona të caktuara të ndotura, ku për të rritur mirëqenien e bashkisë duhet ndërhyrë me masa rehabilituese.

- Rikualifikim i zonave pranë puseve të naftës

Në këto zona, shfrytëzimi është bërë pa marrë në konsideratë minimizimin e impaktin në natyrë dhe në zonat urbane përreth. Këto zona duhet të jenë në monitorim të vazhdueshëm nga ana e bashkisë dhe strukturave përgjegjëse në nivel kombëtar. Zhvillimi i aktivitetit duhet të shoqërohet me masa rehabilituese.

Strategjia rekomandon kultivimin e bimësisë dekorative apo për bazë materiale në zonat ku ka përqendrim të lartë puse nafte kjo në mënyrë që cilësia e produkteve bujqësore të mos cënohet, por dhe këto lloje prodhimtarie bujqësore të shërbejë si "filtër" për ndotjen e mundshme të ajrit dhe tokës.

Propozimi afatgjatë në këto territore është ngritja e impianteve fotovoltaike të cilat së bashku me impiantet e prodhimit të energjisë nga gazi do të rrisin sasinë e energjisë të hedhur në rrjet.

- Rikualifikimi i venddepozitimit

Largimi i mbetjeve drejt Inceneritorit të Fierit do të mbyllë vendgrumbullimet aktuale dhe do të konvertojë sistemin infrastrukturor në sistem natyror.

Këto konvertime në nivelin strategjik janë përcaktuar si nevoja të domosdoshme, saktësimi dhe kuantifikimi i tyre do të bëhet si detajim i mëtejshëm në Fazën e Planit të Zhvillimit të Territorit.



*Figura 24 Harta e konvertimeve të tokës*

# 5 PLANI I VEPRIMEVE PRIORITARE, INVESTIMEVE STRATEGJIKE DHE PROJEKTEVE PILOT TË ZHVILLIMIT

## 5.1 Programet dhe plani i veprimit

Vizioni bëhet i zbatueshëm duke zbërthyer drejtimet e zhvillimit dhe objektivat strategjike përkatëse në programe dhe projekte. Zbatimi i programeve dhe projekteve, mbështetet në financat bashkiake dhe në mundësi të tjera potenciale financimi, sikurse do shpjegohet në vijim. Mundësitë e kufizuara financiare nga njëra anë dhe synimi për të patur një zhvillim të kontrolluar, bazuar në shfrytëzimin e ndërgjegjshëm të burimeve të territorit, diktojnë prioritizimin e projekteve dhe përcaktimin e indikatorëve monitories, si një mënyrë efiçente e implementimit të objektivave strategjikë.

Nga ana tjetër një instrument efikas i zbatimit të strategjisë është plani i zhvillimit territorial dhe rregulloret lokale në zbatim të tij; instrumenta të tjerë të implementimit dhe testimit të strategjisë janë zonat prioritare – pilot të zhvillimit. Këto zona jo vetëm që shërbejnë si orientim i parë i financimeve publike dhe private, por testojnë dhe saktësinë e propozimeve strategjike në situatën konkrete.

Bazuar në ligjin nr.9963 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", vlerësohet e nevojshme një standardizim i procesit të buxhetimit. Standardizimi, synon të lehtësoj dhe unifikoj buxhetimin e të gjitha financave të pushtetit vendor. Në këtë kontekst, udhëzimet dhe orientimet kanë qenë dhe janë drejtë unifikimit dhe lehtësimit të procesit të buxhetimit.

Projektet e identifikuara nga plani i përgjithsëm vendor kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi financat bashkiake, për këtë arsye zbatueshmëria e tyre lidhet ngusht me hartimin dhe parashikimet e Programit Buxhetor Afatmesëm. Në këtë kontekst, standardizimi dhe harmonizimi i planit të veprimit të identifikuar nga plani i përgjithshëm vendor, me standartet e programit buxhetor afatmesëm, është një hallkë e rëndësishme në ndërlidhjen dhe lehtësimin e vizionit të zhvillimit dhe parashikimeve financiare.

Që procesi i buxhetimit të jetë sa më transparent dhe i dobishëm, për secilin projekt të propozuar në palnin e veprimeve janë identifikuar funksioni (Ref. Sektori) dhe nënfunksionet (Ref. Programi) bashkiake që ndërlidhen me projektin/ndërhyrjen.

Standardizimi i planit të veprimit me procedurën e hartimit të Programeve Buxhetore Afatmesëm, synon të lehtësojë implementimin dhe zbatueshmërin e Planit të përgjithshëm vendor.

Plani Territorial i Zhvillimit nuk mund të trajtojë të gjithë gamën e problematikave të ngritura nga Strategjia Territoriale. Strategjia në përmbajtje të saj ka dhe elementë që kanë të bëjnë me aspektet

e dinamikave sociale dhe ekonomike të burimeve njerëzore, si dhe me aspekte që ndikojnë në politika sektoriale në rang bashkie, por dhe rajoni e kombëtar.

- Projektet të cilat lidhen drejtëpërdrejtë me territorin janë lokalizuar në hartë dhe në databazën GIS.
- Projektet të cilat janë politika janë cilësuar si të tilla në tabelë dhe nuk janë pasqyruar në hartë dhe në databazë.
- Projektet të cilat prekin të gjitha vendbanimet ose të gjithë territorin janë cilësuar si të tillë dhe nuk janë pasqyruar në hartë dhe në databazë.
- Projektet të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm territorial, ndonëse nuk mbulohen nga bashkia (jo pjesë e kompetencave të saj) janë cilësuar si të tillë duke përcaktuar përgjegjësitë përkatëse, në këto raste kostot e projektit përcaktohen nga strukturat pëergjegjëse. Në këtë rast zëri Kosto në databazë është "0".
- Në projekte të rëndësishme por komplekse të cilat kanë nevojë për studime paraprake buxheti gjithëashtu nuk është përcaktuar, dhe në këtë rast zëri Kosto në databazë është "0".


[illegible] Nr.35, H. 6, Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2420135, e-mail: [illegible]

| 1 | ZHVILLIMI EKONOMIK | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ID | Programe | Nënprograme | ID | Projekte | Objektivi Strategjik[10] | Përgjegjësia | Burim financimi | Kosto | Fazat e zbatimit (3 vjeçare) | | | | Vendndodhja | Kodi Sektori | Kodi Programi |
| | | | | | | | | (mln/ lekë) | Faza I | Faza II | Faza III | Faza IV | | | |
| 1.1 | Zhvillimi ekonomik i sektorit bujqësor | Zhvillimi i fermave bujqësore | 1.1.1 | Mbështetje dhe orientim të ngritjes të pikave agroeksportuese | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 047_Industri të gara |
| | | | 1.1.2 | Krijimi i tregut për produktet bujqësore të zonës | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 100.00 | | | | | Politike | 04_Çështjet Ekonomike | 041_Çështje e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës |
| | | | 1.1.3 | Mbështetje dhe orientim të ngritjes së fidanishteve | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politike | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.4 | Mbështetje dhe orientim në krijimin e bfeqeve frutore dhe ullishte | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.5 | Mbështetje dhe orientim në ngritjen e një pike përpunimi e magazinimi për frutat | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.6 | Mbështetje dhe orientim në modernizimin e pikave ekzistuese të përpunimit të ullirit (8 ekzistuese dhe një e re) | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.7 | Mbështetje në investim asistence teknike | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 5.00 | | | | | Politike | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.8 | Mbështetje dhe orientim për investime në infrastrukture agroteknike | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.9 | Mbështetje dhe orientim për ngritjen e një sere për prodhimin e fidaneve perimore | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politike | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.10 | Mbështetje dhe orientim në ngritjen e një pike grumbullimi rrushi dhe patatinë të prodhimeve perimore | Objektivi 1 | Bashki, AZHBR, Sipërmarrja private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | Zhvillimi i fermave blegtorale | 1.1.11 | Orientimi drejt dyfishimit të krerëve të shpendëve dhe një rritje prej 20% të lopëve dhe gjedhëve | Objektivi 1 | Sipërmarrja private, Bashki, AZHBR | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |

[10] Referohu kapitullit 4.2 Objektivat strategjikë të zhvillimit

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | (IPARD), donatorë | | | | | | | | |
| | | | 1.1.12 | Mbështetje dhe orientim në ngritjen dhe modernizimin e bashtave dhe pajisje transporti e ftohëse të produktive bregdetare | Objektivi 1 | Sipërmarrja private, Bashki, AZHBR | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatore | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.13 | Mbështetje dhe orientim në ngritjen e një thertore dhe pike ruajtje e magazinim të mishit, të të imtave dhe shpendëve. | Objektivi 1 | Sipërmarrja private, Bashki, AZHBR | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.14 | Mbështetje në investime për bazën ushqimore të të imtave | Objektivi 1 | Sipërmarrja private, Bashki, AZHBR | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 1.1.15 | Krijimi i tregut të gjësë së gjallë dhe therores | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 120.00 | | | | | Sipas hartës | 04_Çështjet Ekonomike | 041_Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës |
| 1.2 | Zhvillimi ekonomik i sektorit dytësor (Industri) | | 1.2.1 | Nxitje e zhvillimit të industrisë përpunuese ushqimore dhe lehtë duke identifikuar hapësira të përshtatshme | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 041_Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës |
| 1.3 | Zhvillimi ekonomik i sektorit terciar (shërbimeve) | Zhvillim shërbimeve në lagje dhe fshatra | 1.3.1 | Mbështetje dhe orientim në pikëpamjen me shërbime tregtare dhe gastronomike në lagje dhe fshatra | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, donatore | 2.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 041_Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës |
| | | | 1.3.2 | Krijimi i një tregu publik për qytetin | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 53.40 | | | | | Sipas hartës | 04_Çështjet Ekonomike | 041_Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës |
| | | | 1.3.3 | Hapësira të pajisura me infrastrukturë për tregtare ambulant dhe itinerant | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 12.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 041_Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës |
| | | Turizmi rural dhe agroturizmi e mbështetja e zonave rurale | 1.3.4 | Identifikimi i fermave me vlera agroturistike | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 3.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 047_Industri të tjera |
| | | | 1.3.5 | Mbështetja e aktiviteteve agroturistike për fshatrat Ngjeqar, Luar, Kurjan, Strum | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD), donatorë | 3.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 047_Industri të tjera |
| | | Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse pranë pikave në interesit turistik | 1.3.6 | Lokalizimi i strukturave të shërbimeve pranë objekteve të trashëgimisë kulturore dhe monumenteve të natyrës | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 3.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 047_Industri të tjera |
| | | | 1.3.7 | Krijimi i pikave panoramike turistike përgjatë akseve rrugore, bazuar në rrjetin rrugor dhe të pajisura me infrastrukturë mbështetëse në fshatin Ngjeqar, Luar, Kurjan, Strum | Objektivi 1 | Bashki, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, donatore | 10.00 | | | | | Politikë | 04_Çështjet Ekonomike | 045_Transporti |
| 1.4 | Infrastrukturë e shërbimeve | Krijimi i akseve turistike si | 1.4.1 | Krijimi i aksit nagyror-turistik (Roskovec-Ngjeqar) në drejtim të liqenit Kurjan, duke u lidhur me sistemin e rrugëve të Vlorë-Malakastër-Berat | Objektivi 1 | Bashkia | Bashkia, Sipërmarrja | 250.00 | | | | | Sipas hartës | 04_Çështjet Ekonomike | 045_Transporti |


Rr. "Elbasanit" Nd.33, H.5, Ap.4/1, Njësia Administrative Nr.5 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel +355 4 2222804 / 2480183, e-mail: info@atelier4.al

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | zhvillimit ekonomik | promovues të territorit | | | | | private, donatorë | | | | | | | | |
| | | | | Krijimi i kondicioneve turistike natyrore përgjatë kanalit Seman | Objektivi 1 | Bashkia | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 64.00 | | | | | Politike | 04_Cështjet Ekonomike | 045_Transporti |
| | | | 14.2 | Identifikimi i aksesve të përshtatshme për biçikleta për rezervatin, kanalet, kanali Seman (në rrugë dhe jashtë rrugë - shtigje natyrore) . Krijimi i hartave dhe pajisja e tyre me sinjalistikë | Objektivi 1 | Bashkia | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 25.00 | | | | | Politike | 04_Cështjet Ekonomike | 045_Transporti |
| | | | 14.3 | Identifikimi i shtigjeve natyrore dhe ndërlidhjet së tyre | Objektivi 1 | Bashkia | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 3.00 | | | | | Politike | 04_Cështjet Ekonomike | 045_Transporti |
| | | | 14.4 | Ndërtimi në përmirësimin e aksesit dhe pajisja me sinjalistikën përkatëse të shtigjeve, sipas normave. | Objektivi 1 | Bashkia | Bashkia, Sipërmarrja private, donatorë | 15.00 | | | | | Politike | 04_Cështjet Ekonomike | 045_Transporti |
| | | Përmirësimi i infrastrukturës ujitëse | 14.5 | Investime në infrastrukturë agroletrike | Objektivi 1 | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD) | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD) | 10.00 | | | | | Politike | 04_Cështjet Ekonomike | 047_Industri te tjera |
| | | | 14.6 | Mbështetje dhe orientim në zhvillimin e sistemeve të vaditjes dhe automatizimit. | Objektivi 1 | Bashkia, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD) | 10.00 | | | | | Politike | 04_Cështjet Ekonomike | 042_Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| | | | 14.7 | Përmirësimi e teknikave të ujitjes nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika | Objektivi 1 | Bashkia, Sipërmarrje private | Bashkia, Sipërmarrja private, AZHBR (IPARD) | 5.00 | | | | | Politike | 04_Cështjet Ekonomike | 042_Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
*Figura 26 Harta e fazave të projekteve të bashkisë Roskovec*

Në hartë janë ilustruar projektet prioritare për Bashkinë.

Këto projekte strategjike ndahen në:

- Projekte në nivel politikash në të cilën përfshihen objektiva dhe orientime të rëndësishme strategjike, psh në zhvillimin ekonomik.

- Projekte reale në terren, ku i jepet prioritet zhvillimit infrastrukturor (rrugë, ndriçimi rrugor, ujësjellës-kanalizime, telekomunikacion) zhvillimit të shërbimeve në funksion të komunitetit (rikonstruktim i shkollave, ndërtim i sheshеve dhe parqeve, ndërtim i qendrave komunitare, etj.), si dhe aplikimi i rregullave arkitektonike dhe strukturore, si rehabilitimi i vendbanimeve dhe ndërtimi me një gjuhë arkitektonike dhe tradicionale etj.
- Projekte të cilat prekin të gjithë territorin bashkiak.

Në bazë të zbatimit të tyre në mënyrën e duhur, duke siguruar një zhvillim sa më të qëndrueshëm për bashkinë, bazuar dhe në ndarjen e propozuar në Databazën e vënë në dispozicion nga AKPT, këto projekte janë ndarë në katër faza zbatimi:

*Faza e parë dhe e dytë e zbatimit*

Faza e parë është një fazë 1 vjeçare e cila liston ato projekte të cilat janë cilësuar si ndërhyrje emergjente nga bashkia dhe nga komuniteti, si dhe projektet që bashkia ka patur të evidentuar dhe kanë patur investim të sigurtë.

Në këtë fazë janë përcaktuar dhe të gjitha projektet që duhet të jenë pjesë e punës rutinë të bashkisë dhe që do të shtrihen në kohë. Viti i parë i zbatimit të PPV-së do të përcaktojë politikën dhe strategjinë që do të ndiqet për arritjet e këtyre objektivave ndaj do të ketë nevojë për angazhime shtesë në burime njerëzore, trajnime etj.

Në fazën e dytë të zbatimit 1-3 vjeçare janë listuar të gjitha projektet, të cilat janë të nevojshme për t'u realizuar në një afat kohor të afërt, duke u cilësuar si ndërhyrje të rëndësishme për bashkinë, të cilat shihen si nevojat më të domosdoshme për komunitetin. Në këtë fazë i është dhënë prioritet ndërhyrjeve të kategorizuara më poshtë dhe të detajuara në hartën e fazave të projekteve prioritare për bashkinë.

- Strukturimi i ofrimit të shërbimeve në
- Strukturimi dhe rigjallërimi i vendbanimeve duke plotësuar kërkesat e banorëve për shërbime dhe përmirësim të cilësisë së jetesës;
- Përmirësimi dhe rikonstruksioni i shërbimeve infrastrukturore [ndërtimi i akseve lidhës të fshatrave me njëri-tjetrin; ndërtimi i terminalit multimodal, përmirësimi i shërbimeve në furnizim me ujë, ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve, pastrime të kanaleve ujitës, rikonstruksion i nënstacionit elektrik, përmirësimi i ndriçimit publik dhe rrjetit të telekomunikacionit].


Rr. "E. Kosovarëve", Nd. 15, H. 6, Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222604 / 2430195, e-mail info@atelier4.al

*Faza e tretë e zbatimit*

Në fazën e tretë 4-10 vjeçare të zbatimit janë cilësuar projektet si në vijim:

- Strukturimi dhe rigjallërimi i vendbanimeve duke plotësuar kërkesat e banorëve për shërbime dhe përmirësim të cilësisë së jetesës [rikualifikim i fshatrave me interes për vizitorët, krijimi i tregut artizanal, ristrukturimi i ambienteve sportive të shkollave në fshatra, krijimi i klasave profesionale, qendra sociale ditore];
- Përmirësimi dhe rikonstruksioni i shërbimeve infrastrukturore (ndërtimi i impiantit të ujërave të ndotura, etj)

*Faza e katër e zbatimit*

Në këto faza mbi 10 vjeçare, janë përfshirë ato projekte që ndonëse të rëndësishme për zhvillimin e bashkisë kanë një kosto të lartë dhe ndikim të ulët në përmirësimin e jetesës.

Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet që duke u bazuar në kohëzgjatjen e hartimit të projekteve, ato mund të zgjasin në disa faza siç janë projektet për ndërtimin e akseve rrugore, për ndriçimin e fshatrave, përmirësimi rrjetit të telekomunikacionit apo masat mbrojtëse mjedisore.

Të gjitha projektet prioritare dhe me shtrirjen e tyre në fazat përkatëse janë të paraqituara në hartën e mësipërme.

## 5.4 Financat bashkiake dhe burimi i mundshëm i financimit

### 5.4.1 Financat bashkiake

Burimi kryesor i financimit të Buxhetit Lokal rrjedh nga të ardhurat ndërqeveritare dhe të ardhurat e veta. Janë pikërisht këto të ardhura dhe volumi i tyre që përcaktojnë performancën financiare të bashkive.

*Të ardhurat ndërqeveritare*

Të ardhurat ndërqeveritare, mund te ndahen në disa nënzëra:

Transferta e pakushtëzuar që është një fond që përcaktohet në bazë të një formule dhe variableve si popullsia, shërbimet urbane dhe sipërfaqja, e cila i tranferohet pushteti vendor nga buxheti i shtetit, me qëllim që bashkitë të plotësojnë funksionet dhe veprimtarinë e tyre.

Transferta Specifike, janë transferta që i tranferohen bashkive për të plotësuar disa funksione specifike si:

- Konviktet e arsimit parauniversitar
- Qëndrat e Shërbimeve Sociale
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)
- Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar
- Rrugët rurale
- Administrimi i pyjeve
- Ujitja dhe Kullimi

Janë pikërisht transfertat e pakushtëzuara dhe transfertat specifike të cilat zënë peshën kryesore të të ardhurave të bashkisë.

Për vitin 2018, bashkia Roskovec ka përfituar nga një transfertë e pakushtëzuar prej 106.7 milion lekë, e cila ka njohur një trend në rritje gjatë viteve të fundit, për shkak të ndryshimeve ligjore dhe rritjes se kontributit të pushteti qendror ndaj atij lokal.


Rr. ... 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430795, e-mail info@atelier4.al

*Grafiku 10 Transferta e pakushtëzuar*




Burimi : Ministria e Financave, përpunoi Atelier 4.

Krahas transferiës së pakushtëzuar që renditet si burimi kryesor i të ardhurave, transfertat specifike renditet si burimi i dytë për nga rëndësia. Transfertat specifike që financojnë disa nga funksionet e bashkisë, kanë njohur vitet e fundit një tendencë në rritje (gati 14% në 3 vitet e fundit), për të arritur vlerën totale prej 48.1 milion lekë në 2018.

*Tabela 8 Tranfertat Specifike*

| | Transfertat specifike Bashkia Roskovec | | |
|---|---|---|---|
| | 2016 | 2017 | 2018 |
| Konviktet e arsimit parauniversitar | 0 | 0 | 0 |
| Arsimi parashkollor | 18 461 | 20 373 | 22 326 |
| Arsimi parauniversitar | 1 948 | 1 857 | 2 275 |
| Mbrojtja nga zjarri | 0 | 0 | 12 944 |
| Mbrojtja sociale | 0 | 0 | 0 |
| Administrimi i pyjeve | 0 | 0 | 0 |
| Rrugët | 3 775 | 3 851 | 3 889 |
| Ujitja dhe Kullimi | 5 843 | 5 923 | 6 670 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Fond për Investime | 0 | | 0 |
| Total | 30 027 | 32 003 | 48 104 |

Burimi : Ministria e Financave, përpunoi Atelier 4.

Ne vija të përgjithshme, transfertat e kushtëzuar dhe transfertat specifike kanë njohur një rritje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, duke kaluar nga 102.4 milion lekë ne 2016 në 150.5 milion lekë në 2018, duke shënuar një rritje prej gati 47%.

*Grafiku 11 Transfertat në vite*




Burimi : Ministria e Financave, përpunoi Atelier 4.

## *Të ardhurat e vetë Bashkisë*

Të Krahas të ardhurave ndërqeveritare, të ardhura të tjera të rëndësishme janë dhe të ardhurat e vetë bashkisë që përbëhen nga të ardhura tatimore dhe jotatimore.

Të ardhurat tatimore rezultojnë kryesisht nga të taksat lokale si: taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa e pastrimit, taksa e pronës, tatimi ndaj biznesit, banesës, taksat e zënies së hapsirave publike, taksa e fjetjes në hotel etj.

Ndërsa të ardhurat jo tatimore rrjedhin nga tarifat dhe kontributet financiare të ndryshme në perfitim të bashkisë.

Per 2017, bashkia Roskovec ka realizuar 179,267 mijë lekë të ardhura, të cilat zënë vetëm 1.06 % të të ardhurave të mbledhura nga bashkitë, duke e renditur bashkinë Roskovec, në vendin e 18-të, të


Rr. "E Kosovarëve" ... Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222604 / 2430195, e-mail info@atelier4.al

renditjes së bashkive sipas realizimit të të ardhurave. Tek të ardhurat, 52,642 mijë lekë, ose 29.36 % janë të ardhura tatimore të grumbulluara nga bashkia Roskovec, ndërsa pjesa tjetër e të ardhurave rrjedhin nga tarifat dhe donacionet.

| Lloji i Taksës | Të ardhurat (mijë lekë) |
|---|---|
| Tatimi mbi biznesin e vogël | 1,259 |
| Tatimi mbi tokën | 30,624 |
| Tatimi mbi ndertesën | 7,947 |
| Taksa e fjetjes në hotel | 0 |
| Taksa e ndikimit në infrastrukturë e legalizimeve dhe e ndërtimeve të reja | 71 |
| Taksa e transaksioneve imobiliare | 0 |
| Taksa e rregjistrimit të automjeteve | 30 |
| Taksa për zënien e hapësirave publike | 2,293 |
| Taksa e tabelës | 184 |
| Tarifë për pastrimin dhe higjienën | 8,599 |
| Taksa e gjelbërt | 0 |
| Taksa të tjera | 1,634 |
| Të ardhura jo Tatimore | 126,626 |
| TOTALI | 179,267 |

Burimi: Ministria e Financave

Për vitin 2018 të ardhurat e bashkisë Roskovec vlerësohen 149.5 milion lekë, duke shfaqur fluktuacione të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Volumi i të ardhurave pritet të rritet dhe me tej, për shkak të ndryshimeve fiskale mbi taksën e banesës.

| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| Të ardhurat e veta | 66 393 780 | 179 267 000 | 201 430 260 | 149 467 630 |

Burimi: Ministria e Financave

Papralelisht me rritjen e të ardhruave të bashkisë vërehet sa ka dhe një rritje të shpenzimeve bashkiake, duke arritur vlerën prej 487.9 milion lekë në 2018.

| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet | 101 697 340 | 466 198 420 | 479 760 065 | 487 908 423 |

Burimi: Ministria e Financave

Shpenzimet bashkiake që rrjedhin nga shpenzimet per personel, shpenzimet, korrente, dhe shpenzimet për investime, janë pothuajse pesëfishuar gjatë katër viteve të fundit. Kjo kryesisht për pasojë të shpenzimeve për investim.

Për sa i përket autonomisë financiare ta bashkisë mund të themi se ende shpenzimet e bashkisë tejkalojnë ndjeshëm të ardhurat e vetë bashkisë.

*Grafiku 12 Të ardhura dhe Shpenzime në vite*




Burimi: Ministria e Financave

Si përfundim, mund të konfirmojmë se në përgjithësi Bashkia Roskovec, ka një performancë kryesisht pozitive nga pikëpamja financiare, duke shfaqur tendenca pozitive në të ardhrura.

Cilësia e kapitalit

Duke marrë në konsideratë aktivitetin ekonomik të zonës, si dhe orientimet dhe zhvillimet që derivojnë nga PPV, cilësia e kapitalit është e mirë dhe e qendrueshme pasi do mbështetet në burime njerëzore të kualifikuara dhe cilësore.

Buxhetimi i nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve

Shifra totale e projektit , prej 4455 milion lekë e tejkalon mundësinë financiare të bashkisë Roskovec në periudhë afatshkurtër. Duke qënë se financat janë të kufizuara, projektet do të zbatohen sipas fazave dhe prioritetit, ndikimin finaciar, social e ndikimit që kanë në mirëqënien e komunitetit. Për integrimin e projekteve në investimet e bashkisë, në buxhetimin afat shkurtër dhe mesëm, këto projekte do të shërbejën "bankë" nga e cila bazuar në kriteret e mësipërme dhe fazat e zbatimit do të bëjë integrimin në PBA-të periodike.


Rr. "E Kosovarëve", ... Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel +3554 2222604 / 243095, e-mail: ...

### 5.4.2 Burimi i mundshëm i financimit

Nisur nga këndvështrimi i procesit të planifikimit strategjik, mekanizmi i zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor konsiston në radhë të parë në identifikimin e projekteve të investimeve publike, si mishërim i politikave publike të synuara në planin e zhvillimit të territorit. Çdo projekt është në zbatim të një objektivi strategjik që synon arritjen e një situate të caktuar të zhvillimit të territorit në afatin e mesëm (i cili në terma kohor shkon nga 2-3 vjet), si fazë e ndërmjetme për arritjen e synimeve afatgjatë të PPV-së në një periudhë pesëmbëdhjetëvjeçare. Projektet janë grupuar në funksion të tre drejtimeve të zhvillimit, të cilët kanë të bëjnë shkurtimisht me zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, me strukturimin dhe gjallërimin e vendbanimeve, shoqëruar së fundmi me aspekte të ndryshme të zhvillimit kulturor dhe social.

Projektet e përzgjedhura pas diskutimit me komunitetin iu nënshtruan një procesi kostimi dhe përzgjedhje sipas kritereve të mëposhtme:

- **Efektiviteti i projektit** në lidhje me synimin strategjik, domethënë shkalla e lidhjes shkak/pasojë midis aktiviteteteve të projektit dhe synimeve që kërkohen të arrihen.
- **Efiçenca e projektit** domethënë shkalla e arritjes së synimit për njësi të kostos në vlerë monetare të projektit.
- **Shkalla e maturimit** të projektit që është një funkson i identifikimit të burimit të financimit të projektit: burime të vetat të bashkisë apo burime të tjera ku përfshihen burime të qeverisë qendrore, donatorëve apo financime private.

Të marra në tërësinë e vet këto tre kritere janë përdorur për të kaluar projektet e shpenzimeve kapitale nga procesi i kostimit në procesin e buxhetimit. Në këtë të fundit paraprakisht është llogaritur korniza fiskale, si një funksion i parashikimeve makroekonomike (domethënë faktorët e rritjes ekonomike të identifikuara në seksionet e mëparshme). Korniza fiskale ka shërbyer si pikënisje e identifikimi të tavaneve buxhetore për Roskovecin, në terma të shpenzimeve kapitale dhe aktuale në afat të mesëm, i cili është dhe hallka lidhëse e planit të investimeve prioritare me **Planin e Buxhetimit Afatmesëm (PBA).**

Në rastin e këtij plani fazat e zbatimit janë ndarë në 4 faza, për të lehtësuar integrimin e projekteve në procesin e buxhetimit. Supozimet e mëposhtme janë konsideruar thelbësore në lidhjen e Planit të Investimeve Prioritare me PBA-në:

- **PBA nuk konsiston vetëm në shpenzimet kapitale, por edhe korrente të absorbimit të strategjisë.** Kjo do të thotë që shkalla e zbatimit të PBA-së do të varet nga aftësia e njësisë shpenzuese për të përballuar me shpenzime korrente të natyrës së përgjithshme procesin e zbatimit të projekteve të shpenzimeve kapitale brenda tavaneve buxhetore. E thënë me fjalë të tjera kjo do të varet nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

aftësia e përballimit të programit të manaxhimit dhe administrimit (Programi 01110) për të zbatuar të gjitha programet e tjera buxhetore brenda tavaneve buxhetore.

- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet rekrutimit të personelit shtesë (domethënë metoda ekstensive) dhe përmirësimit të aftësive nëpërmjet trajnimeve mund dhe duhet të përmirësohet në mënyrë që i gjithë plani i investimeve prioritare të strategjisë të absorbohet. Niveli aktual i operimit duhe të përmirësohet jo më vonë se viti 2022 në mënyrë që ky plan të arrihet të zbatohet.
- Projektet e investimeve kapitale janë identifikuar me kodet përkatëse të nënfunksioneve të thesarit (si një shkurtim për programet buxhetore) duke specifikuar dhe burimin e financimit dhe hendekun përkatës.

Siç u shpjegua në fillim të këtij seksioni projektet prioritare janë programuar brenda një kornize fiskale që rrjedh prej faktorëve të rritjes ekonomike të identifikuar në seksionet e mëparshme të analizës ekonomike dhe është në përputhje me kuadrin e ri makrofiskal të publikuar nga Ministria e Financave.

Në aspektin e burimeve të ardhurat e konsideruara në këtë plan i korrespondojnë paketës fiskale në fuqi, e cila specifikon kategoritë e mëposhtme të burimeve tatimore dhe jotatimore të të ardhurave :

*Të Ardhura Tatimore*

- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të përdorura;
- Të ardhura nga sistemi i taksave vendore;
- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme;
- Taksa mbi ndërtesën;
- Taksa mbi tokën bujqësore;
- Taksa mbi truallin;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
- Taksa e tabelës;
- Taksa e fjetjes në hotel;
- Taksa të përkohshme.

*Të Ardhura Jotatimore*

- Të ardhura nga Tarifat Vendore;
- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave;
- Tarifa e ndriçimit rrugor;
- Tarifa e gjelbërimit;


Rr. "E Kosovarëve", Nr. 35, H 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel: +3554 2222804 / 2430195, e-mail: info@a4.al

- Tarifa për zënie hapësirë publike;
- Tarifa e shërbimit veterinar;
- Tarifa për liçenca dhe certifikata të transportit rrugor;
- Tarifa parkimi;
- Tarifa të tjera vendore;
- Të ardhura të tjera jotatimore;
- Të ardhurat nga qera ndërtese;
- Të ardhura nga qera troje;
- Të ardhura nga qera toke bujqësore;
- Të ardhura nga gjobat në nivel vendor;
- Të ardhura nga likujdimi i mjeteve kryesore.

Është menduar që periudha e PBA të shërbejë dhe si periudhë e ndërmjetme për rritjen e kapaciteteve për të mundësuar rritjen e kontributeve të tjera të burimeve të financimit në periudhat ndjekëse të PBA-së (për shembull burimet nga Qeveria Qendrore, Donatorë apo Financime Private, të cilat në periudhën aktuale të konfirmuara janë minimale).

Rritja e kontributit të burimeve të tjera është vendimtare, jo vetëm për të përballuar hendekun ekzistues, por sidomos për të rritur peshën e absorbimit të projekteve.

## 5.5 Ndryshime të nevojshme institucionale dhe ligjore

Projektet e parashikuar nuk kanë nevojë të drejtëpërdrejtë për ndryshime institucionale dhe ligjore pasi janë konform funksioneve të veta të bashkisë apo agjencive kombëtare dhe programeve e politikave në rang kombëtar e rajonal.

Në takimin paraprak të organizuar, pranë Bashkisë Roskovec, kompania konsulente në bashkëpunim me stafin e bashkisë diskutuan për bashkëpunimin e ekpertëve të kompanisë me stafin e bashkisë si në përcaktimin e prioriteteve ashtu dhe evidentimin e nevojave të tyre gjatë zbatimit të PPV-së. Nga njohja paraprake e organigramës u vu re një mangësi numerike në staf. Bashkia në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban ka të angazhuar Drejtorinë e planifikimit dhe zhvillimit të territorit me një staf prej 12 vetash në strukturë. Kjo drejtori përbehet nga 3 Sektorë: Sektori i planifikimit dhe i lejeve të ndërtimit, Sektori i projektimit dhe Sektori i regjistrimit të pronave. Nga takimi paraprak doli në pah mungesa e njohjes së programeve me bazë GIS. Procesi i punës së drejtorisë do të vlerësohet në detaj në fazat e mëtejshme për të kuptuar se si do të përballet puna në rritje pas miratimit të PPV-së. Faktor për vlerësimin e proceseve janë dhe formularët e vetëvlerësimit shpërndarë gjatë takimit paraprak.

Gjendja aktuale e strukturës së bashkisë ballafaquar me numrin e lartë të projekteve të nevojshme për t'u realizuar është indikator i nevojës që këto projekte të tenderohen dhe bashkia të luajë një rol monitorues e kontrollues të proceseve. Ky aspekt do të trajtohet me detaje në relacionin "Raporti për kapacitetet institucionale" pjesë e fazës së tretë të dorëzimit.


Rr. "F Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel: +3554 2227804 / 2430135, e-mail: info@atelier4.al

## 5.6 Indikatorët e monitorimit dhe të zbatimit të strategjisë

Projektet që lindin si nevojë e zbatimit të programeve strategjike, me qëllim arritjen e objektivave të zhvillimit, duhet të kalojnë gjatë fazës së realizimit të tyre nëpër një proces të mirëstrukturuar monitorimi. Fazat e këtij monitorimi sipas rëndësisë së tyre, referuar edhe grafikut kronologjik të zbatimit të projekteve të prezantuara në Raportin e Strategjisë, mund të realizohen bazuar në indikatorët monitorues të zbatimit:

a. Raportet periodike statistikore;

b. Respektimi i afateve të vendosura;

c. Përqindja e realizimit të projektit;

d. Impakti i këtyre projekteve gjatë zbatimit;

e. Elementët e ndikimit në mjedis;

f. Zbatimi i normativave dhe hallkave ligjore gjatë fazës realizuese;

g. Impakti i produktit final në ekonominë dhe mirëqenien e zonës.

Janë këto faktorë, të cilët krijojnë dhe bazën e premisat, për të evidentuar kushtet social-ekonomike të ndryshimeve të mundshme të PPV-së.

Duhet pasur parasysh, se për kryerjen e këtij procesi monitorimi, bashkia ka nevoja për rritje të kapaciteteve të tyre, shoqëruar gjithashtu me riformulim të strukturave organizative, nëpërmjet krijimit të zyrave statistikore dhe njësive të implementimit të projekteve.

Tabela 9. Tabela me të dhënat e indikatorëve të monitorimit për bashkinë

| DREJTIMI: ZHVILLIMI EKONOMIK | |
|---|---|
| **Objektivi** 1 Një ekonomi e balancuar që krijon vende punë të kualifikuara dhe një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e sektorit primar, industrisë dhe shërbimeve. | |
| Programet Strategjike | Treguesit e monitorimit |
| **Zhvillimi ekonomik i sektorit primar** | Eficenca prodhuese<br>Prodhimi për hektar, të ardhura për hektar etj.<br>Prodhimi për krerë, të ardhura për krerë etj.<br>Kulturat e mbjella (Sipërfaqet)<br>Sipërfaqe e përdorur në blegtori<br>Kapaciteti mbajtës i rezervuareve<br>Sipërfaqet e mbuluara me ujitje<br><br>Volumi i prodhimit blegtoral dhe nënprodukteve<br>Numri i krerëve<br><br>Numri i bizneseve të sektorit,<br>Numri i të punësuarëve<br>Numri i pikave të grumbullimit dhe përpunimit (Kapaciteti mbajtës)<br>Kapaciteti i tregut/tregjeve<br>Sipërfaqe e tregjeve<br>Numri i mjeteve motorike të përdorura në bujqësi dhe blegtori<br>Numri i pajisjeve në mbështetje të prodhimit dhe përpunimit |
| **Zhvillimi ekonomik i sektorit dytësor (industri)** | Numri i bizneseve të sektorit<br>Biznese me seli të vendosur në territorin administrativ<br>Nr i te punesuarve |
| **Zhvillimi ekonomik i sektorit terciar (shërbimeve)** | Numri i bizneseve të orientuara në ofrimin e shërbimeve dhe turizëm<br>Numri i agro-turizmeve me sistem akomodimi<br>Numri i strukturave akomoduese dhe Kapaciteti akomodues<br>Numri i shërbimeve Turistike<br>Numri i vizitorëve pranë Monumenteve të Kulturës<br>Numri i turistëve |
| **Infrastruktura në shërbim të zhvillimit ekonomik** | Metra lineare infrastrukturë e reabilituar<br><br>Raportet periodike 4-6 mujore mbi monitorim dhe mirembajtje. |



Rr. "E Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap.4/1. Njesia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2450195, e-mail: info@atelier4.al

| Objektivi 2 Pushteti vendor bashkëpunues dhe transparent, nxitës i zhvillimit ekonomik me anë të politikave fiskale, nismave, promovimit dhe marketingut. | |
|---|---|
| **Programet Strategjike** | **Treguesit e monitorimit** |
| **Marketimi (promovimi) i vlerave, traditave dhe produkteve (brand lokal)**<br><br>**Promovimi i arsimit profesional**<br><br>**Mbështetje e biznesit**<br><br>**Sigurimi i aksesit në informacion dhe transparencë.** | Prodhimi i brendshëm bruto.<br><br>Vlera e Shtuar bruto.<br><br>Të ardhura për banor.<br><br>Formalizimi kontraktual i prodhueshmërisë dhe tregtisë.<br><br>Certifikimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale.<br><br>Numri i fermave, dhe shërbimeve te certifikuara në cilësi.<br><br>Numri i frekuentimit të sistemeve - agroturizëm.<br><br>Numri i fermerëve me investime të përbashkëta.<br><br>Numri i subjekteve prodhuese bujqësore dhe blegtorale në pronësi të disa fermerëve lokal.<br><br>Numri i evenimenteve në lidhje me produktet bujqësore, blegtorale.<br><br>Pjesëmarrja në panaire.<br><br>Panaire dhe festivale promovuese të organizuara.<br><br>Numri i faqeve ëeb/ Blog/ Forume etj. në promovimin e pikave kulturore, natyrore, ekologjike etj.<br><br>Numri i Shërbimeve të të promovuar në internet.<br><br>Takime sensibilizuese dhe informuese në mbrojtjen e mjedisit. |

<table>
<tr><th colspan="2">DREJTIMI: STRUKTURIMI DHE GJALLËRIMI I VENDBANIMEVE</th></tr>
<tr><td colspan="2">Objektivi 3 Lagje dhe fshatra që sigurojnë një mjedis të sigurtë, mundësi ndërveprimi social dhe shërbime të orientuara drejt mirëqenies së banorëve</td></tr>
<tr><th>Programet Strategjike</th><th>Treguesit e monitorimit</th></tr>
<tr><td>Ruajtja dhe vlerësimi i karakterit të çdo vendbanimi</td><td>Densiteti i vendbanimeve<br>Numri i shërbimeve publike<br>Sipërfaqe e gjelbëruar<br>Sipërfaqe rekreative<br>Sipërfaqe sportive<br>Diversifikimi i funksioneve<br>Sipërfaqe e rikualifikuar<br>Sipërfaqë e rezervuar<br><br>Numri i ambienteve administrative<br>Numri i ambienteve kulturore<br><br>Numri i ambienteve arsimore<br>Kapaciteti i ambienteve arsimore<br>Numri i nxënësve<br>Numri i mësuesve<br>Sipërfaqja rekreative e ambienteve arsimore<br>Numri i ambienteve laboratorike për ambjent arsimor<br>Lidhja e ambienteve arsimore me rrjetin TIK<br>Numri i ambienteve shëndetësore (ambulanca, urgjenca, spitale etj.)<br>Kapaciteti i ambienteve shëndetësore (numri i shtretërve)<br>Numri i mjekëve dhe infermierëve në ambientet shëndetësore<br>Nr i strukturave të ristrukturuara<br>Nr i aktiviteteve<br>Nr i Qendrave komunitare</td></tr>
<tr><td colspan="2">Objektivi 4 Sigurimi i një varieteti tipologjish strehimi për të gjitha nivelet e të ardhurave, në të gjithë territorin, ofrimi i një larmie alternativash në zgjedhjen e mënyrës të jetesës dhe vendbanimit si përgjigje e ndryshimeve demografike.</td></tr>
<tr><th>Programet Strategjike</th><th>Treguesit e monitorimit</th></tr>
<tr><td>Trajtimi i stokut të banesave<br><br>Krijimi i një mjedisi të sigurtë dhe të përshtatshëm për aktivitetet e përditshme</td><td>Vlera e tokës<br>Vlera e e apartamenteve<br>Vlera e qerasë<br>Sipërfaqja dhe numri i banesave bosh<br>Numri i banesave aktive</td></tr>
</table>


Rr. "F. Kosovarëve", Nd.35, H. 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430185, e-mail: info@atelier4.al

| | |
|---|---|
| | Cilësia dhe amortizimi i banesave<br>Nevoja për banesa sociale<br>Numri i banesave të rikonstruktuara<br>Numri i qendrave sociale dhe numri i popullsisë në nevojë të strehuar (pa strehë, gra dhe fëmijë të dhunar etj)<br>Kapaciteti i shtëpisë për të moshuar |
| **Objektivi 5** Sigurimi i një rrjeti transporti dhe mobiliteti të sigurtë, të aksesueshëm, të qendrueshëm. | |
| Programet Strategjike | Treguesit e monitorimit |
| Krijimi i një rrjeti të plotë qarkullimi me standarde dhe infrastrukturë rrugore të rehabilituar | Km rrugë të rehabilituara<br>Km rrugë të reja<br>Numri i pasagjerëve / udhëtarëve<br>Numri i mjeteve private<br>Numri i automjeteve të transportit publik dhe privat (autobuzëve / mikrobuzëve)<br>Numri i linjave të transportit publik<br>Zonat e mbuluara me transport publik<br>Numri i stacioneve<br>Numri i përdoruesve të rregullt të transportit publik (abone)<br>Frekuencat e përdorimit të transportit<br>Sipërfaqja e rrugëve të asfaltuara<br>Numri i aksidenteve |
| **Objektivi 6** Sigurimi i rrjeteve dhe struktura inxhinjerike që sigurojnë një ambient të shëndetshëm duke ulur impaktin mjedisor. | |
| Programet Strategjike | Treguesit e monitorimit |
| Sigurimi i rrjeteve dhe strukturave inxhinierike | Sipërfaqe e mbuluar nga furnizimi me ujë të pijshëm<br>Numri i banesave që nuk kanë akses në ujë të pijshëm<br>Volumi i ujit të pijshëm i vënë në dispozicion<br>% e reduktimit të humbjeve në rrjet<br><br>Sipërfaqe e mbuluar nga kanalizimet<br>Numri i banesave që nuk kanë akses në kanalizimet e ujrave të zeza<br>Kapaciteti i Impiantit të trajtimit<br><br>Numri i rrugëve, shesheve me ndriçim publik<br><br>% e rrjetit elektik të rindërduar<br>Stabiliteti i furnizimit me energji<br><br>Mbulimi i vendbanimeve me fibrave optike<br>Numri i strukturave publike të pa lidhura me internet |

| | |
|---|---|
| | Strukturave mbrojëse, diga prita etj të reabilituara<br><br>Pemë të mbjella pranë zonave me erozion tokësor dhe lumor<br><br>Nr i zonave të ndotura të reabilituara<br>Sipërfaqe e rehabilituar<br><br>Sipërfaqe e brezave mbrojtës pranë lumenjve, industrive etj. |

| DREJTIMI: ASPEKTET KULTURORE, REKREATIVE, SPORTIVE DHE MJEDISORE | |
|---|---|
| **Objektivi 7** Ruajtja dhe rivlerësimi i elementeve të trashigimisë që janë themelet e qytetërimit dhe konfimojnë të shkuarën. | |
| Programet Strategjike | Treguesit e monitorimit |
| **Evidentimi dhe ruajtja e elementëve të historisë** | Tabela shënjuese dhe shpjeguese<br>Km korridor historik i realizuar<br><br>Sipërfaqe me infrastrukturë evenimensh ne zonat e trashigimisë<br><br>Nr i strukturave të vendosura në mbrojtje<br><br>Nr i strukturave të restauruara dhe/ose të përshtatura<br><br>Nr aktivitetesh të realizuara<br><br>Vepra arti te lokalizuara në territor |
| **Objektivi 8** Ruajtja e mjedisit natyror duke e integruar në aspektet argëtuese dhe sportive, me anë të krijimit të aksesit dhe mundësive për argëtim dhe shijim të natyrës.<br><br>**Objektivi 9** Integrimi i elementëve natyrore dhe kulturorë në jetën kulturore dhe artistike të bashkisë për të promovuar më tej territorin. | |
| Programet Strategjike | Treguesit e monitorimit |
| **Krijimi i korridoreve turistike natyrore**<br><br>**Krijimi i ambienteve për shfaqje kulturore pranë monumenteve të natyrës dhe kulturës** | Sipërfaqe parku: natyrore dhe me shërbime<br>Sipërfaqe e rikualifikuar<br><br>Nr i pikave panoramike të realizuara<br><br>Nr i kendeve sportive nëpër vendbanime |


Rr. "E Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail

| | |
|---|---|
| | Nr i pemëve të mbjella në zonat urbane dhe përgjatë akseve rrugore<br><br>Km Korridoresh peizazhistik<br>Km Korridoresh çiklistike<br>Përdorues biçikletash<br><br>Numri i aktiviteteve në lidhje me natyrën dhe ekologjinë |

# 6 ANEKSE

## A – SKEDAT E PROJEKTEVE

| | |
|---|---|
| TITULLI I PROJEKTIT | Ndërtimi i stadiumit të qytetit të Roskovecit |
| TIPI I PROJEKTIT | Arredimi Urban, Arkitekturë, Zhvillim ekonomik, Social |
| VENDNDODHJA E PROJEKTIT | Roskovec |
|  |   |
| SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN | Stadiumi ekzistues në territoirn e bashkisë ka humbur cilësinë e nevojshme dhe me standarde për të organizuar aktivitete sportive, rrjedhimisht nuk frekuentohet as nga banorët as nga skuadrat e bashkisë. |
| PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT | Stadiumi i Roskovecit ka mundësi për rikonstruksion dhe rivitalizim të hapësirave e shërbimeve të nevojshme. Ka një hapësirë të gjerë dhe ofron mundësi të mira për zhvillim e këtij projekti. Projekti do përfshijë, rehabilitimin e fushës së futbollit, dhe krijimin ose rikonstruktimin e ndërtesës së shërbimeve. |
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT (OBJEKTIVAT) | Rikonstruksion i stadiumit për të rikthyer aktivitetet sportive në zonë. |
| NDIKIMI/ REZULTATET E PRITSHME | Rritja e aktivitetit social<br>Bashkëveprim i ngushtë me komunitetin<br>Veprimtari sportive |


Rr. "E Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1013, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2227804 / 2430195, e-mail: [illegible]

| | |
|---|---|
| | Zhvillim ekonomik në zonë |
| **PËRFITUESIT** | Bashkia, banorët |
| **BURIMI I FINANCIMIT DHE PARTNERËT E MUNDSHËM** | Donatorët, FSHF |
| **AKTIVITETE STRATEGJIKE** | Hartimi I projektit<br><br>Zbatimi I projektit |
| **VLERËSIMI I KOSTOS** | 409.4 mil/lekë |
| **PRIORITETI** | Faza III |
| **AFATET DHE KOHËZGJATJA** | 3 vite |

ATELIER 4 STUDIO ARKITEKTURE

| TITULLI I PROJEKTIT | Tregu industrial dhe urban |
|---|---|
| TIPI I PROJEKTIT | Arredim urban, zhvillim ekonomik |
| VENDNDODHJA E PROJEKTIT | Roskovec |
|  | |
| SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN | Mungesa e tregjeve me standarde për tregtimin e foragjereve si produktet vendase. |
| PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT | Projekti synon krijimin e disa kushteve dhe strukturave për tregtimin e produkteve, duke respektuar standartet e nevojshme. |
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT (OBJEKTIVAT) | - Sistemim i tregut – tezgat permanente dhe tezgat e përkohshme (tregtimi me ditë të përcaktuara);<br>- Krijimi i kushteve optimale për tregtarët dhe për fshatarët që duan të shesin produktet e tyre;<br>- Sistemimi i aksesit në zonë;<br>- Sistemi i parkimeve. |


Rr. "E Kosovarëve", Nd 35, H. 6, Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail info@atelier4.al

| | |
|---|---|
| NDIKIMI/ REZULTATET E PRITSHME | Nga ndërtimi i tregut përfitojnë banorët e zonës ku do ndërtohet, por edhe banorët e fshatrave përreth për shitjen e produkteve të tyre blegtorale. |
| PËRFITUESIT | Bashkia, banorët |
| BURIMI I FINANCIMIT DHE PARTNERËT E MUNDSHËM | Bashkia, Donatorët, FSHZH |
| AKTIVITETE STRATEGJIKE | Hartimi i projektit<br>Ndërtimi i tregut<br>Përcaktimi i qerasë dhe taksave për tezgat |
| VLERËSIMI I KOSTOS | 53.40 mil/lekë |
| PRIORITETI | Faza I |
| AFATET DHE KOHËZGJATJA | 1 vit |

| TITULLI I PROJEKTIT | Tregu i gjesë së gjallë dhe thertore |
|---|---|
| TIPI I PROJEKTIT | Arredim urban, zhvillim ekonomik |
| VENDNDODHJA E PROJEKTIT | Roskovec |
|  |  |
| SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN | Rritja dhe mbarështimi i bagëtive është specifike për këtë territor, ashtu edhe për zonat përreth. Një nga problemet që hasen është mungesa e një tregu fizik për shitjen e gjesë së gjallë dhe thertoreve. |
| PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT | Projekti synon krijimin e disa kushteve dhe strukturave për tregtimin e gjësë së gjallë, duke respektuar standartet e nevojshme. |
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT (OBJEKTIVAT) | - Sistemim i tregut – tezgat permanente dhe tezgat e përkohshme (tregtimi me ditë të përcaktuara);<br><br>- Krijimi i kushteve optimale për tregtarët dhe për fshatarët që duan të shesin produktet e tyre;<br><br>- Sistemimi i aksesit në zonë; |


Rr. "E Kosovarëve", Nd.35, H. 6,Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222604 / 2430155, e-mail: info@atelier4.al

| | |
|---|---|
| NDIKIMI/ REZULTATET E PRITSHME | Nga ndërtimi i tregut të gjësë së gjallë përfitojnë banorët e zonës ku do ndërtohet, por edhe banorët e fshatrave përreth për shitjen e produkteve të tyre blegtorale. |
| PËRFITUESIT | Bashkia, banorët |
| BURIMI I FINANCIMIT DHE PARTNERËT E MUNDSHËM | Bashkia, Donatorët, FSHZH |
| AKTIVITETE STRATEGJIKE | Hartimi i projektit<br>Ndërtimi i tregut<br>Përcaktimi i qerasë dhe taksave për tezgat |
| VLERËSIMI I KOSTOS | 120.00 mil/lekë |
| PRIORITETI | Faza I |
| AFATET DHE KOHËZGJATJA | 1 vit |

| | |
|---|---|
| TITULLI I PROJEKTIT | Ngritja e pikave të grumbullimit për produktet vendase |
| TIPI I PROJEKTIT | Zhvillim rural e bujqësor |
| VENDNDODHJA E PROJEKTIT | Roskovec |
|  | |
| SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN | Territori i Bashkisë Roskovec, ofron prodhime të bollshme në tokat bujqësore. Sektori i bujqësisë përbën prioritet në zhvillimin ekonomik të zonës në të ardhmen. Nisur nga shifra e prodhimit në bashki, lind nevoja e ngritjes së pikave të grumbllimit në disa njësi administrative. Nisur nga struktura e mbjelljeve, prodhimtaria, sipërfaqet e lira bujqësore, tradita, kushtet klimatiko – tokësore, rezulton se ka hapësira të mëdha për zhvillimin e sektorit në strukturë, prodhimtari dhe sidomos në zgjerimin e hallkave jo vetëm të prodhimit, por edhe të grumbullimit, magazinimit, përpunimit e tregtimit të tyre në tregun rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. |
| PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT | Ky projekt do të përfshije aktivitetet pothuajse në pjesën më të madhe të Njësive Administrative dhe do të sigurojë rritjen e të ardhurave të familjeve fermere, që do të merren me aktivitetet familjare dhe të organizuara dhe do të konsolidojnë këto të ardhura për një periudhë afatmesme kohore. Plani synon përveç teknologjive bashkëkohore të kultivimit, grumbullimit dhe |

| | |
|---|---|
| | përpunimit, në kuadër të rritjes së vlerës së produktit të gatshëm dhe të përpunuar. |
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT (OBJEKTIVAT) | - Krijimi i kushteve optimale për tregtarët dhe për fshatarët që duan të shesin produktet e tyre;<br>- Sistemimi i aksesit në zonë; |
| NDIKIMI/ REZULTATET E PRITSHME | Rezultati i pritshëm, i këtij sektori do të jetë që në një periudhë afatmesme të jetë një nga sektorët bujqësor, me të ardhura më të larta, jo vetëm nga shtimi i prodhimit të produktit të freskët, por sidomos të rritjes së vlerës së tij nga përpunimi i produktit. |
| PËRFITUESIT | Bashkia, banorët |
| BURIMI I FINANCIMIT DHE PARTNERËT E MUNDSHËM | Bashkia, Donatorët, FSHZH, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| AKTIVITETE STRATEGJIKE | Studim lidhur me rajonizimin dhe avantazhet e secilës zonë sipas përkatesisë së varieteteve dhe llojit të pemëve frutore;<br>Hartimi i projektit, përzgjedhja e drejtimeve sipas grup kulturave;<br>Zbatimi i projektit në drejtim të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit, si një filiere e plotë ekonomike<br>Bashkëpunimi me donatorë privatë dhe Institucione të specializuara si AZHBR, etj);<br>Promovimi i zonës;<br>Instalimi i pikave të grumbullimit dhe përpunimit; |
| VLERËSIMI I KOSTOS | 2 mil/lekë |
| PRIORITETI | Faza I |
| AFATET DHE KOHËZGJATJA | 2 vite |

ATELIER 4 STUDIO ARKITEKTURE

| | |
|---|---|
| TITULLI I PROJEKTIT | Rruga bujqësore në Veri |
| TIPI I PROJEKTIT | Infrastrukturë |
| VENDNDODHJA E PROJEKTIT | Fshatrat: Suk I Poshtëm, Suk I Sipërm, Strum, Jagodinë |
|  | |
| SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN | Nga analizimi I territorit dhe vizitat në terren, dukshëm është e nevojshme aksesueshmëria e fshatrave veriorë, me njëri tjetrin, nepërmjet një aksi bujqesor. Ky aks përveç mundësisë për tu aksesuar, do ndihmoj banorët dhe fermerët, që nepërmjet tij, të bëjnë lidhjen më të shpejtë edhe pikat e grumbullimit, si dhe me aksin kryesor të Fierit. |
| PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT | Ky projekt do të përfshijë fshatrat Suk I poshtë, Suk I sipërm, Strum, Jagodinë, duke kaluar në territorin e Patosit, dhe duke vazhduar lidhjen me Fierin. Projekti synon, përmirësimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës rurale e bujqësore në funksion të prodhimit dhe lëvizjes së prodhimit drejt tregut. Gjithashtu, organizimin e grupeve të interesit të prodhuesve dhe përpunuesve të produkteve vendase. |
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT (OBJEKTIVAT) | Projektimi dhe ndërtimi I rrugëve<br><br>Lidhja e fshatrave me njëri tjetrin |


Rr. "F. Konowarfve", Nd 35, H. 6 Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5 1019, Tiranë, Shqipëri Tel. +3554 2222804 / 2430195, e-mail info@...

| | |
|---|---|
| | Lidhja e fshatrave me pikat e grumbullimit<br><br>Lidhja më e afërt me aksin kryesor të Fierit |
| NDIKIMI/ REZULTATET E PRITSHME | Nga rikonstruksioni i rrugës përfiton komuniteti i zonës në disa aspekte (infrastrukturor, ekonomik, social, etj), përfiton Bashkia, |
| PËRFITUESIT | Bashkia, banorët |
| BURIMI I FINANCIMIT DHE PARTNERËT E MUNDSHËM | Bashkia, Donatorët, FSHZH, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| AKTIVITETE STRATEGJIKE | Hartimi i projektit<br><br>Zbatimi i projektit |
| VLERËSIMI I KOSTOS | Sipas projektit ARRSH |
| PRIORITETI | Faza III |
| AFATET DHE KOHËZGJATJA | 2 vite |

ATELIER 4 STUDIO ARKITEKTURE

| TITULLI I PROJEKTIT | Rikualifikimi i qendrës së fshatit Suk i Sipërm |
|---|---|
| TIPI I PROJEKTIT | Arredim Urban, Zhvillim ekonomik, Zhvillim tuistik |
| VENDNDODHJA E PROJEKTIT | Suk i Sipërm |
|  |   |
| SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN | Sot fshati Suk I Sipërm nuk ka një qendër fshati të mirfilltë. Ka hapësira boshe pa funksion dhe nga kjo lind nevoja e krijimit të një hapësire qendrore për komunitetin. Prania e shesheve, por mosfunksionimi i tyre si pasojë e mungesës së infrastrukturës, hapësirave të sistemuara, kushtet jo të përshtatshmetë sheshit të fshatit, kanë ndikuar negativisht në strukturën e fshatit, duke bërë të mundur humbjen e identitetit + karakterit të fshatit. |
| PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT | Projekti synon t'i japë fshatit një hapësirë të dedikuar kryesisht për banorët e saj, po ashtu edhe për nxënësit e shkollës 9-vjeçare. Rivitalizimi i hapësirës së zgjedhur do të ndikojë në përmirësimin e hapësirës publike, nga ana arkitektonike dhe funksionale duke integruar shërbime të nevojshme për nxënësit dhe aktivitete sociale dhe kulturore për banorët. |
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT (OBJEKTIVAT) | Të kthejë identitetin e fshatit, duke ndihmuar drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të fshatit dhe banorëve.<br>Të përforcojë nocionin e zonës urbane |
| NDIKIMI/ REZULTATET E PRITSHME | Zhvillimi i fshatit<br>Përmirësimi i imazhit arkitektonik të zonës |


Rr. "E Kosovarëve", Nd.55, H. 6,Ap 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1013, Tiranë, Shqipëri - Tel: +3554 2222804 / 2430185, e-mail: info@atelier4.al

| | |
|---|---|
| PËRFITUESIT | Banorët e fshatit, Bashkia |
| BURIMI I FINANCIMIT DHE PARTNERËT E MUNDSHËM | Bashkia, FSHZH, Donatorët |
| AKTIVITETE STRATEGJIKE | Hartimi I projektit<br><br>Zbatimi I dizajnit urban |
| VLERËSIMI I KOSTOS | 4.50 mil/lekë |
| PRIORITETI | Faza III |
| AFATET + KOHËZGJATJA | 1 vit |

| | |
|---|---|
| **TITULLI I PROJEKTIT** | Rruga turistike në jug (Luar, Siqecë dhe Ngjeqar- Sinjë) |
| **TIPI I PROJEKTIT** | Infrastrukturë, Zhvillim turistik, Zhvillim ekonomik, Arredim urban, Arkitekturë |
| **VENDNDODHJA E PROJEKTIT** | Luar - Ngjeqar |
|   | |
| **SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN** | Nevoja për promovimin e zonës së fshatit Luar dhe Ngjeqar, duke e lidhur atë dhe me fshatra fqinjë, si: Siqeca, dhe lidhja me fshatrat e Beratit (Sinjë) është e rëndësishme për bashkinë. Krijimi I këtij aksi do të ndihmojë në zhvillimin e agroturizmit. |
| **PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT** | Krijimi i një aks i ri turistik, jo vetëm automobilistik por edhe për biçikleta dhe këmbësorë. Ky aks do të rrisë zhvillimin ekonomik të zonës, zhvillimin e turizmit, duke e mbështetur me shërbime rekreative dhe gastronomike aktuale dhe të propozuara.<br><br>Ky aks do ketë në përbërje të vet dhe sinjalistikën e nevojshme. |

| | |
|---|---|
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT (OBJEKTIVAT) | Projektimi dhe ndertimi i rrugës<br><br>Plotësimi me sinjalistikën e duhur përgjatë rrugëve |
| NDIKIMI/ REZULTATET E PRITSHME | Kjo rrugë synon të lidh fshatrat karakteristikë për zonën, duke bërë të mundur fuqizimin ekonomik të territorit, si pasojë e rivitalizimit turistik të zonës.<br><br>Aksi do të shoqërohet me, pika vrojtimi, stola, pika për shitës ambulantë.<br><br>Aksi do të lidhë funksione të ndryshme që shtrihen përgjatë zonës, ku vizitorët do gjejnë një rrjet të plotë shërbimesh. |
| PËRFITUESIT | Banorët, bashkia, Vizitorët |
| BURIMI I FINANCIMIT DHE PARTNERËT E MUNDSHËM | Bashkia, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Donatorë të ndryshëm etj. |
| AKTIVITETE STRATEGJIKE | Hartimi i Projektit të Detajuar<br><br>Zbatimi i Projektit të Ndërtimit, së bashku me sinjalistikën përkatëse |
| VLERËSIMI I KOSTOS | 15.40 mil/lekë |
| PRIORITETI | Faza I |
| AFATET DHE KOHËZGJATJA | 3 vite |

| | |
|---|---|
| TITULLI I PROJEKTIT | Ndërtimi i një parku të ri prane zonës së Rezervuarit të Roskovecit |
| TIPI I PROJEKTIT | Infrastruktura e mbrojtjes mjedisore |
| VENDNDODHJA E PROJEKTIT | Bashkia Roskovec |
|  |   |
| SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN | Qyteti i Roskovecit ka nevojë për më shumë hapësira të gjelbra për të ekuilibruar ndotjen aktual të ajrit si dhe parqe apo hapsira rekreacioni për banorët e këtij qyteti |
| PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT | Projekti konsiston në ndërtimin e një parku me hapësira të gjelbra si dhe një kënd dedikuar për fëmijët pikërisht në një nga hapësirat e shumta buzë Rezervuarit të Roskovecit. Kjo do të ishtë një hapësirë e gjelbër më shumë në këtë qytet si dhe një vlerë e shtuar për qytetin dhe një mundësi e mirë për të tërhequr turistët. |
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT (OBJEKTIVAT) | - Krijimi i një mushkërie të gjelbër për qytetin dhe një hapësire të dedikuar për më të vegjlit e kësaj zone. |
| PËRFITUESIT | Banorët e Bashkisë Roskovec |
| PËRGJEGJËSITË (BURIMI I FINANCIMIT DHE PARTNERËT E MUNDSHËM) | Bashkia Roskovec, Donatorë të ndryshëm |
| AKTIVITETE STRATEGJIKE | Plani për përcatimin e zonës ku do të implementohet projekti |
| VLERËSIMI I KOSTOS | 10 mil/lekë |
| PRIORITETI | Faza I dhe II |
| AFATET DHE KOHËZGJATJA | 3 vjet |


Rr. "... Kosovarëve", Nd.35, H. 6, Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5,1019, Tiranë, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430135, e-mail: info@atelier4.al

| | |
|---|---|
| TITULLI I PROJEKTIT | Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujrave të Ndotur për Bashkinë Rroskovec |
| TIPI I PROJEKTIT | Infrastrukturë urbane, Trajtim i Ujrave të Ndotur |
| VENDNDODHJA E PROJEKTIT | Bashkia Rroskovec |
| SFONDI DHE PROBLEMATIKAT QË ADRESOHEN | NUK Rroskovec nuk realizon aspak largimin e organizuar të ujrave të zeza. Ndonëse qyteti i Rroskovecit dhe Njësitë Administrative të kësaj bashkie kanë një mbulim të kënaqshëm me shërbimin e kanalizimeve të ujrave të zeza, problemi kryesor qëndron në emetimin e ujrave të ndotur të patrajtuara në mjedis. Nëpërmjet kolektorit kryesor ujrat e ndotur të qytetit shkarkohen direkt në lumin e Semanit duke cënuar mjedisin dhe ndikuar negativisht në potencialin turistik të zonës. |
| PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT | Projekti do të kanalizojë dhe disiplinojë largimin e ujrave të zeza dhe atyre të shiut. Do të plotësojë rrjetin ekzistues në shërbim të të gjithe banorëve, do të realizoje trajtimin e ujrave të zeza për banorët e qytetit të Rroskovecit dhe fshtrave përreth. |
| QËLLIMI KRYESOR I PROJEKTIT [OBJEKTIVAT] | - Kanalizimi tërësor i ujrave të zeza të qytetit Rroskovec dhe fshtrave përreth.<br>- Trajtimi i ujrave të zeza të qytetit Rroskovec dhe fshtrave përreth.<br>- Eliminimi i shkarkimeve në kanalet e hapura.<br>- Eliminimi i gropave septike individuale të qytetit Rroskovec dhe fshtrave përreth. |
